



**UNIVERSITETI I TIRANËS**

---

**FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE  
DEPARTAMENTI PEDAGOGJI-PSIKOLOGJI  
PROGRAMI I DOKTORATURËS**

**TEMA:**

**“PËRFSHIRJA E PRINDËRVE NË REALIZIMIN E  
KURRIKULËS SË CIKLIT FILLOR SI FAKTOR I  
NDËRTIMIT TË MARRDHËNIEVE MIQËSORE TË  
NXËNËSIT ME SHKOLLËN”**

**Paraqitur në kërkim të gradës shkencore**

**“Doktor”**

**nga MS. Dritan SALLAKU**

*Udhëhequr nga :*

**PROF. DR. MILIKA DHAMO**

*Tiranë, Shtator 2015*

## **DEKLARATË STATUORE**

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

E drejtë e autorit © 2013. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.



**UNIVERSITETI I TIRANËS**

**FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE  
DEPARTAMENTI PEDAGOGJI-PSIKOLOGJI  
PROGRAMI I DOKTORATURËS**

**TEMA:**

**PËRFSHIRJA E PRINDËRVE NË REALIZIMIN E  
KURRIKULËS SË CIKLIT FILLOR SI FAKTOR I  
NDËRTIMIT TË MARRDHËNIEVE MIQËSORE TË  
NXËNËSIT ME SHKOLLËN**

**Paraqitur në kërkim të gradës shkencore “Doktor”**

**nga MS. Dritan SALLAKU**

*Udhëhequr nga :*

**Prof. Dr. MILIKA DHAMO**

**Juria e mbrojtjes:**

1. Prof. As. \_\_\_\_\_ (Kryetar)
2. Prof. \_\_\_\_\_ (Oponent)
3. Prof. \_\_\_\_\_ (Anëtar)
4. Prof. As. \_\_\_\_\_ (Oponent)
5. Prof. As. \_\_\_\_\_ (Anëtar)

**TIRANË, 2015**

## I ABSTRAKT

Ndërtimi dhe zhvillimi i partneritetit shkollë-familje, po shfaqet si një ndër tematikat më aktuale në diskutimet dhe qasjet profesionale të drejtuesve të institucioneve shkollore, mësuesve, specialistëve dhe kërkuesve shkencor të fushës së edukimit. Kjo, jo vetëm për shkak të interesit të shkollës për përmirësimin e cilësisë së shërbimit të saj, por edhe për faktin se familja ka një rol dhe potencial të konsiderueshëm në efektivitetin e edukimit të fëmijëve.

Studimi në vijim, i titulluar “*Përfshirja e prindërve në realizimin e krikllës së ciklit fillor, si faktor i ndërtimit të marrëdhënieve miqësore të nxënësit me shkollën*”, është zhvilluar në kuadër të programit të Doktoratës të organizuar në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës. Studimi është zhvilluar pikërisht në këtë fushë dhe/ose aspekt të shërbimit arsimor dhe ka synuar të paraqesë jo vetëm një analizë të cilësisë së zhvillimit të kësaj marrëdhënie në institucionet tona shkollore, por edhe të ofrojë një qasje lidhur me metodologjinë që mund të zbatohet në shkolla, lidhur me ndërtimin dhe zhvillimin profesional të marrëdhënieve të mësuesit me prindërit në ciklin fillor të edukimit.

Studimi analizon disa nga aspektet dhe karakteristikat që evidencohen në përvojën e deritanishme të shkollave tona në bashkëpunimin e tyre me prindërit. Në këtë kontekst, janë analizuar dhe evidencuar karakteristikat, barrierat dhe vështirësitë që paraqesin komunitetet prindërore të shkollave tona, të cilat nuk u mundësojnë atyre një përfshirje efektive në procesin e edukimit të fëmijëve të tyre. Gjithashtu, studimi ka analizuar edhe kuadrin normativ dhe rregullator të sistemit arsimor në vendin tonë, përvojën aktuale të krijuar në shkollat tona në këtë drejtim, duke konstatuar se ato janë të pamjaftueshme për një përfshirje të plotë dhe efektive të prindërve.

Studimi, duke konsideruar përvojën e krijuar dhe sidomos interesin e përbashkët të shkollës dhe prindërve për zhvillimin e qëndrueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor, paraqet dhe zhvillon tezën se, përfshirja dhe partneriteti i shkollës me ato duhet të fitojë një tipar dhe/ose dimension të ri, atë të *angazhimit* të prindërve në realizimin e procesit të edukimit dhe sidomos në atë të të nxënësve.

Popullata e këtij studimi janë prindërit e nxënësve të ciklit fillor të klasave I-V-së të shkollave 9-vjeçare, të cilat administrohen nga Drejtoria Arsimore Rajonale e qytetit Tiranë. Kampioni i

përzgjedhur nga kjo popullatë, ka qenë 2885 prindër dhe referuar statistikave të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për vitin shkollor 2012-2013, përbën 10.8 % të prindërve që kanë përfituar shërbimin arsimor në institucionet shkollore të këtij qyteti.

Me qëllim njohjen e karakteristikave të komuniteteve prindërore të shkollave, si instrument kryesor i metodologjisë, u hartua dhe u administrua një pyetësor i strukturuar për prindërit. Pyetësori u strukturua në rubrika të tilla; të përgjithshme, për kompetencën/aftësinë e të shkruarit, për kompetencën/aftësinë e të lexuarit, për kompetencën/aftësinë matematikore, për njohjen e programeve lëndore dhe për organizimin e procesit të edukimit në familje. Pyetësori përmban gjithsej 47 pyetje dhe përpunimi i dhënave të mbledhura u realizua përmes paketës statistikore për shkencat sociale SPSS, version 18.

Rezultatet e studimit tregojnë se prindërit në shkollat tona kanë një përfshirje të konsiderueshme në jetën dhe veprimtarinë e shkollës, por kjo pjesëmarrje pasqyrohet vetëm në aspektin e drejtimit dhe administrimit të institucionit shkollor. Ndërsa, kjo përvojë nuk u mundëson atyre (prindërve) të jenë faktor mbështetës të cilësisë së shërbimit arsimor që ofrohet në shkolla. Evidencimi dhe interpretimi i karakteristikave të komunitetit të prindërve në shkolla, të tilla si; niveli arsimor i tyre, mos njohja e programeve lëndore, mungesa e aftësive mbi metodologjinë e procesit të të mësuarit, i bën ata jo një faktor mbështetës dhe plotësues të cilësisë, por në faktor dhe shkaktar të riskut të saj.

**FJALË KYÇE:** Përfshirje në edukim, angazhimi në edukim, nxënie, kompetencë, të mësuarit në shtëpi, partneriteti shkollë-familje, tregues të suksesit.

## II MIRËNJOHJA

Studimi që kam nderin të paraqes është mundësuar falë mbështetjes, bashkëpunimit, inkurajimit dhe konsulencës miqësore e profesionale të të gjithë aktorëve dhe subjekteve që u përfshinë, që nga ideimi dhe deri në strukturimin dhe përfundimin e plotë të tij.

Dëshiroj të falenderoj prindërit e nxënësve me të cilët u realizua pjesa më e madhe e metodologjisë së këtij studimi. Gatishmëria, durimi, koha që nuk u mungoi asnjëherë për të komunikuar me mua, sinqeriteti dhe komunikimi i tyre kanë qenë mbresëlënës për cilësinë e bashkëpunimit dhe frymëzues për zhvillimin dhe kapërcimin e çdo faze të zhvillimit të kësaj teze.

Një falenderim të veçantë kam për drejtuesit dhe mësuesit e shkollave me të cilët u bashkëpunua për realizimin e këtij studimi. Profesionalizmi, përvoja, gatishmëria dhe mirëkuptimi i ofruar nga kolegët mësues dhe drejtues të shkollave, më mundësuan një bashkëpunim dhe komunikim me rëndësi përcaktuese për identifikimin dhe qartësimin e aspekteve të vëzhguara në veçanti dhe studimin në tërësi.

Me plot respekt dhe mirënjohje falenderoj Prof. Dr. Milika Dharmo, udhëheqësen time shkencore në këtë studim. Secila prej orëve apo ditëve të panumërta që ajo i ka dedikuar bashkëpunimit tonë, kanë sjellë për mua një konsulencë dhe ekspertizë profesionale të shkëlqyer që ka ndikuar në ridimensionimin e këndvështrimit tim mbi temën e studiuar, në zgjerimin dhe përfitimin e njohurive në fushën e interesit të temës, si dhe në orientimin dhe konsolidimin e qasjeve që reflektohen në punimin tonë shkencor.

Plot me dashuri dhe mirënjohje është edhe falenderimi që kam për familjarët e mijë, të cilët kanë bërë gjithçka, jo vetëm për të më lehtësuar, por edhe për të më mbështetur në këtë angazhim shkencor timin.

Falenderime, mirënjohje dhe suksese u adresoj Profesoratit të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, kolegëve të mijë në punë dhe veçanërisht kolegëve me të cilët, së bashku vijua studimet e këtij programi doktori. Mendimet, këshillimet dhe përvojat që kemi ndarë se bashku, kanë qenë mjaft interesante dhe të dobishme për mua.

### **III TABELA E PËRMBAJTJES**

- I Abstrakt
- II Mirënjohje
- III Pasqyra e lëndës
- IV Lista e tabelave dhe grafikëve

### **KAPITULLI I PARE**

- 1 HYRJE.....faqe 12
- 1.1. Prezantimi i problemit.....faqe 13
- 1.2. Qëllimi i studimit.....faqe 16
- 1.3. Hipoteza të studimit.....faqe 17
- 1.4. Objektivat e studimit.....faqe 18
- 1.5. Rëndësia e studimit.....faqe 19
- 1.6. Përkufizime.....faqe 20
- 1.7. Kufizime te studimit.....faqe21
- 1.8. Organizimi studimit.....faqe 22

### **KAPITULLI I DYTË**

- 2 SHQYRTIMI I LITERATURËS .....faqe 24
- 2.1. Prindërimi, modelet dhe karakteristikat.....faqe 27
- 2.2. Prindërimi, stilet dhe karakteristikat.....faqe 30
- 2.3. Menaxhimi i shkollës dhe partneriteti me prindërit.....faqe 31

2.4	Politikat arsimore për partneritetin shkollë-familje.....	faqe 34
2.4.1	Politikat arsimore rajonale për partneritetin shkollë-familje.....	faqe 34
2.4.2	Politikat arsimore lokale për partneritetin shkollë-familje.....	faqe 37
2.5	Barriera të përfshirjes së prindërve në shkollë.....	faqe 42
2.6	Studime të kryera në Shqipëri.....	faqe 43

## **KAPITULLI I TRETË**

3	METODOLOGJIA.....	faqe 48
3.1	Analizimi i politikave institucionale dhe përvojave metodologjike të krijuara në vendin tonë .....	faqe 48
3.2	Popullata e studiuar, kampioni dhe instrumenti i mbledhjes së të dhënave .....	faqe 50

## **KAPITULLI I KATËRT**

4	GJETJET E STUDIMIT.....	faqe 54
4.1	Gjetjet nga analiza e politikave arsimore dhe përvojave metodologjike të krijuara në vendin tonë.....	faqe 54
4.1.1	Gjetjet nga analiza e programeve të studimit të IAL-ve për formimin e mësuesve të ciklit fillor.....	faqe 54
4.1.2	Gjetjet nga analiza e planeve vjetore të punës mësimore edukative në shkollë.....	faqe 54
4.1.3	Gjetjet nga analiza e politikave të zhvillimit profesional të punonjësve mësimor.....	faqe 55
4.1.4	Gjetje nga analizimi i përvojës së vlerësimit të cilësisë së shërbimit arsimor në institucionet shkollore .....	faqe 62



4.2	Gjetje të përfituara nga pjesëmarrësit në studim.....	faqe 63
-----	---	---------

## **KAPITULLI I PESTË**

5	DISKUTIMI.....	faqe 80
---	----------------	---------

5.1	Diskutimi i gjetjeve nga analiza e politikave arsimore.....	faqe 80
-----	---	---------

5.1.1	Kuadri normativ dhe rregullator i bashkëpunimit shkollë-prindër.....	faqe 81
-------	--	---------

5.1.2	Zhvillimi profesional i mësuesve dhe drejtuesve në shërbim.....	faqe 81
-------	---	---------

5.1.3	Programet e studimit të IAL-ve në formimin e mësuesve të rinj.....	faqe 82
-------	--	---------

5.2	Diskutimi i gjetjeve nga studimi pjesëmarrësve në studim.....	faqe 83
-----	---	---------

5.2.1	Karakteristika të komunitetit prindëror në shkolla tona.....	faqe 83
-------	--	---------

5.2.2	Kompetencat akademike, njohja dhe qëndrimi i prindërve.....	faqe 84
-------	---	---------

5.2.3	Njohja e programeve lëndore nga prindërit.....	faqe 88
-------	--	---------

5.2.4	Karakteristika të procesit të edukimit të organizuar në shtëpi.....	faqe 90
-------	---	---------

5.2.5	Standardizimi i metodologjisë së angazhimit të prindërve në procesin e nxënies.....	faqe 91
-------	--	---------

## **KAPITULLI I GJASHTË**

6	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	faqe 97
---	---------------------------------	---------

6.1	Përfundime lidhur me hipotezën e studimit.....	faqe 97
-----	--	---------

6.2	Përfundime lidhur me objektivat e studimit.....	faqe 99
-----	---	---------

6.3	Rekomandime.....	faqe 100
-----	------------------	----------

#### IV LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKËVE

Tabela 1:	Standardet e partneritetit shkoll-familje
Tabela 2:	Karakteristikat të kampionit të përdorur
Tabela 3:	Planet vjetore të punës mësimore dhe edukative të analizuara
Tabela dhe grafiku 4:	Pjesëmarrja në pyetsot sipas gjinisë
Tabela dhe grafiku 5:	Shpërndarja e nxënësve sipas klasave
Tabela dhe grafiku 6:	Niveli arsimor i prindërve (Nënat)
Tabela dhe grafiku 7:	Niveli arsimor i prindërve (Babai)
Tabela dhe grafiku 8:	Profesioni i prindërve.(Nëna)
Tabela dhe grafiku 9:	Profesioni i prindërve.( Babai)
Grafiku 10:	Aftësia e të shkruajturit dhe rëndësia në formimin e fëmijës
Grafiku 11:	Vlerësimi i prindërve për cilësinë e të shkruarit
Grafiku 12:	Vlerësimi i prindërve për rëndësinë e të lexuarit në formimin e fëmijës
Grafiku 13:	Vlerësimi i prindërve për cilësinë e të lexuarit të fëmijës
Grafiku 14:	Vlerësimi i cilësisë së të lexuarit- mësuesja
Grafiku 15:	Dakordësia e prindërve me vlerësimin e mësueses për aftësinë e të lexuarit
Grafiku 16:	Njohja që kanë prindërit për treguesit e cilësisë së aftësisë së të lexuarit
Grafiku 17:	Shkolla duhet t'i njohë prindërit me treguesit e cilësisë së aftësisë së të lexuarit
Grafiku 18:	Njohja e prindërve me treguesit e cilësisë nga mësuesja
Grafiku 19:	Kompetenca matematikore dhe rëndësia në formimin e fëmijës
Grafiku 20:	Vlerësimi i rezultateve të fëmijës matematikë-prindërit
Grafiku 21:	Vlerësimi i rezultateve të fëmijës matematikë-mësuesi
Grafiku 22:	Dakordësia e prindërve me vlerësimin e mësueses në matematikë
Grafiku 23:	Mundësia e prindërve për të ndihmuar fëmijët në të mësuarin në matematikë
Grafiku 24:	Këshillimi i metodik i prindërve për ndihmën e fëmijëve në matreantikë

Grafiku 25: ..... *Njohja e treguesve të cilësisë për kompetencën e matematikës*

Grafiku 26: ..... *Shkolla duhet t'i njohë prindërit me treguesit e suksesit në matematikë*

Grafiku 27, tabela 11: ..... *Njohja e programeve lëndore nga prindërit*

Grafiku 28: ..... *Programet lëndorë që njohin prindërit*

Grafiku 29: ..... *Informimi i prindërve për mundësinë e njohjes së programeve*

Grafiku 30: ..... *Njohja e objektivave të programeve lëndore*

Grafiku 31: ..... *Njohja e objektivave të linjave të programeve lëndore*

Grafiku 32: ..... *Këshillimi për rëndësinë e njohjes së programeve lëndore*

Grafiku 33: ..... *Pajisja e prindërve me programe lëndore*

Grafiku 34: ..... *Cilësia e procesit mësimor në klasë*

Grafiku 35: ..... *Ngarkesa mësimore në klasë*

Grafiku 36: ..... *Ngarkesa mësimore dhe niveli i stresit*

Grafiku 37: ..... *Cilësia e mjedisit mësimor në shtëpi*

Grafiku 38: ..... *Me cilin prej prindërve ndjehet më mirë fëmija gjatë të mësuarit në shtëpi*

Grafiku 39: ..... *Cili prej prindërve ndihmon më shumë fëmijën në të mësuarin në shtëpi*

Grafiku 40: ..... *Niveli i ngarkesës mësimore të fëmijës në shtëpi*

Grafiku 41: ..... *Përdorimi i teksteve ndihmëse/alternative në të mësuarin në shtëpi*

Grafiku 42: ..... *Nevoja e fëmijëve për kurse mësimore private*

Grafiku 43: ..... *Frekuentimi i kurseve mësimore private nga fëmijët*

Grafiku 44: ..... *Lëndët në të cilat frekuentohen kurset mësimore private*

Grafiku 45: ..... *Dokumentet kurrikulare në të cilat referohen prindërit gjatë të mësuarit në shtëpi*

Grafiku 46: ..... *Vështirësitë e prindërve në procesin mësimor të të mësuarit në shtëpi*

## **KAPITULLI I PARË**

### **1. HYRJJE**

Veprimtaria e edukimit, si një ndër veprimtaritë qëllimshme më tipike të njeriut, konsiderohet me të drejtë si proces. Kjo, për faktin se edukimi është ndër përvojat më jetëgjatë të njeriut, e cila faktorizohet nga/dhe implikon disa aktorë e faktorë me natyra nga më të ndryshmet dhe më komplekset.

Edukimi si përvojë është bashkudhëtar i jetës së qenies njerëzore, si në planin individual, ashtu dhe në atë komunitar. Përfshirja e tij në mënyrë të qëllimshme në edukim, është udhëhequr gjithmonë nga interesi më i lartë, së pari vetjak dhe më tej si pjesë e bashkësisë. Natyra e interesit më të lartë, në mënyrë dialektike shfaqet me profile të ndryshme për etapa dhe stadi të ndryshme të zhvillimit dhe evoluimit të shoqërisë. Kështu, nëse format fillestare të edukimit ishin në funksion të ekzistencës apo mbijetesës individuale të njeriut, format e mëvonshme, institucionet dhe deri sistemet aktuale të strukturuar nëpër organizimin dhe sigurimin e edukimit, dëshmojnë për ndërgjegjësimin e njeriut dhe shoqërisë për rolin dhe rëndësinë që ka edukimi në zhvillimin, emancipimin dhe cilësinë e të jetuarit në tërësi.

Arritja e potencialeve zhvillimore të edukimit ka qenë dhe vijon të jetë në themel të punës kërkimore të studiuesve në veçanti dhe mësimeve në përgjithësi. Këta aktorë, me qasjet e tyre ndaj përvojës së edukimit dhe sidomos të cilësisë së saj, krahas synimit për maksimalizimin e efektivitetit të aspekteve me natyre metodologjike dhe kurrikulare të këtij procesi, kanë synuar që të konsiderojnë partneritetin e shkollës me shoqërinë në përgjithësi dhe prindërit në veçanti, jo thjesht si “konsumator”, por edhe si kontributorë të drejtpërdrejtë të cilësisë së shërbimit.

Pikërisht, studimi im është orientuar dhe fokusohet në këtë aspekt të edukimit, të partneritetit të shkollës me prindërit dhe ndikimit që ka ky bashkëpunim për ndërtimin e një mjedisi miqësor, i konsideruar njëkohësisht si kusht dhe parakusht për një shërbim cilësor dhe efektiv të shkollës.

Nevoja për bashkëpunim të prindërve me shkollën, është një kërkesë konstante që pohohet si domosdoshmëri si nga shkolla, ashtu dhe nga prindërit. Shkolla, referuar filozofisë dhe parimeve të saj të drejtimit, e kërkon bashkëpunim e prindërve në çdo aspekt të organizimit, menaxhimit dhe funksionimit të saj, ndërsa prindërit, krahas gatishmërisë së tyre për të kontribuar në organet dhe forumet menaxhuese dhe administruese të shkollës, interesin më të lartë e kanë për cilësinë

e shërbimit që ata përfitojnë, e shprehur kjo me suksesin që fëmija arrin në shkollë, si në planin akademik ashtu dhe në atë të edukimit në tërësi. Ky interes, në mënyrë të natyrshme është interesi parësor i të gjithë prindërve, por gjithashtu, ky është edhe qëllimi, madje dhe misioni i vetë shkollës si institucion.

Pikërisht, për shkak të potencialeve të mëdha edukative që mbart familja, por edhe për jetësimin e rolit dhe misionit që ka shkolla kundrejt demokratizimit, kohezionit social dhe ruajtjes dhe promovimit të vlerave të shoqërisë, politikbërësit dhe administratorët e arsimit, po theksojnë gjithnjë e më shumë rëndësinë dhe nevojën për metodika dhe modele që sigurojnë bashkëpunim efektiv ndërmjet këtyre dy aktorëve.

### **1.1 Prezantimi i problemit**

Faktorët që mbështesin, por edhe kufizojnë suksesin e nxënësve në arritjet e tyre shkollore, mund të jenë të shumtë, gjithashtu edhe natyra e tyre shfaqet e larmishme, duke i parë ato në kontekste ekonomike, kulturore, sociale. Në mënyrë tipike, faktorët që mbështesin dhe kufizojnë drejtpërsëdrejti cilësinë e arritjeve të nxënësit, si në drejtim të sjelljes, ashtu dhe në progresin akademik të tij, përgjithësohen në faktorë me natyrë, kryesisht psiko-pedagogjike dhe më tej sociale, kulturore, ekonomike etj.

Cilësia e shërbimit arsimor që synohet nga institucionet shkollore dhe pritet nga prindërit është në raport të drejtë me cilësinë e “input”-eve, pra të aktorëve dhe faktorëve që investohen në këtë shërbim. Si të tillë mund të konsiderojmë:

- cilësinë e mësimdhënësve në aspektin metodiko-profesional,
- cilësinë e kurrikulave që planifikohen dhe zbatohen në shkollë,
- cilësinë e mjedisit dhe infrastrukturës mësimore.

Me rëndësi dhe ndikim të veçantë kundrejt arritjes apo kufizimit të cilësisë së shërbimit arsimor, janë edhe faktorë të tillë psiko-social si: motivimi, vetëdija, interesat dhe qëndrimet ndaj vlerave dhe kompetencave që zhvillohen në shkollë. Këto faktor mund të evidencohen si tek trupa e mësimdhënësve që e ofrojnë shërbimin arsimor, por edhe tek nxënësit dhe prindërit që e përfitojnë këtë shërbim

Bashkëpunimi i shkollës me prindërit fillon që në vitet e para të shkollimit dhe e shoqëron nxënësin gjatë gjithë përvojës së tij shkollore. Bashkëpunimi i prindërve me shkollën, spikat për intensitetin e lartë të këtij bashkëpunimi në vitet e para të shkollimit, që përkojnë me ciklin fillor dhe duke shprehur tendencën e zbehjes së kësaj marrëdhënie në vitet në vijim. Gjatë kësaj periudhe, pra në vitet e para të edukimit në ciklin fillor, bashkëpunimi i suksesshëm i prindërve me shkollën paraqet disa sfida, të cilat mund të klasifikohen në dy drejtime:

- *së pari*, në aftësinë e tyre për të ndihmuar fëmijët drejtë një qasje pozitive të tyre ndaj shkollës, profil i cili konstatohet veçanërisht në vitin e parë dhe të dytë të ciklit fillor dhe
- *së dyti* në aftësinë e tyre për të mbështetur arritjet e suksesshme, duke qenë njëkohësisht mbështetës dhe komplementar me përvojën mësimore dhe edukative që fëmija realizon në klasë/shkollë.

Arritja e suksesit të prindërve në qasjen pozitive të fëmijës, ndikohet nga disa faktorë, sikurse mund të jenë; gatishmëria e prindërve dhe e mësuesve, efikasiteti i teknikave të komunikimit dhe bashkëpunimit që ndërtojnë të dy këta aktorë, besueshmëria që krijojnë prindërit për cilësinë e shërbimit që përfitojnë, unifikimi apo dakordësia me kompetencat, vlerat dhe qëndrimet që promovon dhe zhvillon shkolla dhe sigurisht, kapaciteti intelektual dhe akademik që kanë prindërit për të konsultuar dhe ndihmuar fëmijën drejtë suksesit në shkollë, si kundrejt arritjeve akademike, ashtu dhe drejtë vlerave ndër personale dhe sociale.

Fillimi i përvojës shkollore, krahas të tjerave, përcjell për fëmijën një mjedis të ri, i cili spikat me shumë risi, të panjohura dhe deri sfida për fëmijën, të cilat mund të konsiderohen si kërkesa, detyra dhe sfida për ndërtimin e marrëdhënieve të reja sociale, si dhe raporti që do të duhet të vendosë ai/ajo me kërkesat, detyrat dhe sfidat për një performim të suksesshëm në realizimin e programit/ve shkollore në pikëpamjen akademike.

Realizimi i suksesshëm i pjesëmarrjes së suksesshme në përvojën shkollore të fëmijës, përfaqëson interesin më të lartë për prindërit dhe njëkohësisht qëllimin më kryesor për shkollën dhe, të dy këto subjekte janë përgjegjësit kryesor për arritjen apo dështimin kundrejt këtij interesi/qëllimi.

Bashkëpunimi i shkollës me komunitetin e saj prindëror, po klasifikohet gjithnjë e më shumë si një tregues (indikator) i cilësisë së menaxhimit të shkollës dhe kjo pikërisht për shkak të rolit

dhe ndikimit që ka ky tregues në cilësinë e shërbimit që ofron shkolla. *Martimowr(1988)*, në këtë kontekst nënvizon se: “*prindërit janë një ndër faktorët që dallojnë shkollat efektive nga ato më pak të tilla*”. Ndërsa Heneveld & Craig (1996) e përcaktojnë mbështetjen e komunitetit dhe rolin e prindërve në veprimtarinë e shkollës, si faktor kyç të efektivitetit të shërbimit. Duke konsideruar ndikimin e këtij aspekti, promovimi dhe zhvillimi i partneritetit të shkollës me prindërit, është identifikuar si domosdoshmëri edhe në aktet normative ligjore dhe nënligjore që adresohen në sistemin tonë të arsimit para universitar.

Qëllimi i të drejtave dhe detyrave që përcaktohen në këtë kuadër legal, si për shkollën, por sidomos për prindërit, është shfrytëzimi i potencialeve edukative që mbart familja. Kështu, në nenin 62, pika 1 të ligjit për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, prindërit përcaktohen si partner kryesor të institucionit arsimor. Ndërsa në pikën 3 të këtij neni dhe gjithashtu, në nenin 102, pika 2 të dispozitave normative të shkollës, miratuar në vitin 2013, përcaktohet si detyrë, që prindi, ...“duhet të kujdeset që fëmija i tij të ndjekë rregullisht institucionin arsimor dhe të mësojë rregullisht”.

Gjithashtu, në mbështetje dhe plotësim të këtyre akteve, në “Standardet e Përgjithshme të Mësuesit”(SPM), ndër kërkesat dhe standardet e performancës së mësuesit, përcaktohet edhe Standardi, ‘Bashkëpunimi me komunitetin’, treguesit e suksesit të cilit përcaktojnë se; “Mësuesi beson se bashkëpunimi i vazhdueshëm me prindërit është i domosdoshëm për përmirësimin e arritjeve të fëmijëve të tyre dhe të nxënësve në përgjithësi(treguesi 1). Gjithashtu, treguesit 3 dhe 4 të këtij standardi, përcaktojnë përkatësisht se; “Mësuesi u siguron prindërve, informacionet e nevojshme dhe në kohën e duhur për arritjet e fëmijës së tyre”, si dhe në vijim; “Mësuesi ndihmon prindërit të kuptojnë kërkesat e kurikulës ndaj fëmijës së tyre”.

“Kodi etikës së mësuesit”, i cili përfaqëson një tjetër dokument që i adresohet mësuesit në krijimin e modelit të sjelljes që shoqëria vlerëson dhe kërkon si të nevojshëm, në mënyrë që shkolla të realizojë misionin e saj shoqëror për një shoqëri demokratike. Ky dokument, synon të kontribuojë në garantimin e shërbimit arsimor mbështetur në standarde profesionale, në përgjithësimin e praktikave që lidhen me; përkushtimin ndaj nxënësit, përkushtimin ndaj profesionit dhe mjedisit mësimor. Në fushën e dytë të Kodit të etikës, treguesi 2.2, përcaktohet se; *Mësuesi bashkëpunon me prindërit dhe komunitetin në baza mirëbesimi të ndërsjellët*. Në këtë tregues suksesi, mësuesit i kërkohet që të bashkëpunojë me prindërit dhe komunitetin në

funkcion të cilësisë së mësimdhënies e të nxënësve, si dhe të respektojë dhe të përdorë privatësinë e informacionit të veçantë për nxënësin vetëm në interesin më të mirë të nxënësit.

Tradita dhe përvoja e deritanishme e krijuar në drejtim të partneritetit të shkollës dhe familjes, dallohet kryesisht në terma të menaxhimit dhe administrimit të institucionit shkollor dhe jo në arritjet akademike dhe ato të sjelljes së fëmijës/nxënësit. Drejtuesit dhe mësuesit, në përgjigje të interesit më të lartë të prindërve, i cili përgjithësohet me pjesëmarrjen dhe arritjet e suksesshme të fëmijës në shkollë, duhet të adoptojnë teknika dhe metodologji të posaçme, të cilat mundësojnë menaxhimin, si të riskut ashtu dhe të potencialit edukativ që mbartin prindërit dhe familja, duke synuar vendosjen e një bashkëpunimi efektiv dhe duke i konsideruar e trajtuar prindërit si partnerë të qëndrueshëm dhe pjesëmarrës në arritjen e cilësisë së shërbimit.

Përvoja e deritanishme e ndërtuar në shkollën tonë, lidhur me bashkëpunimin e saj me prindërit, përbën një mundësi të mirë për zhvillimin e mëtejshëm të këtij aspekti. Ky bashkëpunim duhet të krijojë tashmë një dimension të ri të përfshirjes së prindërve “*dimensionin e angazhimit të tyre në realizimin cilësor të kurrikulave*”, që zbatohen në institucionet shkollore, përkatësisht në ciklin fillor të edukimit.

## **1.2 Qëllimi i studimit**

Studimi ka për qëllim të vlerësojë ndikimin që ka njohja e programeve në angazhimin dhe pjesëmarrjen e suksesshme të prindërve në realizimin e kurikulës shkollore.

Studimi synon të masë nivelin e njohjes që kanë prindërit për kompetencat e të shkruarit, të t’lexuarit dhe ato matematikore, si dhe për programet lëndore në tërësi, si dhe të evidencojë faktin që kufizimi apo mungesa e plotë e njohjes së tyre është shkaktar kryesor i kufizimit të bashkëpunimit të tyre me shkollën dhe për pasojë i mos realizimit të potencialit edukativ që ato (prindërit) mbartin.

Studimi hedh dritë mbi format dhe përvojat metodike të krijuara nga mësuesit dhe drejtuesit e shkollave, lidhur me zhvillimin e të drejtës së prindërve për t’u mbështetur në punën mësimore dhe edukative që ata organizojnë në familje.

Studimi tregon se zhvillimi i partneritetit, bashkëpunimit dhe mbështetja që shkolla dhe mësuesit duhet t’u ofrojnë prindërve në drejtim të përmirësimit të arritjeve akademike të fëmijës,



nuk konsiderohet dhe trajtohet si tregues i cilësisë së shërbimit të ofruar prej tyre dhe për pasojë, mungon krijimi i një përvoje dhe metodike të unifikuar në këtë drejtim.

Studimi synon të vërtetojë se mbështetja e shkollës në aftësimin e prindërve në dallimin objektiv të suksesit, apo mungesës së tij në arritjet akademike të nxënësit, është faktor që ndikon në potencialin e pjesëmarrjes miqësore të fëmijës/nxënësit në shkollë.

Në vijim, studimi evidencon vështirësitë metodike që kanë prindërit në procesin mësimor që ata organizojnë në familje, si dhe të vlerësojë nivelin e gatishmërisë së tyre për të bashkëpunuar me shkollën në drejtim të njohjes, përvetësimit dhe zbatimit të metodikave profesionale në organizimin e procesit mësimor në familje.

Gjithashtu, studimi ka si qëllim të evidencojë edhe faktin që; kuadri aktual normativ dhe rregullator në shkollat tona, ka mundësuar krijimin e një përvoje të caktuar në drejtim të *përfshirjes* së prindërve në jetën dhe në veprimtaritë e shkollës, ndërsa mungon baza normative, modeli dhe metodika që mundëson krijimin e përvojes për *angazhimin* e prindërve në realizimin e procesit të nxënies.

Studimi propozon një model konkret dhe të standardizuar, i cili ka si qëllim të mbështesë dhe të ndihmojë punën dhe veprimtaritë që ndërmarrin mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve shkollore për ndërtimin dhe përfshirjen efektive të prindërve në procesin e edukimit në tërësi dhe atë të nxënies në veçanti.

### **1.3 Hipoteza të studimit**

Studimi synon të provojë se;

- Angazhimi i prindërve në procesin e të mësuarit, është një përvojë e munguar në modelin e organizimit dhe administrimit të shërbimit arsimor në shkollat tona, e në mënyrë të veçantë në menaxhimin e partneritetit shkollë-prindër.
- Njohja e programeve mësimore, metodologjisë së organizimit dhe vlerësimit të cilësisë së procesit mësimor nga ana e prindërve, ndikon në pjesëmarrjen miqësore të fëmijës në shkollë dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të arritjeve shkollore të tij.

#### 1.4 Objektiva të studimit:

Studimi përmes analizës së përvojës aktuale të drejtimit e menaxhimit të institucioneve shkollore dhe karakteristikave që evidencohen në komunitetet prindërore të shkollave tona, synon të identifikojë jo vetëm shkallën e vështirësive që kanë prindërit për të kontribuar në nxënien e fëmijës, por edhe të evidentojë aspektet në të cilat duhet orientohet menaxhimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit të shkollës me prindërit.

1. Të vlerësoje sa e njohin prindërit kompetencën e themelore të komunikimit në gjuhën amtare dhe a i njohin ata treguesit e suksesit të kësaj kompetence.
2. Të vlerësojë sa e njohin prindërit kompetencën e themelore Matematikore dhe a i njohin ata treguesit e suksesit të kësaj kompetence.
3. Të tregojë nivelin e njohjes që prindërit kanë për programet lëndore dhe sa i referohen ata programit lëndor në procesin mësimor që ata organizojnë në familje.
4. Të evidencojë nivelin e vështirësive që prindërit paraqesin në aspektet metodike të procesit mësimor që ata organizojnë në familje.
5. Të mase nivelin e besimit që kanë prindërit në vlerësimin e arritjeve të nxënësit nga mësuesit.
6. Të vlerësojë metodikën që zbatojnë shkollat për njohjen e programeve lëndore nga prindërit dhe veçanërisht të treguesve të suksesit të kompetencave që zhvillohen në shkollë.
7. Të evidencojë diferencat në *vlerësimin* e arritjeve që kanë prindërit dhe mësuesit dhe të tregojë që këto diferenca janë ndër shkaktarët që ndikojnë cilësinë e performancës së nxënësit në shkollë.
8. Të pohojë domosdoshmërinë e ndërtimit të metodologjive profesionale në nivel shkollë dhe sistemi arsimor, të cilat mundësojnë, jo vetëm përfshirjen e prindërve në jetën e shkollës, por *angazhimin* e tyre të drejtpërdrejtë dhe efektiv në realizmin cilësor të kurrikulave lëndore në ciklin fillor të edukimit.

## 1.5 Rëndësia e studimit

Studimi adresohet në rritjen dhe zhvillimin e faktorëve potencial që ndikojnë përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit në edukim. Edukimi përfaqëson interesin më të lartë për individin dhe shoqërinë në tërësi. Përfshirja dhe kontributi i prindërve në progresin akademik dhe jo vetëm të fëmijëve, përcaktohet nga ana e mësuesve dhe drejtuesve të shkollës si i domosdoshëm. Nga ana tjetër, prindërit *pohojnë* një gatishmëri të lartë për të mbështetur fëmijët e tyre në procesin e edukimit në shkollë dhe jashtë saj, e shprehur kjo në arritjet shkollore.

Studimi adresohet në partneritetin shkollë-familje, dhe si i tillë është në mbështetje të plotë me nismat dhe politikat arsimore që i janë adresuar shkollës në këto vitet e fundit dhe që synojnë rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të shërbimit arsimor të ofruar nga ata.

Duke ju referuar konsideratës dhe gatishmërisë që shprehin prindërit dhe mësuesit për domosdoshmërinë e bashkëpunimit të tyre në funksion të arritjeve shkollore të nxënësve, studimi merr një rëndësi të veçantë, pasi synon të ofrojë për ato një qasje konkrete dhe të strukturuar në drejtim të promovimit dhe zhvillimit të një bashkëpunimi të qëndrueshëm ndërmjet këtyre dy aktorëve. Studimi merr një rëndësi të veçantë për *prindërit*, pasi synon t'i mbështesë ata në organizimin e procesit mësimor që ata zhvillojnë në familje me një metodike sa më profesionale në pikëpamjen pedagogjike, sa më të sistemuar dhe sa më koherente me atë të shkollës. Në këtë aspekt, studimi synon të paraqesë një mundësi të shtuar për aftësimin e prindërve në identifikimin e suksesit të arritur, por në mënyrë të veçantë në identifikimin e suksesit të munguar dhe/ose dështimit dhe organizimin metodik të procesit për kapërcimin dhe përmirësimin e tij.

Studimi synon të jetë në funksion të plotë të mësuesit. Raporti i mësuesit me prindin/rit është tipik në shkollë dhe mjaft intensiv, sidomos gjatë viteve të para të shkollimit. Mësuesit në këtë studim do të gjejnë një qasje me shumë për zhvillimin e bashkëpunimit me prindërit. Kjo qasje synon të jetë konkrete, duke u adresuar drejtpërdrejtë në aspekte akademike, sikundër janë kompetencat *themelore të komunikimit dhe ato matematikore*, të cilat janë ndër më të rëndësishmet në këto vite të para të shkollimit dhe shumë të rëndësishme për t'u njohur e trajtuar nga prindërit në mënyrë të unifikuar me procesin që zhvillohet në shkollë. Mbështetja e prindërve në drejtim të njohjes sa më të plotë të kurikulës dhe zhvillimit sa më profesional të saj, do t'i kthejë ato (prindërit), nga shkaktar të cenimit të cilësisë, në faktor të arritjes së saj.

Studimi merr një vlerë të veçantë për drejtuesit e shkollave. Njohja e mundësive, vështirësive dhe nivelit të gatishmërisë së prindërve për përfshirjen dhe sidomos angazhimin e tyre në procesin e edukimit, do t'i ndihmojë ato për një planifikim dhe administrim më efikas të këtij partneriteti.

Studimi synon të përfshihet edhe në interesin e institucioneve politkëbërëse, si të nivelit vendor ashtu dhe në atë qendror. Njësitë arsimore vendore (DAR/ZA) dhe Ministria e Arsimit, mund të konsiderojnë gjetjet dhe rekomandimet e këtij studimi dhe ti formësojnë ato në instrumente jo vetëm normative, por edhe metodologjike të cilët do të ndihmojë institucionet tona shkollore në përdorimin efektiv të potencialeve edukative të prindërve dhe në tregues konkret të performancës së punës së punonjësve arsimorë në shkolla.

Nevoja për ridimensionimin e përvojës aktuale të partneritetit shkollë-familje në institucionet tona shkollore, që paraqitet në këtë studim, përbën një qasje që mund të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të debatit profesional në fushën e edukimit. Kësisoj, mendojmë se studimi mund të jetë interesant për specialistët dhe kërkuesit e interesuar në këtë aspekt.

## **1.6 Përkufizime:**

Konceptet kryesore të trajtuara në këtë punim, janë referuar në kontekstet dhe në kuptimet përkatëse, si vijon:

*Cilësia e edukimit:* Në kontekstin e temës së trajtuar në këtë studim, Edukimi dhe cilësia e tij përcaktohet si cilësia e faktorëve dhe aktorëve që përfshihen në shërbimin arsimor. Këto faktorë dhe aktorë janë: Nxënësit, Mjediset (në kuptimin infrastrukturor), Përmbajtja, Procesi, Rezultatet dhe Reagimi. (UNICEF.2000. Defining Quality in Education.)

*Partneriteti shkollë-familje:* përcaktohet si marrëdhënia që krijon dhe zhvillon shkolla me komunitetin e saj prindëror, qoftë në aspektin kolektiv, ashtu dhe atë individual. Ky partneritet zhvillohet në dy aspekte tipike; në terma të menaxhimit të institucionit shkollor dhe në terma të cilësisë së shërbimit të përfituar.

*Prindërimi:* tipologjitë dhe modelet që demonstrojnë dhe synojnë të adoptojnë prindërit në raport me fëmijët gjatë edukimit në tërësi dhe të mësuarit në veçanti. Veprimtaritë që ndërmerren nga shkolla me synim aftësimin e familjes për të kuptuar karakteristikat e zhvillimit në faza dhe etapa të ndryshme, p.sh në fëmijëri dhe adoleshencë.

*Treguesit e suksesit:* karakteristikat e cilësisë së përmbushjes së detyrave të demonstruara nga nxënësit në procesin e të mësuarit.

*Kurrikula:* tërësia e materialeve mësimore të tilla si, plani mësimor, programi mësimor, teksti dhe mjete të tjera mësimore të një lënde apo fushe të nxëni, si dhe e tërë veprimtaria e organizuar në mjedisin e të mësuarit që siguron arritje të caktuara të nxënësit.

*Kompetencë themelore:* ndërthurja e dijeve, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave që u nevojiten nxënësve për zhvillim vetjak, qytetarinë aktive, përfshirjen shoqërore dhe punësimin.

*Përfshirje në edukim* Përfshirja trajtohet më së shumti si marrëdhënia që ka prindi me shkollën dhe veprimtaritë e saj. Përfshirja e prindërve fokusohet kryesisht në aspektin e menaxhimit dhe administrimit të institucionit arsimor

*Angazhimi në edukim:*, Angazhimi përcaktohet si roli dhe përmasa e angazhimit të prindit në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e të nxënit të fëmijës së tij. Ndërsa përfshirja demonstron në shkollë, angazhimi demonstron në shkollë, por në mënyrë tipike në shtëpi.

*Të mësuarit në shtëpi:* adresohet në përfshirjen e familjes, të njërit ose të dy prindërve me fëmijët e tyre në aktivitete në funksion të nxënies, ku përfshihen, krijimi i mjedisit të të mësuarit, si dhe mbështetja konkrete dhe specifike në realizimin e detyrave të shtëpisë dhe aktivitete të tjera të krikllës.

*Punonjës mësimor;* mësuesit dhe drejtuesi e institucioneve shkollore

## **1.7 Kufizimet e studimit**

Studimi ka këto kufizime:

- Për arsye objektive, popullata e prindërve të përdorur në realizimin e këtij studimi është kufizuar vetëm në qytetin e Tiranës.
- Shkalla e përfaqësimit të çdo individi/prindi sipas shtresave (stratat) të nivelit të jetesës/zhvillimit, nuk është e njëjtë. Kjo sepse; zona banuese e familjes së nxënësit identifikohet me vendndodhjen e shkollës. Databasa kombëtare dhe rajonale e mbledhjes së informacionit statistikor të arsimit, krijohet në bazë shkolle dhe jo në bazë nxënësi.

- Krijimi i një data basë për rreth 35.000 nxënës të ciklit të ulët të shkollave të Qytetit të Tiranës, me informacionin mbi vendndodhjen e familjeve të nxënësit, del jashtë mundësive konkrete të realizimit.
- Mos përfshirja e nxënësve që ndjekin shkollat në institucionet të arsimit parauniversitar. Mos përfshirja e tyre erdhi për shkak të hezitimit dhe mungesës së gatishmërisë së drejtuesve të këtyre institucioneve.
- Nivel jo i njëjtë perceptimi i përgjigjeve të strukturuar në pyetjet e pyetësorit. P,sh; Jo të gjithë kemi të njëjtin perceptim kur themi që arritjet e nxënësit janë të mira. Dikush mund ta identifikojë këtë nivel me notën 8, e dikush tjetër me notën 9.

### 1.8 Organizimi i studimit

Studimi, në tërësinë e tij është organizuar në kapituj të veçantë dhe konkretisht në: *Hyrje, Shqyrtimi i literaturës, Metodologjia, Gjetjet e studimit, Diskutimi dhe së fundmi, Përfundimet dhe rekomandimet.*

Në kapitullin e parë, Hyrje, përmes çështjeve përkatëse të trajtuara në këtë kapitull, është synuar paraqitja dhe njohja e lexuesit me; temën dhe problemin e trajtuar nga studimi, qëllimin e studimit, hipotezën dhe objektivat e tij, rëndësinë e studimit, përkufizimet dhe kuptimin e fjalëve dhe koncepteve kryesore të trajtuara, si dhe kufizimet të studimit.

Në kapitullin e dytë, *shqyrtimi i literaturës*, është synuar gjithashtu të paraqitet për lexuesin një përmbledhje e kontributit dhe debatit profesional që është krijuar për këtë tematikë nga kërkues dhe autorë të ndryshëm shkencor, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Në këtë kontekst, paraqiten qasjet, përkufizimet, modelet dhe interpretimet teorike të krijuara nga debati profesional.

Një tjetër këndvështrim i këtij kapitulli, ka synuar që krahas shqyrtimit të bibliografisë dhe studimeve shkencore, të shqyrtohen dhe të paraqiten edhe nisma, politika arsimore dhe modele rregullative/normative të cilat synojnë ndërtimin dhe rritjen e efektivitetit të partneritetit të shkollës me prindërit dhe që aktualisht janë ndërmarrë dhe po implementohen në vende të ndryshme të rajonit dhe me gjerë.

Metodologjia e përdorur përfaqëson një tjetër kapitull të këtij studimi. Në këtë kapitull evidencohet metodologjia e përdorur, instrumentet, teknikat dhe burimet e përdorura për mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e tyre.

Në kapitullin Gjetjet e studimit, paraqiten rezultatet dhe gjetjet e rezultuara nga mbledhja dhe përpunimi i të dhënave. Në këtë kapitull paraqiten karakteristika të popullatës së studiuar, si dhe raportohen rezultatet e aspekteve të vëzhguara dhe analizuar të procesit mësimor që organizohet si në institucionet shkollore, ashtu dhe në familje. Përkatësisht për këto aspekte paraqiten rezultatet për kompetencat akademike të vëzhguara, niveli i njohjes së programeve lëndore dhe aspekte organizative dhe metodologjike të organizimit të procesit mësimor në familje.

Gjithashtu, në këtë kapitull paraqiten edhe gjetjet e rezultuara nga analizimi i politikave dhe nismave normative që janë ndërmarrë dhe kanë synuar mbështetjen profesionale të zhvillimit të marrëdhënieve shkollë-familje në vendin tonë.

Në kapitullin Diskutimi, paraqiten interpretimet dhe qëndrimet e autorit të këtij studimi, lidhur me rezultatet dhe gjetjet e evidencuara nga përpunimi dhe analizimi i të dhënave të përpunuara dhe literaturës së shqyrtuar. Gjithashtu, në këtë rubrikë paraqitet edhe qasja e autorit të studimit, mbi nevojën e konsiderimit të angazhimit të prindërve në edukim si një aspekt apo nën-fushë e veçantë e partneritetit shkollë-familje dhe sugjerimi metodologjik për mbështetjen në mënyrë të standardizuar të kësaj nën-fushe.

Në kapitullin, Përfundimet dhe rekomandime, paraqiten konsideratat dhe konkluzionet e arritura nga ky studim. Ndërsa, si Rekomandime, paraqiten qasjet, si dhe rekomandimet që adresohen si për vendimmarrësit në nivel institucional dhe/ose sistemi, ashtu dhe në aspektin metodologjik që planifikohet dhe zbatohet në institucionet shkollore kundrejt efektivitetit të marrëdhënies së shkollës me prindërit.

## KAPITULLI I DYTË

### 2. SHQYRTIMI I LITERATURES

Përfshirja dhe bashkëpunimi i shkollës me prindërit, po shfaqet gjatë dekadave të fundit me një intensitet gjithnjë e më të madh në diskutimet e bashkësisë profesionale të edukimit. Autorë të ndryshëm, në këndvështrimet dhe realitete të ndryshme që ata përfaqësojnë, po e paraqesin partneritetin shkollë-familje si një aspekt kompleks dhe shumë dimensional, jo vetëm për sigurimin e shërbimit arsimor, por edhe për përmirësimin e cilësisë së tij. Muller (2009) pohon se; Partneriteti shkolle-familje-komunitet po ridimensionon kufijtë dhe funksionet e edukimit si përvojë. Ky bashkëpunim zgjeron kapacitetet e prindërve dhe komunitetit, duke krijuar kushte që fëmijët të jenë më efektiv në të nxënë.

Nga shqyrtimi i literaturës së huaj mbi partneritetin e shkollës dhe familjes, evidencohen trajtimet që lidhen me përkufizimet dhe qartësimet e koncepteve të tilla si; edukimi, komuniteti, pjesëmarrja e komunitetit në edukim, prindërimi dhe tipet e tij, mjedisi edukativ në familje etj., si dhe karakteristikave të ndryshme të aspekteve që përfaqëson kjo tematikë.

Lidhur me përkufizimet, rezulton se në kontekstin e partneritetit shkollë/familje, sipas UNICEF 2000, *Edukimi* përcaktohet si një veprimtari e cila përkundrejt këtij partneriteti, shfaqet në gjashtë dimensione:

- nxënësit,
- mjediset,
- përmbajtja,
- procesi,
- rezultatet dhe
- reagimi.

Ndërsa *komuniteti dhe pjesëmarrja* e tij në veprimtarinë e shkollës, mund të përcaktohet për nga karakteristikat që ndajnë anëtarët e tij. Këto karakteristika i referohen kulturës, gjuhës, besimit, gjeografisë, klasës dhe racës. Shaeffer (1992), argumenton se komunitetet janë homogjene dhe heterogjene, disa dallohen për bashkimin e tyre, disa të tjera për konfliktualitetin e tyre.



Struktura e komunitetit, sipas Zenter (1964), shfaq tre aspekte:

1. Struktura e grupit, e cila mund të jetë formale dhe informale dhe luan rol në problemet dhe qëllimet e përbashkëta.
2. Identifikimi kolektiv dhe
3. Shkalla e autonomisë dhe raporti që komuniteti ka me përgjegjësitë e përbashkëta.

Ndërsa, lidhur me *Përfshirjen* e komunitetit në edukim në përgjithësi dhe financimin në veçanti, Braj (1996), në studimin e tij paraqet tre tipe të komunitetit:

1. Komunitet gjeografik; i cili klasifikohet nga njëjtësia rezidenciale e anëtarëve të tij, siç mund të jenë komunitetet në fshat, apo ato në qytet etj.
2. Komunitet i tipit etnik; që përcaktohet apo identifikohet nga raca dhe përkatësia e besimit fetar të tyre.
3. Komunitete që identifikohen nga marrëdhënia që kanë me edukimin dhe çështjet e tij; siç janë organizatat, shoqatat etj., që veprojnë në këtë fushë.

Marrëdhënia e prindërve me shkollën si institucion dhe të mësuarin si përvojë, nuk shfaqet me një përcaktim apo përkufizim të vetëm. Ndër shumë autorë, por edhe politikbërës kjo marrëdhënie shfaqet herë si *angazhim*, herë si *përfshirje* dhe herë si *pjesëmarrje* e prindërve. Kjo papërcaktueshmëri, mendoj se vjen si rezultat i analizës së karakteristikave që vëzhgohen dhe evidencohen në profilin e marrëdhënies së prindit në shkollë dhe profilin që shfaq prindi në familje kundrejt procesit të t'nxënimit. Megjithatë, literatura e konsultuar nënvizon një diferencë ndërmjet konceptit të *përfshirjes* së prindërve dhe atij të *angazhimit* të tyre. Përfshirja trajtohet më së shumti si raporti që ka prindi me shkollën dhe veprimtarinë e saj, kryesisht menaxheriale, ndërsa angazhimi shfaqet më i drejtpërdrejtë në të mësuarin si proces. Pra, ndërsa përfshirja e prindërve në veprimtarinë e shkollës ka një funksion të rëndësishëm komunitar dhe social, angazhimi i tyre në të mësuarin në shtëpi ndikon dhe pasqyrohet në mënyrë direkte në cilësinë e arritjeve akademike të nxënësit.

Sipas Emerson, L., Fear, J., Fox, S., & Sanders, E. (2012), angazhimi i prindërve ndikon në rritjen e vetëdijes mbi avantazhet dhe përfitimet që sjellë përfshirja e tyre në edukimin e

fëmijëve dhe që u mundëson atyre të pasurojnë përvojat dhe aftësitë në mbështetjen dhe ndihmën që ata u japin fëmijëve.

Ndërsa, Jensen, K., Joseng, F., Jose Lera, M. (2007), duke u bashkuar me konsideratën se prindërit janë një burim shumë i rëndësishëm për fëmijët e tyre, dallojnë tre faktorë që kushtëzojnë efektivitetin e implikimit të prindërve: Së pari- *Kuptimi*, prindërit kuptojnë arsyet dhe rëndësinë se përse ata duhet të mbështesin fëmijët e tyre në procesin e të mësuesit. Së dyti- *Ndikimi*, prindërit e ndjejnë dhe dallojnë, që ndihma e tyre ka ndikuar në suksesin e fëmijës në shkollë dhe së treti- *Mbështetja*, prindërit e konsiderojnë gatishmërinë e shkollës dhe veprimtarinë e tyre që e mbështesin në këtë bashkëpunim.

Sipas Seafer (1994), pjesëmarrja/përfshirja e prindërve në jetën e shkollës, shfaqet si:

- pjesëmarrje formale,
- jo formale,
- aktive dhe pasive,
- direkte dhe jo direkte.

Seafer e përcakton pjesëmarrjen si *formale*, për rastet kur prindërit plotësojnë një detyrim të caktuar për përfitimin e shërbimit arsimor, siç është p.sh regjistrimi i fëmijëve në shkollë.

Ndërsa, përfshirja *jo formale* e prindërve, konstatohet në rastet e shkëmbimit dhe përfitimit të shërbimeve të caktuara që shkolla kryen me prindër të shkollës, por që natyra e këtij ndërveprimi lidhet me nevoja apo shërbime të caktuara të shkollës.

Përfshirje *direkte*, përmes kontributit në vlera financiare apo kontribute të ndryshme. Përfshirja direkte, shfaqet dhe konsiderohet si e tillë, në ato raste kur prindërit gëzojnë të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjet e shkollës. Përfshirje *pasive*, kur prindërit marrin pjesë në mbledhje të ndryshme të shkollës dhe nuk ndikojnë apo marrin pjesë në vendime. Dimensioni aktiv apo pasiv i pjesëmarrjes së prindërve, evidencohet edhe në aspektet e planifikimit dhe sidomos të realizimit të veprimtarive mësimore apo kurrikulave të shkollës. Përfshirja e prindërve në jetën e shkollës dhe pjesëmarrja e tyre në aktivitetet e shkollës dhe vendimmarrjet e saj, është mjeti më i përshtatshëm për ndërtimin e qëllimeve të përbashkëta dhe praktikave të

koordinuara kundrejt konteksteve specifike të familjes dhe shkollës si partneritet (*Parent participation in the life of schools in South East Europe 2010*).

Pjesëmarrja e prindërve në shkollë është gjithashtu një mekanizëm i përgjegjshëm dhe demokratik që duhet ndjekur si një vlerë udhëheqëse dhe drejtuese nga shkolla, por studimet, gjithashtu tregojnë se angazhimi i prindërve është në vetvete edhe një parashikues i fortë i arritjeve akademike të fëmijës, dhe ndikimi i saj në masë të madhe tejkalon ndikimin e statusit socio-ekonomik mbi arritjet arsimore të nxënësve Jeynes,W.(2014).

Mjakëll Fullan në librin e tij “Kuptimi i ri për ndryshimin”,(2002) thekson se; Sa më afër t’i qëndrojnë prindi shkollimit të fëmijës së tij, aq më i madh do të jetë ndikimi në zhvillimin dhe arritjet shkollore të fëmijës. Më tej, ky autor thekson se; *Prindërit dhe anëtarët e tjerë të bashkësisë janë burime të rëndësishme dhe në përgjithësi të pashfrytëzuara, të cilët kanë vlerat dhe ekspertizën për partneritetin.*

Për efektivitetin e partneritetit ndërmjet shkollës dhe komunitetit dhe në mënyrë të veçantë të aksionit/nërveprimit ndërmjet prindërve, nxënësve dhe mësuesve, Fullan (2002) thekson se *..duhet zhvillimi i njëkohshëm i shkollave dhe bashkësive të saj.*

## **2.1 Prindërimi, modelet dhe karakteristikat**

Prindërimi dhe modelet e prindërimit është një tjetër aspekt i trajtuar nga autorë të ndryshëm. Një ndër më të cituarit është korniza me gjashtë tipet e përfshirjes së prindërve, Epstein (2001).

Sipas kësaj kornize, tipet e përfshirjes janë:

1 *Prindërimi*, sipas të cilit veprimtaritë që ndërmerren nga shkolla synojnë aftësimin e familjes për të kuptuar karakteristikat e zhvillimit në faza dhe etapa të ndryshme, p.sh në fëmijëri dhe adoleshencë. Mbështetjen e familjes në ndërtimin e përshtatshëm të mjedisit në shtëpi për të mësuarin në çdo nivel. Të mbështesë shkollën të kuptojë familjen.

2 *Komunikimi*, sipas të cilit, veprimtaritë në këtë kontekst, synojnë komunikimin me familjen për programet shkollore dhe progresin e nxënësit përmes komunikimit efektiv shkollë familje-shkollë.

3 *Vullnetarizmi*, veprimtaritë e së cilës, adresohen në përmirësimin e trajnimit, kualifikimit dhe përfshirjes së prindërve si vullnetarë në mbështetje të nxënësve dhe programeve të shkollës.

4 *Të mësuarit në shtëpi*, adresohet në përfshirjen e familjes me fëmijët e tyre në aktivitete në funksion të nxënies ku përfshihen detyrat e shtëpisë dhe aktivitete të tjera të kurikulës.

5 *Vendimmarrja*, përfshin familjen si pjesëmarrës në vendimet e shkollës, drejtimit dhe administrimit të saj përmes organeve të tilla si këshilla, komitete dhe forume të prindërve.

6 *Bashkëpunimi me komunitetin*. Koordinimi me agjenci dhe subjekte të biznesit, i resurseve dhe shërbimeve për familjen, nxënësit dhe shkollën dhe ofrimi i shërbimeve për komunitetin.

Një tjetër kornizë që i referohet partenritetit të shkollës dhe familjes, është Korniza Australiane e Partneritetit Familje Shkollë (Deewer 2008), e cila është hartuar nga bashkëpunimi i Këshillit Australian i Organizatave të Shkollave Shtetërore, Këshillit të Prindërve dhe qeverisë Australiane. Dimensionet e kësaj kornize dhe karakteristikat kryesore të saj janë:

1 *Komunikimi*: Ky dimension thekson se komunikimi efektiv ka si karakteristika: të qenët aktiv, personal, frekuent, i përshtatshëm në aspektin kulturor dhe i hapur ndaj nevojave dhe karakteristikave të familjes. Është një raport i dyanshëm i fokusuar jo vetëm në shkëmbimin e informacionit, por edhe në mundësi për shkollën dhe familjen për të ndërvepruar dhe mësuar nga njëra tjetra. Kjo kornizë qartëson dhe konsideron faktin që familjet janë partnerë të veçantë, unik për nga karakteristikat dhe që ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve të vogla.

2 *Lidhja ndërmjet të mësuarit në shtëpi dhe në shkollë*: thekson si nevojë të kuptuarin ndërmjet shkollës dhe familjes për : mbivendosjen e mjedisit familjar të të mësuarit me atë të shkollës. Lidhjen ndërmjet partenritetit të suksesshëm dhe të mësuarit e fëmijës, ku theksohet rëndësia dhe pritshmëria e lartë e të dy aktorëve, prindërve dhe shkollës për suksesin e fëmijës në shkollë. Rëndësinë e bashkëpunimi të shkollës dhe familjes për të krijuar qasje pozitive tek fëmija ndaj eksperiencës së të mësuarit dhe bashkëpunimin në vendimmarrjet që i adresohen progresit të fëmijës.

3 *Ndërtimi i komunitetit dhe identitetit:* thekson aktivitetet që ndikojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet, siç janë; respektimi i kulturës/ve, traditave, vlerave dhe bashkëjetesës në komunitet dhe që veprimtaritë e shkollës përfshijnë aspektet të zhvillimit social, emocional, moral dhe shpirtëror të nxënësve. Shkolla përfaqëson një mundësi reale për prindërit për të qenë së bashku dhe për të kontribuar në ngritjen e kapaciteteve, ndarjen dhe promovimin e vlerave të përbashkëta.

4 *Njohja e rolit të familjes:* Ky dimension konsideron faktin që edukatorët e parë të fëmijëve janë prindërit dhe roli i tyre ka një influencë të madhe në qëndrimet dhe arritjet e fëmijës në shkollë. Ajo mund të inkurajojë fëmijët për të mësuar në shkollë dhe jashtë saj dhe të mbështesë shkollën në arritjen e qëllimeve dhe ethosit të saj. Prindërit kërkojnë nga shkolla të ofrojë mjedis të sigurtë për fëmijët.

5 *Konsultimi i vendimmarrjes:* Konsideron faktin që prindërit gëzojnë të drejtën të konsultohen nga shkolla për problemet që lidhen me fëmijët e tyre. Përfshirja e prindërve në vendimmarrje, ka në themel ndarjen e përgjegjësiave që ka shkolla me prindërit dhe komunitetin, si dhe ushtrimin e përbashkët të tyre.

6 *Bashkëpunimi përtej shkollës:* Ky dimension thekson identifikimin, vendosjen dhe integrimin e burimeve që mbart komuniteti që forcojnë dhe mbështesin shkollën, nxënësit dhe familjet e tyre dhe anasjelltas. Duke nënvizuar kështu intensitetin dhe qëndrueshmërinë e marrëdhënieve të shkollës me familjen/et.

7 *Pjesëmarrja:* është dimensionin që thekson që koha, energjia dhe ekspertiza e familjes mund të mbështesin programet e shkollës në shumë mënyra dhe të gjitha kontributet e saj janë të vlefshme. Këtu mund të përfshihet: puna me nxënësit në aktivitetet e trajtuara në mësim/klasë, pjesëmarrja në aktivitete të tjera, jashtë saj..etj. Pjesëmarrja në aktivitetet jashtë-shkollore, mbështetja dhe vlerësimi i mësuesve, sigurimi që përfshirja/angazhimi i prindërve është një çështje e njohur e takimeve të stafit dhe aspekt i zhvillimit të saj profesional.

## 2.2 Prindërimi, stilet dhe karakteristikat;

**Stile të prindërimit:** modelet e përcaktuara nga psikologia D.Baumrind (1971, 1991) evidencohen, si ndër modelet më të referuara nga literatura në këtë aspekt. Modelet e identifikuar nga Baumrind, bazohet në dy aspekte të sjelljes së prindërve:

- *Kontrolli*, i cili i referohet mënyrës se si prindërit përballojnë dhe menaxhojnë sjelljet e fëmijëve të tyre.
- *Ngrohtësia prindërore*, i referohet shkallës me të cilën prindërit shfaqen miratues dhe responsiv ndaj sjelljes së fëmijëve të tyre.

Ndërveprimi i prindërve, përkatësisht në këto dy kontekste, evidencën katër stile të prindërimit, të cilat janë:

1. *Stili autoritativ*. Prindërimi i kategorizuar në këtë stil, dallon për inkurajimin që prindërit i bëjnë fëmijëve për të qenë të pavarur, por duke zhvilluar dhe aftësinë e mbajtjes së kontrollit në veprimet e tyre. Ata dëshmojnë të gatshëm për të dëgjuar dhe biseduar mbi këndvështrimet e fëmijëve, duke zhvilluar diskutimin dhe debatin. Fëmijët e rritur nën këtë model prindërimi, mësojnë dhe aftësohen të negociojnë dhe të përfshihen në diskutime. Ata kanë më shumë mundësi për të zhvilluar kompetencat sociale, pavarësinë dhe përgjegjshmërinë.
2. *Stili autoritarian*. Shfaq ngrohtësi më të kufizuar dhe nivel më të lartë kontrolli. Prindërit e këtij modeli/stili dallohen për disiplinë, masa shtrënguese dhe ndëshkuese dhe i imponohen fëmijëve që ata të ndjekin direktivat e prindit. Fëmijët e rritur nën këtë model dhe atmosferë prindërimi, nuk janë të përfshirë në diskutime mbi rregullat dhe standardet e familjes dhe më gjerë dhe ata/fëmijët, janë të detyruar ti pranojnë dhe zbatojnë këto rregulla dhe standard, pa i diskutuar e kundërshtuar ato.
3. *Stili tolerant*. Prindërit e këtij modeli dallojnë për ngrohtësi të madhe, deri të ekzagjeruar ndaj fëmijëve dhe nuk kërkojnë llogari ndaj tyre. Prindërit tolerant nuk “dinë” t`u thonë ‘Jo’ fëmijëve të tyre dhe në këto kushte, fëmijët arrijnë të marrin vendime të rëndësishme pa mendimin dhe dakordësinë e prindërve. Fëmijët e rritur sipas këtij modeli, shfaqin

vështirësi me vetëkontrollin dhe shfaqin egocentrizëm që i ndikon negativisht ata në ndërtimin e marrëdhënieve korrekte me të tjerët.

4. *Prindër të pa përfshirë*. Nuk janë të ngrohtë dhe nuk kanë kërkesa për fëmijët e tyre, ata shfaqen të pa përfshirë në veprimet dhe aksionet e tyre deri në neglizhim të plotë dhe nuk investojnë kohë për prindërimin e tyre ndaj fëmijëve. Fëmijët e rritur nën këtë model prindërimi, kanë vështirësi të administrojnë autokontrollin e tyre në mënyrë racionale.

### **2.3 Menaxhimi i shkollës dhe partneriteti me prindërit**

Gjithashtu, duke ju referuar studimeve të autorëve të ndryshëm, të cilët kanë trajtuar karakteristikat dhe aspektet e përfshirjes së prindërve në veprimtarinë e shkollës, mund të bëhen disa klasifikime të qasjeve apo këndvështrimeve të tyre lidhur me aspektet e kësaj tematike.

Në klasifikimin *e parë*, mund të konsiderohen ato autorë, kërkimet e të cilëve e trajtojnë partneritetin shkollë-familje në kontekstin institucional, pra të cilësisë së menaxhimit të shkollës. Në këto kërkime, nënvizohet rëndësia e përfshirjes së prindërve në vendimmarrjen dhe administrimin e shkollës. Rastet, përvojat dhe modelet e trajtuara në këto kërkime, evidencojnë filozofinë dhe parimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë që duhet të karakterizojnë institucionet shkollore që referohen si modele të suksesshme të menaxhimit. Menaxhimi/drejtimi i shkollave bëhet më i dobët për shkak të përfshirjes së ulët apo të munguar të prindërve në aspektet financiare dhe të vendimmarrjes së saj (Azeem 2010).

Th.Nordahl 2006, paraqet tri lloje të bashkëpunimit ndërmjet shkollës dhe familjes, si dhe karakteristika të tij.

Llojet e bashkëpunimit sipas këtij autori, janë:

- 1) *Bashkëpunim përfaqësues*, që shprehet më nivelin e pjesëmarrjes së prindërve në organizatat e prindërve,
- 2) *Bashkëpunim direkt*, që spikat për takimet e veçanta/personale ndërmjet mësuesve dhe prindërve dhe që rezulton më një `marrëveshje` ose plan të përbashkët veprimi mësues-nxënës-prindër dhe

3) *Bashkëpunim indirekt*, që dallon për veprimet e përditshme që prindërit bëjnë në familje në mbështetje të arritjeve të fëmijës në shkollë.

Ndërsa si karakteristika të bashkëpunimit, ky autor identifikon:

1) Shkëmbimi i informacionit dhe komunikimi, që si tipar kryesor ka dimensionin e njëanshëm apo dyanshëm të komunikimit të shkollës me familjen.

2) Dialogu; për çështje të veçanta dhe të individualizuara për nxënësin dhe 3) Kontributi dhe ndikimi, që buron nga vendimet e përbashkëta të shkollës me prindin.

Tipike në këtë klasifikim janë shkollat e bazuara në komitetin e menaxhimit (School Based Management Cometees), ose shkollat të cilat këtë forum e kanë si Bordi Drejtues i shkollës ose si Shoqatat Prindër-Shkollë. Karakteristikat dhe përparësitë e këtyre modeleve janë trajtuar nga autorë të ndryshëm. Cheng (1996) e shikon këtë model si kërkesë apo detyrë për të mundësuar pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve që përfshihen në procesin dhe veprimtarinë e shkollës, siç janë nxënësit, mësuesit dhe veçanërisht prindërit, të cilët duhet të kenë autonomi në përzgjedhjen dhe përdorimin e burimeve që ka shkolla. Në të njëjtën linjë qëndrojnë edhe Caldwell & Spinks (1988), kur e përcaktojnë këtë model si një sistem drejtimi dhe administrimi të procesit të edukimit, ku një pjesë e madhe e autoritetit dhe përgjegjësisë vendimmarrëse janë të decentralizuara dhe ushtrojnë përgjegjësi për qëllimin, politikën, standardet dhe përgjegjësinë për cilësinë e shërbimit.

Në klasifikimin e *dytë*, mund të konsiderohen ato autorë, kërkimet e të cilëve fokusohen në trajtimin e posaçëm të aspekteve konkrete që evidencohen në procesin e edukimit. Qasjet në këtë kontekst nënvizojnë faktin se përfshirja e prindërve në shkollë, ndikon në:

*Përmirësimin e performancës/arritjeve akademike*: Ndikimi i përfshirjes së prindërve në suksesin shkollor të fëmijëve, evidencohet jo vetëm nga kërkimet shkencore, por ajo po reflektohet dhe po promovohet gjithnjë e më shumë edhe nga politkëbërësit. Kërkimet në këtë aspekt nënvizojnë faktin që, përfshirja e prindërve që në fazat e hershme të edukimit është e lidhur dhe/ose ndikon pozitivisht në performancën shkollore të fëmijës. Fëmijët, prindërit e të cilëve janë më shumë të përfshirë në edukimin e tyre, kanë nivel më të lartë në arritjet shkollore se ato fëmijë, prindërit e të cilëve nuk përfshihen, ose janë të kufizuar në përfshirjen e tyre në edukimin e fëmijëve. Emerson, L., Fear, J., Fox, S., & Sanders, E. (2012), pohojnë se strategjitë



e angazhimit të prindërve kanë një ndikim më të madh në rezultatet shkollore kur referohen dhe konsiderojnë;

- karakteristikat e familjes,
- cilësinë e të kuptuarit të rolit të prindërve dhe mësuesit në procesin e të mësuarit dhe
- cilësinë e marrëdhënieve shkollë-prindër.

Në këtë studim përcaktohet gjithashtu, se faktorët që kontribuojnë në mënyra të ndryshme në rezultatet e nxënësve dhe në të cilat mund të ndërhyhet janë; përvojat dhe qasjet e familjes ndaj edukimit, karakteristikat e nxënësit dhe konteksti komunitar i shkollës.

*Përmirësimin e performancës/arritjeve të sjelljes:* edhe në këtë aspekt, gjithashtu nënvizohet se pjesëmarrja e prindërve ka ndikim pozitiv edhe në performancën sociale dhe atë të sjelljes së nxënësit. Sa më të përfshirë dhe aktiv të jenë prindërit në mbështetje të fëmijës/nxënësit, aq më pozitive do të demonstrohen edhe karakteristikat dhe arritjet e tyre sociale. Sidomos, përfshirja e prindërve merr një rëndësi të veçantë për shkollën në:

- Kapërcimin e barrierave të ndryshme dhe rritjen e kohezionit dhe integritit social-kulturor të nxënësve, por dhe komuniteteve shkollore, tipike kjo për vendet e Evropës perëndimore, Sh.B të Amerikës dhe me gjerë, të cilat janë vende që dallohen dhe synohen për/nga emigracioni.
- Menaxhimin e sjelljeve të rrezikshme të nxënësve.
- Arritjen e potencialit të nxënësve si në aspektin e perceptimit racional të vetes, por edhe të ndërtimit dhe ndërveprimit social të tyre

Qasjet e kërkimeve, që i referohen këndvështrimit të mësuesve për përfshirjen e prindërve, trajtojnë dhe nënvizojnë rolin dhe rëndësinë e komunikimit të shkollës me prindërit duke e trajtuar këtë si “instrumentin” apo mjetin kyç për ndërtimin e partneritetit të shkollë-prindër. Ndërsa, në të tjera kërkime të kësaj perspektive, evidencohen përvojat dhe modelet e veprimtarisë mësimore të prindërve në mjedisin familjar, si dhe konsideratat që kanë ato për faktorët dhe shkaktarët që mbështesin apo pengojnë realizimin e këtij aspekti.

Kërkimet e kategorizuara në klasifikimin e mësipërm, fokusohen në trajtimin e pengesave që identifikohen në përfshirjen efektive si për mësuesit ashtu edhe për prindërit. Studimet në këtë

drejtim, evidencojnë që natyra e pengesave që karakterizojnë prindërit për një pjesëmarrje të suksesshme janë të tilla; mungesë interesi ndaj fëmijës, pa mundësi për t'iu përgjigjur kërkesave të shkollës në këtë drejtim, diferencat kulturore dhe gjuhësore të familjes me shkollën, kompleksi i shfaqjes së nivelit të ulët edukues të prindërve, mungesë njohje dhe informimi mbi bashkëpunimin shkollë-familje, mungesë besimi ndaj shkollës. Ndërsa, natyra e pengesave që evidencohen tek përfshirja efektive e mësuesve është e tillë: Koha e kufizuar, kultura profesionale e mësuesit, përvoja menaxhuese e shkollës, qëndrimi ndaj kritikave të mundshme, paragjykimi dhe pritshmëritë e ulëta ndaj aftësive të prindërve.

## **2.4 Politikat arsimore për partneritetin shkollë-familje**

### **2.4.1 Politika arsimore rajonale dhe partneriteti shkollë-familje**

Përfshirja e prindërve në veprimtarinë e shkollës, pikërisht për shkak të rëndësisë dhe dobishmërisë që ata kanë në suksesin e shkollës, është reflektuar në formën e gjetjeve dhe rekomandimeve globale të institucioneve ndërkombëtare të tilla UNSECO, OECD, UNICEF, OKB, BE, Këshilli i Evropës..etj. që operojnë në fushën e edukimit. Në Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut evidencohet përgjegjësia e prindërve për edukimin e fëmijëve, në kreun 26, pika 3 të kësaj deklaratë, përcaktohet se *prindërit kanë të drejtën të zgjedhin llojin e edukimit që do t'iu jepet fëmijëve të tyre*. UNESCO dhe OECD e përcaktojnë përfshirjen e prindërve në edukimin e fëmijëve që në fazat fillestare.. “si një e drejtë e prindërve dhe njëkohësisht si një detyrë e tyre”. Në raportin e OECD 1997 “Prindërit si partnerë të shkollës”, pohohet se; *kontributi i prindërve ka një rol të rëndësishëm në arritjet shkollë të fëmijës dhe se për këtë arsye është me rëndësi zhvillimi i dialogut dhe bashkëpunimit të shkollës me prindërit në të gjitha nivelet e edukimit, sidomos në vitet e para të edukimit*.

OECD, në Programin e saj Ndërkombëtar të Vlerësimit të Nxënësve (PISA), konstaton se; “nxënësit 15-vjeçarë, prindërit e të cilëve raportojnë se u kanë lexuar libra fëmijëve të tyre në vitet e para të shkollimit, reflektojnë performancë të dukshme kundrejt atyre nxënësve, prindërit e të cilëve nuk kanë vepruar në këtë mënyrë” OECD (2012).

Ndërsa, në strategjinë e BE-së, Europa 2020, mbështetja e prindërimit paraqitet në një dimension relevant edhe pse e integruar në 2 prej 10 prioritetëve, siç janë; reduktimi i braktisjes shkollore dhe përfshirja sociale (prioriteti 9 dhe 10) i kësaj strategjie. Në rekomandimet KE-së nr. 1501 dhe nr.19 të adoptuara përkatësisht në vitin 2001 dhe 2006, përcaktohet se; “ edukimi e shoqëron individin nga fëmijëria deri në moshë madhore dhe se ai është një miksturë faktorësh dhe influencash dhe se familja dhe shkolla janë dy institucionet që mbajnë përgjegjësi para ligjit dhe shoqërisë”. Gjithashtu në këtë rekomandim, nënvizohet nevoja “për të eksploruar dhe mbështetur rrugët që mundësojnë bashkimin e forcave ndërmjet prindërve dhe shkollave dhe kombinimin e përgjegjësive të tyre në funksion të efektivitetit të edukimit”.

Gjithashtu, rekomandimi 19 (2006), i rekomandon qeverive të vendeve anëtare të hartojnë programe dhe politika në nivel lokal për prindërimin pozitiv, të orientuara në arritjen e tre tipeve të objektivave”:

1. Në krijimin e kushteve për prindërimin pozitiv,
2. Heqjen e barrierave të prindërimit pozitiv dhe
3. Promovimi i prindërimit pozitiv përmes zhvillimit të vetëdijes dhe marrja e të gjitha masave për bërjen realitet të tij.

Save the children, konstaton dhe vlerëson se janë të shumta studimet dhe programet që adresohen në rëndësinë që ka prindërimi në ndërhyrjen e hershme dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të fëmijës, por shumë prej tyre nuk fokusohen në përmirësimin e arritjeve në edukim. *Bringing families and school together* (Save the Children 2011).

Shoqata Kombëtare e Prindërve dhe e Mësuesve (NPTA), e cila është themeluar dhe ushtron aktivitetin e saj prej më shumë se 100 vjetësh në ShBA, ka krijuar “Standardet për përfshirjen e prindërve”, të cilat synojnë të orientojnë shkollat se ç’ duhet të bëjnë ato në bashkëpunim me prindërit, me qëllim mbështetjen e nxënësve në suksesin e tyre shkollore.

Standardet e partneritetit shkollë-familje: Tabela 1

	Standardi	Karakteristikat
Standard 1	Gatishmëria dhe mirëpritja e familjeve në komunitetin shkollor	Familja është pjesëmarrës aktiv në jetën e shkollës dhe duhet të ndjehet e mirëpritur, e vlerësuar dhe e lidhur me pjesën tjetër të komunitetit, me stafin e shkollës dhe e njohur me ç`farë mësojnë dhe ç`farë bëjnë në klasë.
Standard 2	Komunikimi efektiv	Familja dhe stafi i shkollës angazhohen për komunikim të rregullt dhe sistematik rreth të mësuarit të nxënësit.
Standard 3	Mbështetja e suksesit të nxënësit	Familja dhe stafi i shkollës bashkëpunojnë në mënyrë të qëndrueshme për të mbështetur të mësuarin nga nxënësi dhe zhvillimin e shëndetshëm të tij. Shkolla mbështet fuqimisht prindërit për ta bërë sa më sipër në mënyrë efektive.
Standard 4	Komunikimi për çdo fëmijë/nxënës	Shkolla mbështet prindërit që të informohen dhe të jenë të sigurtë që fëmijët trajtohen në mënyrë profesionale dhe kanë akses të plotë ndaj mundësive të të mësuarit.
Standard 5	Ndarja e pushtetit	Familja dhe shkolla janë partnerë të barabartë në vendimmarrjet që prekin nxënësin dhe së bashku punojnë për informimin e ndërsjellët, ndikimin/et dhe në hartimin e programeve të këtij qëllimi.
Standard 6	Bashkëpunimi me komunitetin	Familjet dhe stafi i shkollës bashkëpunojnë me pjesëtarë të komunitetit me qëllim që të lidhin nxënësit, familjet dhe stafin për zgjerimin e oportuniteteve të të mësuarit, shërbimet komunitare dhe pjesëmarrje civike.

#### **2.4.2 Politikat arsimore lokale për partneritetin shkollë-familje.**

Nga shqyrtimi i përvojave të krijuara në disa vende të Evropës, lidhur me ngritjen dhe mbështetjen e strukturuar të prindërimit, rezulton se politikat e prindërimit janë të integruar dhe kanë synuar që të krijojnë oportunitetet për zhvillimin e këtij aspekti, jo vetëm nga institucionet që ushtrojnë përgjegjësinë publike, por edhe nga subjektet që zhvillojnë partneritete të caktuara me institucionet shkollore, siç janë NGO të ndryshme. Gjithashtu, karakteristikë e politikave të prindërimit të këtyre vendeve, është fakti se ky aspekt trajtohet dhe mbështetet me një qasje të integruar dhe që përfaqësohet në politikat që i adresohen familjes në aspekte të ndryshme të saj. Në këtë kontekst, prindërimi fokusohet në; *mbrojtjen e fëmijës, mirëqenien shëndetësore, në mirëqenien ekonomike dhe në mirëqenien sociale të tij*, ku dhe më së shumti evidencohet edhe aspekti pedagogjik i prindërimit. Kështu, në Bullgari ka një numër të lartë NGO dhe grupe të veçanta interesi që veprojnë dhe mbështesin zhvillimin e modeleve të prindërimit. Fokusi kryesor i veprimtarisë së tyre është mbrojtja dhe trajtimi i fëmijëve në risk.

Prej vitit 2010, Bullgaria ka ndërmarre nismat për hartimin e instrumenteve ligjore që mundësojnë pjesëmarrjen e prindërve në zhvillimin personal të fëmijëve dhe jo vetëm trajtimin e tyre si subjekt i mbrojtjes.

Në Kroaci, mbështetja e prindërve në zhvillimin tërësor të fëmijës, shfaqet gjithashtu si një nismë dhe politikë e re, (që pas vitit 2000). Prej më shumë se 10 vitesh, në Kroaci janë adoptuar disa strategji, programe dhe protokolle që kanë në qendër mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijës. Dalluese për këtë vend, është prania e organizmave dhe subjekteve kombëtare (19 family centres) dhe sidomos lokale, që në baza vullnetare ofrojnë shërbime për familjen/prindërit në dimensionin e informimit dhe aftësimin të tyre në mbështetjen e zhvillimit të fëmijës dhe progresit të tyre në edukim.

Në Republikën Çeke politikat e prindërimit janë të fokusuara në mirëqenien e fëmijës, ndërsa lidhur me progresin shkollor të tyre, janë ngritur shumë qendra të këshillimit pedagogjik dhe psikologjik.

Estonia, mbështetjen dhe zhvillimin e prindërimit e ka përfshirë në planin/programin kombëtar të veprimit të qeverisë (Action Plan) 2010-2020, ku ndër të tjera, shkolla identifikohet si një aktor dhe partner i rëndësishëm për mbështetjen e prindërve, veçanërisht në performancën

shkollore të fëmijës. Në këtë kontekst, evidencohen se ka disa programe të zhvillimit dhe trajnimit të shkollave për efektivitetin e partneritetit të shkollave me familjen, ku me tipiku është programi i tre P-ve (Positive Parenting Programme).

Italia paraqet një rast më të qartë të rregullimit normativ të përfshirjes dhe të të drejtave të prindërve në shkollë, si në aspektin menaxhues ashtu dhe në atë të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës. Përfshirja e të gjithë aktorëve në procesin e edukimit të fëmijës, përfaqëson një ndër tre kolonat e sistemit të edukimit. Mbi këtë bazë normative është ngritur edhe përfshirja e institucionalizuar e prindërve në nivel shkolle, rajoni dhe atë kombëtar, ku kjo e fundit AoNAGS (Forum Nazionale delle Associazioni dei Genitori della Scuola) është e njohur zyrtarisht nga Ministria e edukimit dhe një ndër qëllimet e së cilës është ofrimi i këshillimit për prindërit lidhur me cilësinë e shërbimit që ata përfitojnë.

Maqedonia paraqet një rast, gjithashtu të rregulluar në pikëpamjen normative. Ligji për arsim fillor konsideron përfshirjen e prindërve dhe bashkëpunimin e shkollës me to, si dhe një sërë të drejtash të tyre. Në administrimin e shkollës, prindërit marrin pjesë në forumin “Këshilli i shkollës” të cilëve u njihen disa të drejta/kompetenca administruese të shkollës, ndërsa në pikëpamjen e performancës akademike të shkollës/nxënësve, prindërit marrin pjesë në “Këshillin e prindërve”. Gjithashtu, ky ligj përcakton se, bashkëpunimi i mësuesit me prindërit, është një ndër *detyrat* e mësuesit dhe prindit i njihet *e drejta* që të kërkojë mësim plotësues për fëmijën kur ai e çmon të nevojshme.

Ligji për arsimin para universitar në Republikën e Kosovës, i konsideron prindërit si palë e rëndësishme dhe u njeh atyre të drejtën për t’u organizuar dhe për të përfaqësuar interesat e tyre në vendimmarrjet që adresohen për cilësinë e shërbimit arsimor. Nivelet e organizimit dhe përfaqësimit të prindërve janë si në nivelin qendror, ashtu dhe në nivelin e institucioneve arsimore. Ky ligj autorizon ministrinë e kësaj linje që të rregullojë kompetencat dhe veprimtarinë e Këshillit të prindërve në nivel shkolle.

Edhe në vendit tonë, partneriteti dhe bashkëpunimi i shkollës me prindërit është trajtuar në disa akte normative, ku më kryesorët janë ligji për sistemin arsimor parauniversitar dhe duke vijuar në aktet nënligjore, të tilla si; Dispozitat Normative 2013, “Kodi Etikës së Mësuesit”, “Standardet e përgjithshme të mësuesit”, “Standardet e shkollës si qendër komunitare”(2014), “Standardet e drejtorit të institucionit arsimor” (2011).

Në ligjin për sistemin arsimor para universitar, prindërit përcaktohen dhe konsiderohen si partneri kryesor për mbarëvajtjen e fëmijës në shkollë dhe institucionit. Në të drejtat që ligji u njeh atyre, nënvizohen të drejtat me natyrë informuese që kanë/gëzojnë prindërit lidhur me aspektet e menaxhimit të shkollës. Në këtë aspekt, është e drejtë e prindit;

- Të informohet nga shkolla për legjislacionin në fuqi, për rregulloren e shkollës, si dhe për kurrikulën që shkolla i ofron fëmijës.
- Të informohet për kushtet e sigurisë, të shëndetit dhe të mjedisit.
- Të informohet për veprimtarinë e fëmijës në shkollë dhe të japë pëlqimin e tij për veprimtaritë plotësuese dhe jashtëshkollore që ofron shkolla.
- Të vihet në dijeni për drejtimit kryesore të veprimtarisë së institucionit dhe arritjet e tij në krahasim me institucione të ngjashme.

Ndërsa, përcaktohen si detyra të tij,

- kujdesi që fëmija të ndjekë dhe të mësojë rregullisht në shkollë,
- të njoftojë për ndryshimet e shëndetit dhe të sjelljes së fëmijës së tij,
- të marrë pjesë në takimet për çështje që kanë të bëjnë me fëmijën e tij,
- të kontribuojë në mbarëvajtjen e institucionit.

Ndërsa në aktet nënligjore, bashkëpunimi dhe mbështetja që mësuesi duhet t' u ofrojë prindërve, evidencohet në një prej "Standardeve të përgjithshme të mësuesit" dhe pikërisht në standardin; "Bashkëpunimi me komunitetin". Ndër treguesit e këtij standardi, evidencohet se:

- "mësuesi beson se bashkëpunimi i vazhdueshëm me prindërit është i domosdoshëm për përmirësimin e arritjeve të fëmijëve dhe të nxënësve në përgjithësi", si dhe
- "ndihmon prindërit të kuptojnë kërkesat e kurrikulës ndaj fëmijës së tyre".

Në Dispozitat Normative të shkollës, të cilat kanë si objekt përcaktimin e funksioneve dhe detyrave të institucioneve arsimore dhe të punonjësve të tyre, evidencohet raporti që vendoset ndërmjet shkollës dhe prindërve. Në këtë dokument, krahas evidencimit të disa të drejtave dhe

detyrave individuale të prindit në raport me fëmijën e tij, rregullohet edhe përfshirja e prindit në forumin kolegjal të shkollës “ Këshilli i Prindërve”. Të drejtat e këtij forumi, ndër të tjera janë:

- Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të prindërve në institucionin arsimor.
- E drejta për t`u shprehur për cilësinë e shërbimit arsimor

Ndërsa në Kodin e etikës së mësuesve , miratuar në nëntor të 2013, në rubrikën “Qëllimi”, ndër të tjera, përcaktohet se, *“mësuesi duhet të kontribuojë në krijimin e një mjedisi motivues për komunitetin”*. Këtij qëllimi, ky akt/dokument, i ka kushtuar një kapitull të veçantë; *”Përkushtimi ndaj komunitetit”*, përmes së cilit përcaktohet se *“mësuesi bashkëpunon me prindërit dhe anëtar të tjerë të komunitetit jo vetëm për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies e të nxënësve, por edhe për të zgjeruar gamën e shërbimeve që shkolla mund të ofrojë në komunitet”*.

“Standardet e shkollës si qendër komunitare”, të miratuara si akt normativ nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në mars 2014, synojnë ta kthejnë shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe punohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi. Ndër të tjera, në standardin 1, të fushës “Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënës”, janë identifikuar tregues të tillë si:

- *Nxënësit dhe prindërit marrin pjesë në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të kurrikulës në shkollë.*
- *Prindërit bashkëpunojnë me stafin e shkollës për të njohur stilet e të nxënësve.*
- *Shkolla, në bashkëpunim me prindërit identifikojnë treguesit kryesor që masin progresin e nxënësve.*
- *Shkolla siguron zhvillimin e rrugëve të komunikimit prindër-mësues për plotësimin e nevojave akademike dhe individuale të nxënësve.*
- *Shkolla zhvillon veprimtari me nxënësit, prindërit dhe partner të komunitetit për çështje të tilla, si kurrikula e individualizuar, kurrikula në bazë shkolle, planifikimi i karrierës, etj.*

Ndërsa, në standardin 3, të po kësaj fushe, përcaktohen, ndër të tjera edhe tregues të tillë si:



- *Mësuesit bashkëpunojnë me drejtuesit, prindërit dhe anëtarë të tjerë të komunitetit për të krijuar një mjedis të hapur mësimdhënie.*
- *Mësuesit në bashkëpunim me prindërit ndihmojnë nxënësit të ndjekin stile të ndryshme të të nxënës për të patur sukses.*

Në “Standardet e drejtorit” të institucionit arsimor, dokument i cili është miratuar nga MASH në vitin 2011, synohet plotësimi i nevojave profesionale të drejtorëve të shkollave dhe unifikimi i parimeve të drejtimit të institucioneve arsimore. Në këtë dokument, ndër të tjera përcaktohet se: *drejtori bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit të institucionit dhe me partnerë qeveritarë për të siguruar një shërbim cilësor për të gjithë nxënësit ( Std. V).* Ndërsa treguesit e këtij standardi, përcaktojnë se Drejtori:

- Ka njohuri të përditësuara mbi mënyrën e bashkëpunimit me komunitetin, institucionet homologe, biznesin dhe organizatat jo qeveritare dhe siguron bashkëpunimin me ta për të përmirësuar cilësinë e shërbimit të institucionit.
- Siguron periodikisht vlerësimin e cilësisë së shërbimit arsimor të institucionit nga nxënësit dhe prindërit e tyre duke përdorur metoda të ndryshme si pyetësor, takime etj.
- Organizon periodikisht takime me qeverinë e nxënësve, këshillat e prindërve dhe bordin e institucionit për të informuar mbi aktet e reja reformuese në arsim, mbi draft-vendimet e institucionit, mbi arritjet e nxënësve në provimet kombëtare, konkurseve etj.
- Bashkëpunon me pushtetin vendor dhe njësinë arsimore vendore.
- Është efektiv dhe produktiv në sigurimin e fondeve financiare dhe të ardhurave nga shërbimet ndaj të tretëve.
- Bashkëpunon me bordin e institucionit për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor.
- Siguron për komunitetin mjediset për veprimtari sportive, kulturore e zbavitëse pas orëve mësimore.

## 2.5 Barriera të përfshirjes së prindërve në shkollë

Vendosja dhe zhvillimi i partneritetit shkollë-familje ndikohet nga shumë faktorë, natyra e të cilave është përcaktuese për suksesin dhe efektivitetin e kësaj marrëdhënie. Barrierat e përfshirjes së prindërve në shkollë, janë njëkohësisht shkaktare dhe pasoja të nivelit dhe cilësisë së partneritetit të tyre. Në procesin e ndërtimit dhe zhvillimit të këtij partneriteti, evidencohen edhe pengesa apo barriera që kufizojnë ose e bëjnë të dështuar bashkëpunimin e shkollës me familjen dhe/ose prindërit dhe pasojat e saj pasqyrohen si në vendimmarrjet e shkollës, ashtu dhe në arritjet e nxënësit. Në trajtimet dhe kërkimet e ndryshme shkencore të shqyrtuara, referohen kategorizime të natyrës/ve të këtyre barrierave, të cilat sipas perspektivës së familjes dhe asaj të shkollës, përcaktohen si;

- Barriera të përfshirjes së prindërve të gjeneruara nga familja dhe
- Barriera të përfshirjes së prindërve të gjeneruara nga shkolla.

Lidhur me barriera të gjeneruara nga familja, Drummond&Stipek, (2004), pohojnë se për shumë familje, barrierat e përfshirjes efektive të tyre në shkollë, dalin nga vështirësitë kryesisht ekonomike të tyre., siç janë të ardhurat e pakta, varfëria dhe niveli i kufizuar i edukimit të prindërve.

Këto vështirësi e kufizojnë familjen të ndërveprojë me shkollën dhe për pasojë të kufizojë, e madje të dështojë me mbështetjen efektive për fëmijën. Në këtë kategorizim, nënvizohen edhe nën klasifikime të tilla si *barriera me karakter praktik*, dhe *barriera të vetëdijes së ulët*.

- Në barrierat me karakter praktik, të cilat janë tipike për shoqëritë urbane mund të jenë; pamundësia për shkak të punës, vështirësi transporti etj., këto barriera kanë si karakteristikë tipike pamundësinë objektive të prindërve për të investuar kohë në edukimin e fëmijëve të tyre, megjithëse pranojnë rëndësinë dhe domosdoshmërinë për kohën që duhet t'u dedikojnë edukimit të fëmijëve të tyre.
- Ndërsa në barriera të vetëdijes së ulët, janë ndër barrierat që dallohen kryesisht në zonat para-urbane, por evidencohen edhe në shoqëritë urbane. Natyra tipike e këtyre barrierave është aspekti psikologjik dhe social i prindërve, siç mund të jenë; historitë personale të prindërve me dështimin në shkollë, të trajtimit të papërshtatshëm të tyre në shkollë, ose për shkak të

problemeve me shëndetin fizik dhe mental të tyre, të cilat nuk i lejojnë ata të kenë pjesëmarrje dhe bashkëpunim efektiv me shkollën. Prindërit e përgjithësuar në këtë kategorizim, nuk vlerësojnë, ose kanë vlerësim të ulët për rëndësinë e edukimit dhe shkollës në zhvillimin e fëmijës.

Një tjetër nën klasifikim i këtyre barrierave, shfaqet e lidhur me karakteristikat kulturore të prindërve, të cilat, sipas Garcia Coll et al.2002, dalin kryesisht nga diferencat gjuhësore të cilat nuk konsiderohen nga shkolla. Këta barrierat janë tipike për vendet me emigracion dhe ku komunitetet shkollore janë multikulturale.

Ndërsa, lidhur me barrierat e gjeneruara nga shkolla, evidencohen aspektet menaxheriale, administrative dhe mungesa e profesionalizimit të drejtuesve dhe mësuesve të shkollës në trajtimin e këtij aspekti. Në këtë aspekt, dallohen shkollat që nuk ndajnë “pushtetin” me prindërit dhe ku këta të fundit nuk ndjehen si pjesëmarrës të barabartë në bashkëpunim e tyre me shkollën. Kjo bën që prindërit të kenë një frekuencë të ulët dhe madje të munguar të pjesëmarrjes së tyre në takimet që organizon shkolla (Vilchez 2004)

## **2.6. Studime të kryera në Shqipëri,**

Studimet e realizuara në Shqipëri, mbi përfshirjen e prindërve në veprimtarinë e shkollës dhe roli/përvoja e krijuar nga shkollat tona në këtë drejtim, paraqiten të kufizuara.

Në vitin 2008, Qendra për Edukim Demokratik, me mbështetjen e Unicef, ka realizuar studimin “Situata e përfshirjes së prindërve në edukim në Shqipëri”, i cili ka analizuar nivelin e përfshirjes së prindërve në jetën shkollore dhe në çështjet e arsimit në tërësi. Ky studim ka mbledhur të dhëna mbi karakteristikat dhe gatishmërisë së prindërve për takimet me mësuesit, si edhe karakteristika të qasjes së mësuesve për këto takime.

Në këtë studim, ndër të tjera konstatohet se;

Prindërit kanë një nivel të ulët të përgatitjes së tyre për takimet me mësuesit, si dhe paraqiten disi të druajtur për diskutimet dhe debatet me mësuesin. Ata, (prindërit) vënë theksin te nevoja e krijimit të një klime më të mirë bashkëpunimi, ku përgjegjësinë dhe rolin kryesor për krijimin e saj, e kanë shkolla dhe mësuesit. Gjithashtu, studimi konfirmon gatishmërinë e prindërve për

t'u trajnuar nga shkolla lidhur me çështje të edukimit të fëmijëve në veçanti dhe ato të mësimdhënies në tërësi.

Sa u përket mësuesve, sipas këtij studimi, evidencohet se ndërsa ato janë të gatshëm të presin prindërit në takime individuale, nuk janë po aq aktiv në thirrjen e prindërve në takime të tilla.

Lidhur me pengesat dhe vështirësitë që takohen në zhvillimin efektiv të bashkëpunimit shkollë-prindër, studimi evidencon përkatësisht këto pengesa: Tabela 2

Vështirësitë e bashkëpunimit sipas Mësuesve	Vështirësitë sipas prindërve
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesa e interesit nga prindërit dhe mosardhja e tyre në shkollë dhe në takimet me prindër</li> <li>- Niveli i ulët arsimor i prindërve</li> <li>- Problemet dhe vështirësitë ekonomike e sociale të prindërve</li> <li>- Delegimi i përgjegjësisë për edukimin e fëmijëve nga prindërit vetëm tek shkolla</li> <li>- Interesimi nga prindërit vetëm për disa aspekte të punës së shkollës dhe kërkesa për rezultate të larta, jo të merituar, nga fëmijët e tyre.</li> <li>- Mungesa e mirëkuptimit mes mësuesve dhe prindërve.</li> <li>- Mos vlerësimi sa duhet nga prindërit i punës së shkollës.</li> <li>- Sjellja dhe mos komunikimi nga ana e prindërve.</li> <li>- Mosnjohja e termave dhe aspekteve të reja nga prindërit në programet arsimore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ngarkesa e prindërve me aktivitete, punë dhe angazhime të tjera, problemet e tyre ekonomike dhe sociale (që përbëjnë arsyen e përmendur më shpesh nga ana e tyre).</li> <li>- Indiferenca e tyre në kontrollin e fëmijës.</li> <li>- Indiferenca dhe mos komunikimi me mësuesit dhe drejtuesit e shkollës.</li> <li>- Organizimi i një numri të pakët mbledhjesh me prindër si dhe bërja e tyre jo në kohën e duhur.</li> <li>- Mungesa e motivimit dhe kualifikimit të mësuesve.</li> <li>- Mos informimi për atë që ndodh në shkollë.</li> <li>- Anashkalimi i rolit të prindërve për atë që ndodh në shkollë dhe në partneritetin mes tyre dhe mësuesve.</li> <li>- Mendësia, niveli arsimor dhe kulturor i prindërve,</li> <li>- Rezultatet e dobëta të fëmijës.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mosnjohja nga prindërit e personalitetit të fëmijës së tyre.</li> <li>- Largësia e vendbanimit nga shkolla</li> <li>- Mbingarkesa e mësuesve në punë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ngarkesa e mësuesve</li> </ul>
---	---

Studimi evidencon se, shkaqet dhe problemet që pengojnë dhe/ose kufizojnë efektivitetin e bashkëpunimit të mësuesve me prindërit, qëndrojnë në anën e prindërve dhe vetëm një pjesë e vogël tek ato si mësues. Gjithashtu, studimi paraqet në nivele shqetësuese:

- nivelin e trajnimeve që kanë përfituar mësuesit në këtë drejtim, si dhe
- mbështetjen që ofrojnë drejtoritë e shkolla në drejtim të zhvillimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me prindërit, si dhe

Një studim tjetër, me titull “Përfshirja e prindërve në jetën e shkollës në Shqipëri”, (mars 2010), realizuar po nga Qendra për Zhvillim Demokratik dhe mbështetur nga Instituti për Shoqërinë e Hapur, ka patur si objektivi, zbulimin e qëndrimeve, pikëpamjeve të prindërve ndaj bashkëpunimit prindër-shkollë dhe përfshirjes së tyre në jetën e shkollës, si edhe marrëdhëniet e deritanishme midis shkollës dhe familjeve.

Ky studim, ndër të tjera konstaton se ekziston një lidhje domethënëse ndërmjet rezultateve të fëmijës në shkollë dhe faktit nëse prindërit e tyre janë të përfshirë në jetën dhe veprimtarinë e shkollës. Kështu, rezultatet e fëmijëve të prindërve të përjashtuar nga ana sociale janë kryesisht mesatare ose nën mesataren, krahasuar me rezultatet e fëmijëve të prindërve të zakonshëm, të cilat janë kryesisht mbi mesataren. Për më tepër, fëmijët e prindërve që janë të përfshirë në shkollë, kanë rezultate më të mira se mesatarja ose të shkëlqyera, krahasuar me fëmijët e prindërve të zakonshëm ose atyre të përjashtuar nga ana sociale.

Studimi ka analizuar dimensionet e pjesëmarrjes së prindërve në veprimtarinë e shkollës, si dhe ndërgjegjësimin e tyre për përfshirjen. Në këtë aspekt, raportohet se ftesa e shkollës për të marrë pjesë në takimet/veprimtaritë e saj, është më e shpeshtë për prindërit që marrin pjesë në forume të shkollës, se sa ndaj atyre që nuk përfshihen në këto forume dhe akoma më të rralla janë ftesat për prindërit Romë dhe ato të përjashtuar në aspektin social. Gjithashtu, evidencohet se prindërit e përjashtuar nga ana sociale në përgjithësi nuk janë shumë të sigurtë nëse shkolla *duhet* t’i thërrasë prindërit në takime të tilla, ndërsa prindërit të cilët përfaqësohen në shkollë, mendojnë se shkolla *duhet t’i thërrasë patjetër* prindërit në këto takime.

Lidhur me aftësinë e prindërve për të mbështetur fëmijët e tyre në procesin e të nxënies, studimi raporton se 30% e prindërve të përjashtuar nga ana sociale nuk ndjehen të aftë për t'i ndihmuar ato në detyrat e tyre të shtëpisë, ndërsa 46% e tyre, mendojnë se mbështetja e tyre *ndoshta* do t'i ndihmonte në realizimin e detyrave të tyre të shtëpisë. Gjithashtu, studimi evidencën se janë *nënat* ato që në pjesën më të madhe të rasteve ndihmojnë fëmijët me detyrat e shtëpisë pavarësisht nga grupimi ku bëjnë pjesë, ndërsa, baballarët janë gati 8 herë më pak të prirur për t'u përfshirë në dhënien e ndihmës dhe se baballarët Rom *nuk* përfshihen aspak në ndihmën për detyrat e shtëpisë.

Në botimin “Materiale në ndihmë të psikologëve shkollor” të Qendra e Zhvillimeve Humane 2008, nënvizohet që shërbimi psikologjik që ofrohet në institucionet shkollore është një aktor i dobishëm për rritjen e efektivitetit të përfshirjes së prindërve në edukim. Në këtë botim, rekomandohet veprimtari që mund të ndërmerren nga Psikologu shkollor dhe mësuesi në trajtimin e prindërve si; partnerë, vëzhgues, si vullnetar, si këshillues në vendimmarrje.

Në studimin “Paketa e treguese të cilësisë së arsimit”, i realizuar në 2002 nga N.Mita dhe grupi i punës me mbështetjen e AEDP dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përfshirja e prindërve është evidencuar si një ndër treguesit e cilësisë së shkollës në nivel institucional (shkolle). Kjo paketë treguesish, mundëson sigurimin e informacionit të mjaftueshëm sasior për elementët bazë të arsimit dhe të përdorshëm për realizimin e reformave arsimore në të gjitha nivelet (N. Mita, 2002).

Në këtë studim, përfshirja e prindërve konsiderohet posaçërisht në fushën Burimet financiare, material dhe humane, si tregues i veçantë (B.9) i cilësisë së arsimit. Megjithatë, nga shqyrtimi i këtij treguesi, rezulton se ky aspekt nuk është mbështetur me tregues konkret dhe të matshëm, të cilët do të mundësonin gjykimin dhe/ose vlerësimin e efektshmërisë dhe efikasitetit të veprimtarive që mund të ndërmerren në nivelin e shkollës, çka përbën edhe qëllimin e informacionit që mblidhet për këto tregues.

Familja dhe roli i pjesëtarëve të saj në edukim, trajtohet edhe në librin *Pedagogjia e zbatuar* të M. Kraja. Autori, nënvizon faktin se edukimi në familje është i lashtë sa vetë familja dhe se kjo përvojë ka ekzistuar edhe para shkencës së edukimit. Në argumentimin e rolit të familjes në edukim, përshkruhet roli i prindërve dhe gjyshërve, ku nënvizohet në mënyrë të veçantë roli i nënës në këtë proces. Në këtë aspekt, autori e përcakton moshën e fëmijës nga 1-6 vjeç, si një fazë shumë të rëndësishme, jo vetëm për zhvillimin fizik, por edhe për atë intelektual dhe suksesi

në këtë fazë qëndron në nivelin e vetëdijes, formimit dhe arsimimit që duhet të kenë prindërit dhe në mënyrë të veçantë nënat.

Gjithashtu, në këtë trajtim, pohohet se për suksesin e edukimit në familje, krahas unifikimit të pjesëtarëve të familjes, është shumë i nevojshëm edhe kontakti i vazhdueshëm i tyre me mësuesit. (Kraja.2008).

## **KAPITULLI I TRETË**

### **3 METODOLOGJIA**

Në aspektin metodologjik, studimi është realizuar duke u mbështetur në të dhënat e mbledhura përmes:

#### **3.1 Analizimit të politikave institucionale dhe përvojave metodologjike të krijuara në vendin tonë.**

#### **3.2 Popullata e studiuar, kampioni dhe instrumenti i mbledhjes së të dhënave..**

#### **3.1 Analizimit të politikave institucionale dhe përvojave metodologjike të krijuara në vendin tonë.**

Në këtë aspekt, me qëllim evidencimin e hapsirës, veçantitë metodologjike dhe përvojës së krijuar në sistemin tonë arsimor lidhur me tematikën që trajton ky studim, janë studiuar dhe analizuar;

- Programet e Studimit(PS) të ciklit të dytë që realizohen në vendin tona nga IAL për formimin e mësuesve në drejtime të ndryshme.
- Planet vjetore të punës mësimore dhe edukative të institucioneve shkollore.
- Politikat arsimore që zhvillohen në vendin tonë për zhvillimin profesional të punonjësve mësimor dhe që përfshijnë dhe/ose trajtojnë aftësimin e punonjësve mësimor për zhvillimin e bashkëpunimit më prindërit.
- Metodologjitë, fushat dhe treguesit e vlerësimit të cilësisë së shërbimit arsimor.

Në këtë kontekst janë studiuar dhe analizuar kurrikulat e disa programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë, që zbatohen për formimin e mësuesve në ciklin e ulët nga IAL-të: Universiteti “A.Mojisiu”, Durrës dhe Universitetit “E. Çabej” të Gjirokastrës.

Janë studiuar dhe analizuar planet vjetore të punës mësimore dhe edukative të 26 shkollave 9-vjeçare në Tiranë qytet, në Tiranë Qark, Durrës dhe Vlorë. Konkretisht,



Tabela 3

DAR	Shkolla 9-vjecare	Shkolla gjithsej	Shkolla %
Tirana qytet	12 shkolla	64	18.7%
Tirana qark	6 shkolla	65	9.2%
Durrës	4 shkolla	61	6.5
Vlore	4 shkolla	65	6.1

Vjetari statistikor i MAS 2013-2014

Është studiuar dhe analizuar i gjithë rregullimi normativ i zhvillimit profesional të mësuesve dhe drejtuesve që shërbejnë në sistemin arsimor para universitar, si dhe metodologjitë, fushat dhe instrumentet e vlerësimit të plotë që përdoren nga IShA, për vlerësimin e cilësisë së shërbimit arsimor në këtë sistem.

Qëllimi i studimit dhe analizimit të këtyre politikave/praktikave institucionale dhe metodologjike, ka qenë:

- Evidencimi i hapësirës kurrikulare, numrit të orëve dhe tematikave të identifikuara për trajtimin e partneritetit dhe/ose bashkëpunimit të shkollës me prindërit në kurrikulat që zbatohen në programet e studimit të mësuesisë që ofrohen nga IAL, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve.
- Gjithashtu, është synuar të evidencohet edhe përvoja që kanë normalizuar shkollat tona në këtë drejtim dhe sa ky aspekt konsiderohet në menaxhimin dhe administrimin e institucionit shkollor dhe në vlerësimin e performancës së shërbimit që ofrojnë mësuesit në këtë cikël të edukimit.
- Të evidencojë nëse kjo tematikë është pjesë e veprimtarive trajnuese dhe kualifikuese që organizohen dhe ofrohen nga institucionet përgjegjëse/qendrore të sistemit tonë arsimor, për zhvillimin profesional të punonjësve mësimor, ku natyrisht përfshihen mësuesit e këtij cikli dhe drejtuesit e institucioneve shkollore.
- Të evidencojë gjithashtu, nëse partneriteti dhe mbështetja që shkolla u ofron prindërve për realizimin cilësor të kurrikulës, është pjesë e praktikave vlerësuese dhe inspektuese që realizohen nga institucionet e specializuara (IShA), të cilat realizojnë vlerësimin e jashtëm të cilësisë së shërbimit dhe e raportojnë atë për publikun.

### 3.2 Popullata e studiuar, kampioni dhe instrumenti i mbledhjes së të dhënave.

#### 3.2.1 Popullata e studiuar, kampioni.

Studimi është realizuar në qytetin e Tiranës dhe si popullatë e tij kanë qenë prindërit e nxënësve të ciklit fillor të klasave I-V-së të shkollave 9-vjeçare të cilat administrohen nga Drejtoria Arsimore Rajonale e qytetit Tiranë. Referuar statistikave të Ministrisë së Arsimit të vitit 2013, numri i nxënësve që kanë përfituar shërbimin arsimor në ciklin fillor për vitin shkollor 2012-2013 ka qenë gjithsej 26563. Nga kjo popullatë, u përzgjedh një kampion prej 2835 nxënësish/prindërish të cilët kanë përfituar shërbimin arsimor, në këtë cikël edukimi, në gjashtë shkolla të DAR Tiranë, qytet. Përzgjedhja e shkollave (kampion) u bë në mënyrë rastësore. Karakteristikat e kampionit, paraqiten në tab. 1.

Karakteristikat e kampionit Tabela 3

Shkolla 9 vjeçare	Nxënës gjithsej klasa 1-5	Djem	Vajza
Konferenca e Pezës	338	171	167
Vasil Shanto	552	297	255
P.Budi	389	209	180
E Duraku	654	319	335
Avni Rustemi	413	214	199
1 Maji	489	301	188
<b>Gjithsej</b>	<b>2835</b>	<b>1511</b>	<b>1324</b>

#### 3.2.2 Instrumenti i mbledhjes së të dhënave.

Studimi ka patur si instrument kryesor pyetësin për prindërit e nxënësve të klasave 1-5 të arsimit fillor. Rubrikat e kompetencave akademike të përzgjedhura në pyetësor, i janë referuar përcaktimeve të ligjit për sistemin para universitar në Shqipëri nr. 69/2012. Pritshmëritë e sistemit arsimor në përgjithësi dhe suksesit të nxënësit në veçanti, projektohen në tetë kompetenca, ndërsa nëpërmjet pyetësorit tonë jemi interesuar vetëm për një pjesë të këtyre

kompetencave. Konkretisht, kompetencat e vëzhguara dhe studiuar në këtë studim janë përzgjedhur;

- *Kompetencat e komunikimit në gjuhë amëtare dhe*
- *kompetencat matematikore.*

Kjo përzgjedhje është bërë jo rastësisht, por duke ju referuar planit mësimor që zhvillohet në këtë cikël të edukimit dhe që përbën fokusin e studimit tonë dhe në mënyrë të veçantë, hapësirës kurrikulare që zënë këto kompetenca në planin mësimor të këtij cikli.

Pyetëtori ka qenë plotësisht i strukturuar dhe në përmbajtje të tij janë gjithsej 47 pyetje, të cilat janë organizuar në 6 rubrika:

- I. Rubrika; “Të përgjithshme”, e cila ka synuar të mbledhë të dhëna për karakteristika të tilla si; gjinia, klasën në të cilën vijon nxënësi, vlerësimin që kanë prindërit për arritjet akademike të fëmijës, nivelin arsimor që kanë përkatësisht prindërit (nëna dhe babai), si dhe profesionin që ato kanë.
- II. Rubrika; “Për kompetencën/aftësinë e të Shkruarit”, e cila, përmes pyetjeve 6,7 dhe 8 ka synuar të mbledhë të dhëna për rëndësinë dhe vlerësimin që kanë prindërit, si nëna ashtu dhe babai për kompetencën e të shkruarit, si dhe njohja që kanë ato për vlerësimin që ka mësuesja për këtë kompetencë. Gjithashtu, përmes pyetjes 9, është synuar të mblidhen të dhëna për nivelin e dakordësisë që kanë prindërit me vlerësimin e mësues. Ndërsa, me pyetjet 10 dhe 11 të kësaj rubrike, është synuar të mblidhen të dhëna për njohjen ose jo nga prindërit të treguesve të cilësisë për aftësinë e të shkruarit dhe me pyetjen 12 është synuar mbledhja e të dhënave lidhur me vlerësimin që kanë prindërit nëse është e dobishme që shkolla duhet t`u a bëjë të njohura atyre këto tregues.
- III. Rubrika; “Për kompetencën/aftësinë e të Lexuarit”, e cila, përmes pyetjeve 13,14 dhe 15 ka synuar të mbledhë të dhëna për rëndësinë dhe vlerësimin që kanë prindërit, si nëna ashtu dhe babai për kompetencën e të shkruarit, si dhe njohja që kanë ato për vlerësimin që ka mësuesja për këtë kompetencë. Përmes pyetjes 16, është synuar të mblidhen të dhëna për nivelin e dakordësisë që kanë prindërit me vlerësimin e mësues. Ndërsa, me pyetjet 17 dhe

18, është synuar të mblidhen të dhëna për njohjen ose jo nga prindërit të treguesve të cilësisë për aftësinë e të shkruarit dhe nëse shkolla u`a ka bërë të njohura këto tregues. Me pyetjen 19, është synuar mbledhja e të dhënave lidhur me vlerësimin që kanë prindërit, nëse është e dobishme që shkolla duhet t`u a bëjë të njohura atyre këto tregues.

- IV. Rubrika; “Për kompetencën/aftësitë “Matematikore”. Me pyetjet 20, 21 dhe 22 të kësaj rubrike, është synuar të mblidhen të dhëna lidhur me, vlerësimin që kanë prindërit për këtë kompetencë, vlerësimin që ata kanë për arritjet e fëmijës së tyre dhe vlerësimin që ka mësuesja. Me pyetjen 23 janë mbledhur të dhëna me qëllim identifikimin e diferencave që kanë ndërmjet vlerësimit të prindërve dhe vlerësimit që ka mësuesja për arritjet në këtë drejtim. Me pyetjet 24 dhe 25 janë mbledhur të dhëna me qëllim identifikimin e aftësisë së prindërve për asistimin e fëmijëve në të ushtruar në këtë lëndë dhe nëse ata marrin këshilla metodike për ofrimin e kësaj ndihme në shtëpi. Ndërsa, me pyetjet 26 dhe 27, janë mbledhur të dhëna me qëllim njohjen nëse mësuesja/shkolla i njeh prindërit me treguesit e cilësisë së kësaj kompetence dhe se ç`mendojnë ata lidhur me sa e dobishme është që shkolla/mësuesja t`i njohë ata me këto tregues.
- V. Rubrika; “Për njohjen e programeve lëndore”. Përmes pyetjeve 28, 31 dhe 32 kemi synuar të mbledhim të dhëna lidhur me nivelin e njohjes së programeve lëndore që kanë prindërit. Ndërsa, nëpërmjet pyetjeve 30, 33 dhe 34, është synuar që të mblidhen të dhëna që mundësojnë analizimin e punës dhe veprimtarisë që bëjnë shkolla lidhur me njohjen e programeve lëndore nga ana e prindërve.
- VI. Rubrika; “Për organizimin procesit të edukimit në familje”. Pyetjet e kësaj rubrike, ndër të tjera, kanë synuar mbledhjen e të dhënave lidhur me cilësinë e mjedisit mësimor që kanë nxënësit në familje, vlerësimin që kanë prindërit për nivelin e ngarkesës mësimore që kanë nxënësit në shtëpi, marrëdhëniet që kanë prindërit me tekste të tjera mësimore, evidencimin e hapësirës që ka përkatësisht teksti dhe programi mësimor në procesin mësimor që realizohet në shtëpi, si dhe evidencimin e fazës/ave metodologjike në të cilat prindërit paraqesin vështirësi.

Përpunimi i të dhënave të mbledhura përmes pyetësorit, është bërë me programin statistikor për shkencat sociale SPSS, versioni 18.

## **KAPITULLI I KATËRT**

### **4 GJETJET E STUDIMIT**

#### **4.1 Gjetje nga analizimi i politikave institucionale dhe përvojave metodologjike të krijuar në vendin tonë.**

##### 4.1.1 Gjetje nga analiza e Programeve të e Studimit(PS) të IAL-ve, për formimin e mësuesve të ciklit fillor.

Nga shqyrtimi i programeve të studimit që zbatohen nga institucionet e arsimit të lartë, të cilat janë institucionet përgjegjëse për formimin e mësuesve, rezulton se partneriteti shkollë-familje, nuk ka një hapësirë të posaçme të dedikuar trajtimit të kompleksitetit të kësaj tematike. Edhe në lëndë të tilla si “Metodologji të mësimdhënies”, apo “Psikologji të edukimit”, të cilat zhvillohen në ciklin e parë të studimeve për arsimin fillor, rezulton se kjo tematikë nuk trajtohet.

Edhe në programet e ciklit të dytë, rezulton se partneriteti dhe bashkëpunimi me prindërit nuk mbështetet me informacion dhe metodologji të caktuar që të synojë mbështetjen dhe pajisjen e mësuesve të ardhshëm me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për ndërtimin dhe zhvillimin profesional të kësaj marrëdhënie.

##### 4.1.2 Gjetje nga analiza e Planeve vjetore të punës mësimore dhe edukative të shkollës;

Nga shqyrtimi planeve vjetore të punës mësimore dhe edukative të institucioneve shkollore, rezulton se komunikimi dhe bashkëpunimi i shkollës me prindërit trajtohet në një rubrikë të veçantë. Në këtë rubrikë evidencohet planifikimi i takimeve me prindërit në grup dhe individuale në intervale të ndryshme të vitit shkollor. Nga shqyrtimi i tematikave të këtyre takimeve, rezulton që ato të jenë të njëanshme dhe me natyrë informative, ku mësuesi vetëm e informon prindin mbi frekuentimin dhe arritjet/rezultatet e nxënësit.

Ndërkaq, nuk pasqyrohen veprimtari dhe metodologji të posaçme për konsultimin dhe mbështetjen profesionale të nxënësit në shtëpi nga ana e prindërve. Ky aspekt nuk trajtohet me një metodologji dhe/ose përvojë të caktuar, aq më pak të unifikuar, për njohjen mbështetjen e prindërit/ve në vështirësitë që ato kanë në këtë proces.

### *Vlerësimi i performacës së mësuesit;*

Është një proces i detyruar dhe që zhvillohet në fund të çdo vitit shkollor. Vlerësimi i mësuesve realizohet nga drejtori i shkollës dhe përvoja e deri tanishme e këtij procesi, tregon që ky proces vlerësimi realizohet përmes një instrumenti, në përmbajtje të të cilit evidencohen këto tregues:

- Saktësia shkencore e mësimdhënies
- Komunikimi
- Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie dhe nxënie
- Vlerësimi i veprimtarisë së nxënësit
- Përdorimi i kohës në orën e mësimi
- Hartimi i objektivave të arritjes
- Plotësimi i dokumentacionit shkollor
- Përdorimi dhe pasurimi i bazës material dhe didaktike
- Zhvillimi profesional

Duhet theksuar se instrumenti i vlerësimit të mësuesve nuk rezulton unik, por janë vetë shkollat që e strukturojnë këtë instrument duke u bazuar në fushat dhe treguesit e vlerësimit të përdorura kryesisht në vlerësimin e brendshëm të shkollës. Siç shikohet nga treguesit e listuar më lart, bashkëpunimi dhe mbështetja e prindërve nga ana e mësuesit nuk evidencohet akoma si një fushë apo nën-fushë e veçantë e performancës së mësuesit.

#### 4.1.3 Gjetje nga analiza e politikave të zhvillimit profesional të punonjësve mësimor.

Zhvillimi profesional i punonjësve mësimor në sistemin arsimor para universitar, përbën aktualisht një detyrim ligjor, si për punonjësit mësimor, ashtu dhe për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit që duhet ta sigurojë këtë proces. Ligji për sistemin arsimor ka përcaktuar si detyrim për mësuesin, një prag minimal, për realizimin e së paku tre ditë trajnimi gjatë vitit shkollor. Lista e nevojave për trajnim dhe kualifikim të punonjësve mësimor shpallet nga MAS mbi bazën e nevojave dhe kërkesave të identifikuara nga njësitë arsimore vendore dhe vetë punonjësit mësimor.

Oferta e këtyre trajnimeve dhe kualifikimeve, përzgjidhet, akreditohet dhe shpallet për mësuesit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të cilët zgjedhin ato trajnimet dhe kualifikimet që i vlerësojnë të nevojshme. Nga shqyrtimi i listës së nevojave për trajnime dhe kualifikimeve të mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore të shpallura zyrtarisht nga MAS për periudhat 2011-2013 dhe 2014-2016, rezulton se:

Nevojat për trajnimin e mësuesve dhe drejtuesve në arsimin para universitar për periudhën 2011-2013, është e organizuar në fusha, të cilat trajtojnë tematika kryesore, të tilla si:

Fusha	Tematikat
<i>Kurrikula</i>	Aspekte dhe dokumente të kurrikulave që zbatohen në institucionet e arsimit parauniversitar .Kurrikula bërthamë dhe me zgjedhje. Standardet e fushave të të nxënit. Projektet kurrikulare, etj
<i>Dokumentacioni shkollor</i>	Akte ligjore dhe nënligjore të sistemit arsimor dhe të institucioneve arsimore. Rregullore të kualifikimit të mësuesve, të drejtorëve, të praktikave profesionale, të DAR/ZA-ve etj.
<i>Drejtimi dhe menaxhimi i institucionit shkollor</i>	Standardet e drejtorit, Drejtori si lider pedagogjik, Menaxhimi financiar, Vlerësimi i jashtëm dhe vetëvlerësimi. Vlerësimi i mësuesve, Plani vjetor dhe afatmesëm, Raporti vjetor. Funksionimi i bordit të institucionit. Etika dhe komunikimi i drejtorit.etj.
<i>Aspekte metodologjike të mësimdhënies dhe nxënies</i>	Planifikimi vjetor dhe ditor. Metodika, teknika, strategji mësimore me në qendër nxënësin dhe që nxisin të menduarit kritik. Hartimi i minitesteve për rendimentin e orës së mësimit dhe arritjet e objektivave për kapitull. Detyrat e shtëpisë..etj.
<i>Aspekte pedagogjike të mësimdhënies dhe nxënies</i>	Zhvillimi moshor nxënësve. Motivimi i nxënësve. Menaxhimi i klasës. Menaxhimi i konflikteve. Mësimdhënia dhe nxënia për nxënësit me aftësi të kufizuar dhe nxënësit me vështirësi në të nxënë. Mësimdhënia dhe



	nxënia në arsimin parashkollor. Përdorimi i gjuhës së shenjave. Përdorimi i alfabetit “brail”..etj
<i>Mësimdhënia dhe nxënia e TIK</i>	Përdorimi i TIK në mësimdhënie dhe nxënie. Përdorimi i laboratorëve virtual. Rrjetet kompjuterike. Përdorimi i metodave interaktive on-line
<i>Aftësitë kroskurrikulare</i>	Kompetencat themelore. Përdorimi i matematikës në lëndë të tjera. Lidhja e njohurive dhe koncepteve të një lënde me lëndë të tjera. Kultivimi te nxënësi i aftësive ndërkurrikulare. Të drejtat e fëmijëve. Dimensioni evropian etj.
<i>Të tjera</i>	Standardet e përgjithshme të mësuesit dhe ato të mësuesit lëndor. Mentori. Etika dhe sjellja e mësuesit. Bashkëpunimi me prindërit e nxënësve. Veprimtaritë jashtëshkollore. Roli i psikologut dhe bashkëpunimi i mësuesit etj.

Nevojat për trajnimin e mësuesve dhe drejtuesve më arsimin para universitar për periudhën 2014-2016, e cila është aktualisht në fuqi, është e organizuar në fusha, të cilat trajtojnë tematika kryesore, të tilla si:

RUBRIKAT	ÇËSHTJET KRYESORE PËR ZHVILLIM PROFESIONAL
Kurrikula	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kurrikula me bazë kompetencat</li> <li>- Risitë në kornizën kurrikulare dhe kurrikulën bërthamë</li> <li>- Risitë në programet e fushave/lëndëve</li> <li>- Planifikimi i kurrikulës (planifikimi vjetor, planifikimi 3–mujo, planifikimi i orës së mësimit)</li> </ul>

	- Trajtime të përmbajtjes shkencore sipas fushave/lëndëve
	- Projektet kurrikulare lëndore dhe ndër-lëndore
	- Dosja (portofoli) i nxënësit
	- Portofoli i mësuesit për kurrikulën bazuar në kompetenca
Metodologjia e mësimdhënie-nxënie	- Mësimdhënia dhe të nxënit bazuar në kompetenca
	- Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar
	- Planifikimi dhe trajtimi i situatave të të nxënit
	- Korniza e vlerësimit të nxënësve (çfarë, kur dhe si do vlerësojmë)
	- Vlerësimi për të nxënë (instrumentet e vlerësimit, evidencat e vëzhgimeve, vlerësimi diagnostikues, hartimi i testeve formuese, vetëvlerësimi i nxënësve)
	- Vlerësimi i të nxënit (përpunimi i evidencave,; hartimi i testeve përmbledhëse, vlerësimi i dosjes së nxënësit)
	- Raportimi i progresit dhe arritjeve të nxënësve (format e raportimit)
	- Sigurimi i cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies në sistemin arsimor
	- Programi për vlerësimin ndërkombëtar të nxënësve – PISA (Aftësimi i nxënësve në lexim-shkrim, matematikë dhe shkencë dhe metodologjia që përdor PISA për të matur arritjet e nxënësve).
	- Metodatat e mësimdhënies dhe nxënies për nxënës me nevoja të veçanta

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e përgjithshëm</li> <li>- Mësimdhënia në klasat e bashkuara dhe puna me nivele të ndryshme nxënësish</li> <li>- Zhvillimi i moduleve profesionale në gjimnaz</li> </ul>
Pedagogjia	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi moshor i fëmijëve dhe të rinjve</li> <li>- Etika dhe Komunikimi</li> <li>- Ndikimet që sjellin risitë kurrikulare në psikologjinë e individit</li> <li>- Nxitja e përvojave individuale të nxënësve dhe puna e diferencuar sipas nevojave të tyre</li> <li>- Motivimi i nxënësve dhe nxitja e iniciativës dhe krijimtarisë</li> <li>- Menaxhimi i klasës dhe konflikteve</li> <li>- Njohja dhe ndërhyrja tek fëmijët me vështirësi në të nxënë</li> <li>- Njohja dhe ndërhyrja tek fëmijët me aftësi të kufizuara</li> <li>- Aftësitë sociale dhe të punuarit në ekip</li> <li>- Roli i psikologut shkollor</li> </ul>
Drejtimi i shkollës	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtimi dhe vizioni i shkollës</li> <li>- Teoritë dhe stilet e drejtimit</li> <li>- Klima e institucionit arsimor</li> <li>- Legjislacioni, organizimi administrativ i institucionit shkollor</li> <li>- Menaxhimi financiar i institucionit arsimor</li> <li>- Cilësia e arsimit, vlerësimi i jashtëm dhe vetëvlerësimi (instrumentet e vlerësimit)</li> <li>- Plani afatmesëm i zhvillimit të shkollës</li> <li>- Plani vjetor i zhvillimit të shkollës</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi personal dhe ndërveprimi me aktorët e tjerë</li> <li>- Etika profesionale</li> </ul>
TIK në mësimdhënie –nxënie	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Formim i trajnerëve lidhur me risitë kurrikulare</li> <li>- Përdorimi i TIK në mësimdhënie – nxënie</li> <li>- Përdorimi i pajisjeve DEMO në klasë dhe lëndë të ndryshme</li> <li>- Përdorimi i programeve kompjuterike për përgatitjen e demonstrimeve praktike në lëndë të ndryshme</li> <li>- Përdorimi praktik i laboratorit virtual në klasë</li> <li>- Përdorimi i metodave interaktive online</li> <li>- Mirëmbajtja e rrjetit kompjuterik në shkolla</li> <li>- Përdorimi i CD-ve interaktive</li> </ul>
Dokumentacioni shkollor (Ligje, Urdhra, Udhëzime, Rregullore..etj)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji i arsimit parauniversitar</li> <li>- Kodi i Etikës</li> <li>- Udhëzime për fillimin e vitit shkollor</li> <li>- Roli i mentorit dhe rregullorja për zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit</li> <li>- Rregullorja e DAR/ZA-ve</li> <li>- Dispozitat Normative</li> <li>- Standardet e mësuesit, standardet e drejtuesit, standardet e shkollës si qendër komunitare etj.</li> </ul>
Çështje ndërklurrikulare	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mjedisi</li> <li>- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave</li> <li>- Të drejtat e njeriut</li> <li>- Vendimmarrja morale</li> <li>- Zhvillimi i qëndrueshëm</li> </ul>

- Ndërvarësia
- Bashkëjetesa paqësore
- Të nxënit për sipërmarrje përmes kurrikulës shkollore
- Gjithë përfshirja

Ndërsa për zhvillimin profesional të drejtuesve të institucioneve shkollore, “Programi për zhvillimin profesional për kualifikimin e drejtorëve të institucioneve arsimore” (MASH 2011), ka si pikënisje bindjen se, drejtimi i institucionit shkollor nuk mund ti lihet rastësisë. Qëllimi i kësaj politike është ngritja profesionale në nivelin e ekspertit të drejtimit dhe menaxhimit. Programi përbëhet nga 6 module, të cilat ofrojnë njohuri bazë për formimin e aftësive kryesore të një drejtori bashkëkohor. Këto module janë:

1. Teoritë kryesore dhe praktikat e drejtimit dhe menaxhimit të institucionit.
2. Legjislacioni për drejtimin dhe menaxhimin e institucionit.
3. Drejtuesi si lider i zhvillimit pedagogjik dhe i menaxhimit të kurrikulës.
4. Planifikimi për zhvillimin e institucionit.
5. *Bashkëpunimi me përfaqësues të komunitetit të institucionit dhe me partnerë qeveritarë e jo qeveritarë.*
6. Komunikimi, etika dhe teknologjia.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së modulit 5, që adresohet në temën e këtij studimi, rezulton se ky modul trajton/realizohet përmes këtyre temave; “Teoria e organizatës”, “Struktura e shkollës dhe organizimi i saj”, “Organizimi i brendshëm i shkollës”, “Përfshirja e prindërve dhe e komunitetit në mbështetjen e të nxënit të fëmijëve”, “Bashkëpunimi me komunitetin, institucionet homologe, biznesin dhe organizatat jo qeveritare për të përmirësuar arritjet e nxënësve”, “Bashkëpunimi me njësitë përkatëse të arsimit dhe pushtetit vendor”, “Sigurimi i fondeve financiare e materiale nga dhurues e sponsorizues”, “Sigurimi i të ardhurave nga

shërbimet për të tretët”, “Bashkëpunimi me bordin e institucionit”, “Sigurimi për komunitetin i mjediseve për veprimtari sportive, kulturore e zbavitëse”.

#### 4.1.4 Gjetje nga analizimi i përvojës së vlerësimit të cilësisë së shërbimit arsimor në institucionet shkollore

Nga shqyrtimi i përvojës inspektuese dhe vlerësuese të cilësisë së shërbimit arsimor që ofrohet në institucionet tona shkollore, rezulton se është krijuar tashmë një përvojë disa vjeçare dhe metodikë për vlerësimin e brendshëm dhe atë të jashtëm të shkollës. Kjo përvojë është e mbështetur me udhëzime dhe instrumente të standardizuar metodologjike që shërbejnë për vlerësimin edhe në rastet kur ky proces realizohet nga vetë shkolla (vetë-vlerësimi), ashtu edhe kur kryhet nga punonjësit e IShA (vlerësim i jashtëm), i cili është institucioni që ushtron këtë funksion dhe përgjegjësi publike.

Përvoja aktuale e vlerësimit të cilësisë së shërbimit arsimor që ofron shkolla, mbështetet në këto fusha:

- 1.Kurrikula e zbatuar,
- 2.Mësimdhënia dhe të nxënët,
- 3.Klima dhe etika,
- 4.Kujdesi ndaj nxënësit,
- 5.Menaxhimi i shkollës,
- 6.Zhvillimi i burimeve njerëzore,
- 7.Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve.

Vlerësimi i cilësisë në këto fusha mbështetet në nën-fusha më të detajuara dhe në tregues të vlerësimit.

Partneriteti dhe bashkëpunimi i shkollës me prindërit, trajtohet në fushën “Klima dhe etika e shkollës” dhe në mënyrë të detajuar në nënfushën “Lidhja e shkollës me prindërit dhe komunitetit”. Në tabelën në vijim, paraqiten instrumentet që përdoret në procedurën e vlerësimit të shkollës për këtë aspekt apo nënfushë.

<b>Nën fusha</b>	<b>Treguesit</b>	<b>Instrumente</b>
Lidhja e shkollës me prindërit dhe komunitetin	Mësuesi bashkëpunon me prindërit dhe komunitetin.	Prindërit janë të mirëpritur në shkollë
		Prindërit janë përfshirë në hartimin e planit vjetor të shkollës
		Prindërit janë pjesëmarrës në veprimtari mësimore dhe edukative në shkollë
	Mësuesi mban kontakte të vazhdueshme me prindërit për ecurinë e nxënësve	Shkolla përdor forma të ndryshme për të informuar prindërit
		Metodat që përdor shkolla për të informuar prindërit janë të frytshme
	Shkolla respekton vlerat, traditat dhe kulturën e komunitetit	Shkolla mbështet kulturën e komunitetit, vlerat dhe traditat e saj.
		Shkolla kontribuon në ruajtjen e traditës dhe kulturës së komunitetit.
		Shkolla informon komunitetin për synimet dhe arritjet e saj.

Udhëzuesi i IShA

#### 4.2 Gjetje të përfituara nga pjesëmarrësit në studim

Pas përpunimit të pyetësorit, lidhur me pyetjet/karakteristika të përshkruara në rubrikën “Të përgjithshme”, rezulton se pjesëmarrja në pyetësor sipas gjinisë është; 53% janë djem dhe 47% e tyre janë vajza

##### Pjesëmarrja në pyetësor sipas gjinisë

Djem	53.0%
Vajza	47.0%

Tab.4



Grafiku 4


Ndërsa, shpërndarja e tyre sipas klasave, rezulton: nxënës në klasën e parë 24.6%, në klasën e dytë 23.3%, në klasën e tretë 17.1%, në klasën e katërt 18.0% dhe në klasën e pestë 17.1%

**Shpërndarja e nxënësve sipas klasave**

Klasa 1	24.6
Klasa 2	23.3
Klasa 3	17.1
Klasa 4	18.1
Klasa 5	17.1

Tab.5

**Shpërndarja e nxënësve sipas klasave që ndjekin**



Grafiku 5

Niveli arsimor i prindërve pjesëmarrës në pyetësor, rezulton: Nënata me arsim të lartë janë 30.2%, me arsim të mesëm janë 36.3%, me arsim të detyruar 33.4% dhe nëna që nuk kanë raportuar nivelin e tyre arsimor, 0.2%. Ndërsa, niveli arsimor i baballarëve, rezulton si vijon; Me arsim të lartë janë 26.9%, me arsim të mesëm 42.3%, me arsim të detyruar 28.5% dhe vetëm 2.4% e tyre nuk raportojnë nivelin e tyre arsimor.


Niveli arsimor i prindërve :

**Arsimi i Nënave**

I lartë	30.2%
I mesëm	36.3%
I detyruar	33.4%
Pa përgjigje	0.2%

Tab. 6


**Arsimimi i prindërve - Nëna**



Grafiku 6



### Arsimimi i prindërve - Babai



Grafiku 7

### Arsimimi i prindërve - Babai

I lartë	26%
I mesëm	42.3%
I detyruar	28.5%
Pa përgjigje	2.4%

Tabela 7


Lidhur me profesionin e prindërve, nga përpunimi i pyetësorit, raportohet se: 7.7% e nënave që kanë plotësuar pyetësorin, ushtrojnë aktualisht profesionin e mësuesit, ndërsa 91.1% e tyre, nuk janë mësuese. Vetëm në 1.2% të rasteve nuk është raportuar profesioni i nënës.

### Profesioni i Nënave

Mësues	7.7%
Jo Mësues	91.1%
Pa përgjigje	1.2%

Tab.8


### Profesioni i Prindërve - Nëna



Grafiku 8

Ndërsa sa i përket profesionit që ushtron babai, rezulton se 1.3% e tyre ushtrojnë profesionin e mësuesve dhe pjesa tjetër, prej 97.1% janë jo mësues dhe në 1.6 e tyre nuk e raportojnë profesionin.

### Profesioni i Prindërve - Babai




Grafiku 9

### Profesioni i Babait

Mësues	1.3%
Jo mësues	97.1%
Pa përgjigje	1.6%


Tabela 9

Pyetjes “A e vlerësoni të rëndësishme aftësinë e të shkruarit në formimin e fëmijës suaj?”, rezulton se: Nënat dhe baballarët e vlerësojnë si; “Shumë të rëndësishme”, përkatësisht në 66% dhe 61.8% të rasteve. Ndërsa si të “Rëndësishme” e vlerësojnë 32.9% e nënave dhe 35.4% e baballarëve. Si “të parëndësishme” në formimin e fëmijës e vlerësojnë 0.3% e nënave dhe 1.6% e baballarëve dhe nuk raportojnë vlerësimin/mendimin e tyre 1.2% e baballarëve dhe 0.2% e nënave.



Grafiku 10

Vlerësimi që prindërit kanë për cilësinë e shkrimit të fëmijës së tyre, rezulton në këto vlera: në 40.4% të nënave dhe 38.4% të baballarëve e vlerësojnë si “Shumë të mirë” cilësinë e shkrimit të fëmijës, ndërsa 38.4% e baballarëve mendojnë




Grafiku 11

Lidhur me kompetencën e komunikimit, sikurse kemi thënë më lart, u mblodhën të dhëna për aftësinë e të shkruarit dhe të lexuarit, të cilat trajtohen në mënyrë të zgjeruar programet lëndore të: Gjuhës Shqipe për klasat I-V të arsimit fillor. Pyetjet e formuluar në këtë rubrikë, kanë synuar që të evidencohen; qëndrimet që kanë prindërit, përkatësisht nëna dhe babai, lidhur me rëndësinë që ka të shkruarit dhe të lexuarit në formimin e fëmijës, për të evidencuar dakordësinë apo diferencat e mundshme ndërmjet vlerësimit që kanë prindërit dhe atij që bën mësuesja në shkollë, si dhe për të evidencuar faktin nëse prindërit i njohin treguesit e vlerësimit të këtyre aftësive dhe cili është roli apo reagimi i shkollës në këtë drejtim. Nga përpunimi i përgjigjeve rezultoi se:


### Për aftësinë e të lexuarit:

Aftësia e të lexuarit, vlerësohet si “shumë e rëndësishme” nga 75% e prindërve, si nga nënat, ashtu dhe nga baballarët. Ndërsa, 23% e tyre, nënat dhe baballarët, e vlerësojnë si “ të rëndësishme”.



Grafiku 12

Ndërsa vlerësimi që kanë vetë prindërit, për aftësinë e të lexuarit të fëmijës së tyre, rezultoi në këto vlera: nënat në 58.1% të përgjigjeve e vlerësojnë “Shumë të mirë”, aftësinë e të lexuarit të fëmijës së tyre ndërsa, baballarët e vlerësojnë si të tillë, në 54.9% të rasteve/përgjigjeve.




Grafiku 13

Në 34% të rasteve, si nënat ashtu dhe baballarët, vlerësojnë se aftësia e të lexuarit të fëmijës së tyre, është “E mirë”. Ndërsa, prindërit që e vlerësojnë “Mjaftueshëm dhe “Dobët”, shfaqen në

përqindje më të ulët, përkatësisht në 6.6 deri në 7.5% “Mjaftueshëm” dhe (0.3-0.4%) e vlerësojnë të “Dobët” këtë aftësi.


Lidhur me njohjen nga ana e prindërve të vlerësimit të kësaj aftësie nga mësuesja dhe se sa dakord janë ato me këtë vlerësim, rezultojnë se: janë të informuar për vlerësimin e mësues për cilësinë e të lexuarit të fëmijës së tyre dhe sa i përket shkallës së vlerësimit të të lexuarit, rezulton se në 48.6% të rasteve, mësuesja ka vlerësim “shumë të mirë”, në 38% të rasteve ka vlerësim të mirë, vlerësim “Mjaftueshëm” ka në 9.0% të rasteve dhe në 1.9% pohohet se, ose nuk kanë vlerësim nga mësuesja, ndërsa nuk kanë dhënë përgjigje 0.7% e tyre

Vlerësimi i cilësisë së të lexuarit të fëmijës - nga Mësuesja



Grafiku 14

Jeni dakord me vlerësimin e Mësueses për cilësinë e "të lexuarit" të fëmijës?



Grafiku 15

Ndërsa, për dakordësinë që prindërit kanë për vlerësimin e mësueses, rezulton se: Prindërit janë dakord me vlerësimin e mësueses për këtë aftësi, në 73.9% të rasteve, janë “Pjesërisht dakord” në 23.6% të rasteve dhe disi ose mjaftueshëm dakord raportohen vetëm 2.2% e rasteve dhe nuk raportohet asnjë rast që prindërit nuk janë aspak dakord me vlerësimin e mësueses.




Grafiku 16

Prindërit pohojnë se i njohin treguesit e vlerësimit në 71% të rasteve, ndërsa ato që nuk i njohin këto tregues, përfaqësojnë 28% të prindërve të intervistuar. Në 70.1% të të intervistuarve, pohojnë se janë njohur me treguesit e cilësisë nga mësuesja, ndërsa 29.2% e tyre pohojnë se nuk janë njohur me këto tregues nga mësuesja apo shkolla. Ndërsa, rezulton se prindërit mendojnë se është e nevojshme që shkolla dhe/ose mësuesja t'i njohin prindërit me treguesit e cilësisë së të lexuarit. Për këtë pohim, rezulton se 84% e prindërve mendojnë se shkolla duhet t'i njohë ata me treguesit e cilësisë dhe 14.5% e tyre mendojnë se shkolla nuk duhet ta bëjë këtë.



Grafiku 17




Grafiku 18


### Për kompetencën/at matematikore:

Të dhënat e mbledhura përmes pyetjeve të kësaj rubrike, kanë synuar që të njihet qëndrimi, mundësitë, përmasën e bashkëpunimit me mësuesen dhe nevojat që prindërit shfaqin në ndihmën dhe mbështetjen që ata u ofrojnë fëmijëve të tyre në procesin mësimor që zhvillohet

në familje. Rezultatet e përpunuara, tregojnë se prindërit, si nëna ashtu dhe babai, kanë të njëjtin qëndrim lidhur me rëndësinë që ka kompetenca matematikore në formimin e fëmijës/nxënësit. Konkretisht rezulton se:




Grafiku 19



Grafiku 20

Ndërsa lidhur me njohjen që kanë prindërit me vlerësimin që ka mësuesja për këtë kompetencë dhe se sa dakord janë ato me këtë vlerësim, rezulton se: vlerësimi i mësueses për arritjet e nxënësit në këtë kompetencë është, “Shumë mirë” në 42% të rasteve, “Mirë” në 50.1% të rasteve, “Dobët” në 4.8% të rasteve dhe nuk njohin vlerësimin e mësueses në 1% të rasteve. Nuk kanë raportuar përgjigje për këtë aspekt, 1.9% e prindërve. Ndërsa, për sa i përket qëndrimit të prindërve lidhur me vlerësimin e mësueses, pra me të qenurit dakord ose jo me këtë vlerësim të mësuesit/ses, rezulton kjo situatë: vetëm 68.8% e prindërve janë dakord me vlerësimin e mësueses dhe 28.2% e tyre janë “Pjesërisht dakord” dhe 2.8% e tyre nuk janë aspak dakord me vlerësimin e mësuese




Grafiku 21



Grafiku 22

A e ndihmoni dot fëmijën tuaj në të ushtruarin në Matematikë në shtëpi?




Grafiku 23

Lidhur me aspektin se sa të mundur janë prindërit që të ndihmojnë fëmijët e tyre në shtëpi në realizimin e detyrave dhe veprimtarive të lëndës së matematikës, rezulton se 45.8% e tyre pohojnë se janë të mundur që të ndihmojnë fëmijën e tyre, ndërsa 18.7% e tyre pohojnë se nuk janë të mundur që t'i ndihmojnë fëmijët e tyre dhe 35.2% e prindërve, shprehen se janë pjesërisht të mundur që t'i ndihmojnë fëmijët në lëndën e matematikës në të ushtruarit e tyre në shtëpi.

Sa i përket mbështetjes metodike që u ofrohet prindërve nga ana e mësueses apo shkollës, në punën e tyre mbështetëse ndaj fëmijëve në shtëpi, rezulton se në 66.9% të rasteve, prindërit pohojnë se marrin këshilla metodike nga mësuesit, ndërsa 32.9% e tyre, deklarojnë se nuk marrin këshillim metodik nga mësuesi për ndihmën që ata u japin fëmijëve në të ushtruarit në matematikë.

A merrni këshilla metodike nga mësuesja për ndihmën tuaj gjatë të ushtruarit të fëmijës në matematikë




Grafiku 24


Prindërit, në 70.8% të përgjigjeve të tyre, pohojnë se janë njohur nga mësuesja me treguesit e cilësisë në të ushtruarit e fëmijës në lëndën e matematikës. Ndërsa, 29% të tyre, raportojnë se nuk janë njohur me këto tregues nga mësuesja.

Ndërkaq, lidhur me mendimin e prindërve, nëse shkolla duhet t'i njohë ato me treguesit e cilësisë për kompetencat/aftësitë matematikore, rezulton se; 88.3% e prindërve mendojnë se shkolla

duhet t'i njohë prindërit me këto tregues dhe vetëm 11.5% e tyre mendojnë se shkolla nuk është e nevojshme që t'i njohë ata me këto tregues.



Grafiku 25



Grafiku 26

**Për njohjen e programeve lëndore:**

Pyetjet e kësaj rubrike kanë synuar të evidencojnë aspektin sasior dhe cilësor të njohjes që prindërit kanë me programet lëndore, si dhe për të evidencuar konsiderimin dhe trajtimin e këtij aspekti nga shkolla në planifikimin dhe zbatimin e veprimtarive të saj. Gjithashtu, me pyetjen nr.35, është synuar të njihet vlerësimi që kanë prindërit për cilësinë e procesit mësimor që zhvillohet në klasë. Nga përpunimi i të dhënave përkatëse, për çdo pyetje të kësaj rubrike, rezulton se: Për njohjen e programeve lëndore që realizohen në shkollë, 13.4% e prindërve pohojnë nuk janë njohur me asnjë program. Pohojnë se janë njohur me të gjitha programet 44.7% e tyre(prindërve) dhe janë njohur “Me disa nga programet”, 41.6% e tyre.




Grafiku 27

Me asnjë program	13.4%
Me të gjitha programet	44.7%
Me disa programe	41.6%
Pa përgjigje	0.2%

Tabela 11



Prindërve u është kërkuar të shprehen se cilin prej programeve lëndore ato njohin, duke krijuar mundësinë e përzgjedhjes ndër lëndët që fëmija realizon në shkollë. Në këtë drejtim, rezulton se:



Grafiku 28

Referuar grafikut nr. 28, rezulton se programet lëndore që njihen më së shumti nga prindërit janë; Gjuhë amtare në 6.9% dhe Matematika në 6.1% të rasteve, duke vijuar në vlera më të ulëta për lëndët e tjera.

Lidhur me pyetjen nëse prindërit janë të informuar, “se ku mund t’i gjejnë programet lëndore?”, rezulton se, në 53.0% e tyre pohojnë se janë të informuar se ku mund t’i gjejnë ato, ndërsa në 45.9 e tyre raportojnë se nuk e kanë këtë informacion, ndërsa, prindër që nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje janë 1.1 % e tyre.




Grafiku 29

Lidhur me njohjen cilësore të programeve lëndore, prindërve, përmes pyetjes nr.31, u është kërkuar mendim; “A i njihni objektivat e programit/ve lëndore?” dhe pyetjes 32 ‘A i njihni objektivat për çdo linjë(kapitull) të programeve lëndore”.

Nga përpunimi i këtyre të dhënave, rezulton se; Prindërit i njohin objektivat e programit/ve lëndore në 29.2% të rasteve. Nuk i njohin ato në 41.8% të tyre dhe kanë njohje të pjesshme në 28.4% të tyre. Nuk kanë dhënë përgjigje për këtë aspekt, 0.5% e prindërve.

Ndërsa, lidhur me njohjen e objektivave për çdo linjë/kapitull të programit/ve lëndore, rezulton kjo situatë: 24.2% e prindërve pohojnë se i njohin objektivat për linjë/kapitull të programit/ve. Nuk i njohin ato në 38.4% e tyre dhe kanë njohje të pjesshme 36.9% të rasteve.



Grafiku 30




Grafiku 31

Me pyetjen nr.33, “A jeni orientuar/këshilluar nga mësuesja që të njiheni me programet lëndore”?, është synuar që të evidencohet roli dhe përvoja që ka shkolla në zhvillimin e këtij aspekti në mbështetjen e prindërve. Nga të dhënat e përpunuara, rezulton se; 49.9% të rasteve mësuesja i ka orientuar/këshilluar prindërit për njohjen e programeve lëndore, ndërsa, 49.4% e tyre pohojnë se nuk janë orientuar/këshilluar nga mësuesja. Gjithashtu, me pyetjen, “A mendoni se shkolla duhet t`i pajisë prindërit me programet lëndore”?, është synuar njohja e mendimit të prindërve mbi rëndësinë dhe nevojën që kanë ato për njohjen e programeve lëndore. Në këtë kontekst ka rezultuar se: 58.8% e prindërve e mendojnë të nevojshme që shkolla t`i pajisë ato me programet lëndore, 24.7% e tyre e mendojnë të pa nevojshme atë dhe 24.7 % e tyre nuk janë të vetëdijshëm nëse shkolla duhet, ose jo që t`i pajisë ato me programet lëndore.




Grafiku 32



Grafiku 33

Me pyetjen 35, u është kërkuar vlerësimi i tyre lidhur me cilësinë e procesit mësimor që nxënësi/zhvillon në klasë. Me këtë pyetje është synuar që të njihet perceptimi që kanë prindërit për këtë aspekt. Nga përpunimi i përgjigjeve, rezulton se

## Për organizimin e procesit të edukimit në familje




Grafiku 34

Me pyetjet e kësaj rubrike është synuar mbledhja e informacionit lidhur me aspekte të organizimit të procesit mësimor që zhvillojnë në familje. Në këtë drejtim është synuar të njihet vlerësimi që kanë prindërit për: *Mjedisin mësimor të familjes*.

Vlerësimi që ato kanë për ngarkesën mësimore që fëmija/nxënësi duhet të realizojë në shtëpi. Për të evidencuar se cili prej prindërve është më i përfshirë në procesin e edukimit në këtë moshë. Mendimi që kanë prindërit lidhur me nevojën për mësim plotësues të fëmijës së tyre.


Gjithashtu, është synuar që të mblidhet informacion edhe për aspekte metodike të zhvillimit të këtij procesi në familje. Në këtë aspekt janë mbledhur të dhëna për materialet mësimore në të cilat referohen prindërit, përdorimi apo jo i teksteve ndihmëse, si dhe identifikimin e nevojave/vështirësive që kanë prindërit në realizimin e ndihmës së tyre ndaj fëmijëve. Nga përpunimi i të dhënave për këto aspekte, rezultojnë:



Grafiku 35


Në 75.2% të rasteve prindërit e vlerësojnë *normale* ngarkesën mësimore që fëmijët realizojnë në klasë, ndërsa 19.9% e tyre, e vlerësojnë atë si të *mbingarkuar* dhe 4.1% e prindërve e vlerësojnë si të *ulët*.

Prindërit në 20.8% të rasteve mendojnë se ngarkesa mësimore ka ndikuar në nivelin e stresit tek fëmija, ndërsa 55.4 nuk mendojnë se ngarkesa mësimore është shkaktar stresi për fëmijën dhe 25.5% e tyre nuk e dinë nëse ngarkesa është shkaktar stresi për fëmijën. Nuk janë përgjigjur për këtë pyetje 1.3% e prindërve



Grafiku 36

Si e vlerësoni mjedisin mësimor që keni në shtëpi?



Sa i përket vlerësimit të mjedisit mësimor, të krijuar në shtëpi, rezulton se në 55.4% të prindërve e vlerësojnë “të mirë”. 22.5% e tyre vlerësojnë se mjedisi i tyre mësimor duhet të përmirësohet dhe e vlerësojnë mjedisin si “shumë të mirë, 20.8% e prindërve. Nuk i janë përgjigjur kësaj pyetje 1.3% e prindërve.

Grafiku 37

Rezultatet tregojnë se procesi mësimor në familje, organizohet dhe zhvillohet më së shumti nga nënat, se sa nga baballarët dhe gjithashtu, fëmijët në këtë proces ndjehen më mirë me nënat, se sa me baballarët. Konkretisht, për këto dy aspekte, rezulton se në 85% të rasteve janë nënat ato që ndihmojnë dhe/ose organizojnë procesin mësimor në familje dhe vetëm në 13.9% pohohet se është babai ai që ndihmon më shumë fëmijën në procesin mësimor që realizohet në familje.



Grafiku 38



Grafiku 39

Në pothuaj të njëjtat vlera, rezulton edhe ndjesia që kanë fëmijët lidhur me mbështetjen që ofrojnë prindërit.

Lidhur me konsideratën që kanë prindërit për ngarkesën mësimore që nxënësit duhet të realizojnë në shtëpi, rezulton se; 88.4% e prindërve e vlerësojnë si normale ngarkesën që fëmijët duhet të realizojnë në shtëpi, ndërsa 9.1% e tyre e vlerësojnë si të mbingarkuar ketë aktivitet dhe vetëm 2.3% e prindërve, pohojnë se ngarkesa mësimore që fëmijët duhet të realizojnë në familje është “e ulët”.




Grafiku 40



Grafiku 41


Pyetjes “ A e ndjeni të nevojshme se fëmija juaj duhet të ndjekë kurse mësimore private?”, ka rezultuar se, 34.3% e prindërve e vlerësojnë të nevojshme që fëmija i/e tyre të frekuentojë kurset mësimore private, ndërsa 65.4% e tyre, pohojnë se nuk e kanë të nevojshme një gjë të tillë.

Në procesin mësimor që realizohet në familje, prindërit, krahas teksteve shkollore përdorin edhe tekste të tjera ndihmëse dhe/ose plotësuese. Kështu, 46.8% e prindërve pohojnë se përdorin tekste ndihmëse dhe 53% e tyre nuk përdorin të tillë tekste.




Grafiku 42

Lidhur me frekuentimin e kurseve private, rezulton se në 18.4% të rasteve, pohohet se fëmijët frekuentojnë kurset mësimore private. Në vijim të nevojave që kanë prindërit për kurse mësimore private, rezulton se lënda “Gjuhë e huaj”, dhe lënda “Matematikë”, janë ndër lëndët që pasqyrojnë kërkesën apo nevojën më të lartë që prindërit të dërgojnë fëmijët të ndjekin edhe kurse private.



Grafiku 43


Në këtë drejtim, rezulton se në 3.7% të prindërve, pohojnë se fëmijët ndjekin kurse mësimore private për lëndën e “Gjuhë amtare”, 25.3% ndjekin kurse mësimore për lëndën “Gjuhë e huaj” dhe 4.6% ndjekin kurse në lëndën e “Matematikës”.



Grafiku 44

Për aspektin organizativ të procesit mësimor që realizohet në familje, prindërve u është kërkuar informacion, lidhur me dokumentet kurrikulare dhe aspekte të tjera të kësaj natyre, në të cilat referohen prindërit gjatë realizimit të këtij procesi. Në këtë kontekst, rezulton se “Teksti shkollor”, “Porositë e mësueses”, “Teksti dhe Programi mësimor “janë “mjetet” kryesore në të cilët prindërit referohen gjatë procesit mësimor që ata organizojnë në mbështetje të fëmijëve. Ndërsa, “Programi lëndor” rezulton më pak i preferuar apo i referuar nga prindërit gjatë procesit mësimor në familje.


**Prindërit, gjatë procesit mësimor në shtëpi, i referohen:**



Grafiku 45

Me pyetjen se “në cilat faza të procesit mësimor që realizohet në familje keni vështirësi?”, është synuar që të evidencohen vështirësitë metodike që kanë prindërit në organizimin e procesit. Nga përpunimi i të dhënave të mbledhura, rezulton se 24.9% të rasteve, prindërit pohojnë se kanë vështirësi në të gjitha fazat e procesit, në 19.7% e tyre pohojnë se kanë vështirësi në realizimin e procesit, në 12.9% të rasteve, pohojnë se kanë vështirësi në vlerësimin e procesit dhe 14.1%, kanë vështirësi në organizimin e tij. Prindërit që pohojnë se nuk kanë vështirësi në asnjërën prej fazave, përfaqësojnë 34.5 të të anketuarve.

**Prindërit, gjatë procesit mësimor në shtëpi, kanë vështirësi në fazat:**



Grafiku 46

## KAPITULLI I PESTË

### 5 DISKUTIMI

#### 5.1 Diskutimi i gjetjeve nga analiza e politikave arsimore

Duke ju referuar rezultateve të pasqyruara më lart dhe duke i analizuar ato në mënyrë të veçantë në kontekstin e objektivave të këtij studimi, rezulton se:

Partneriteti dhe bashkëpunimi i shkollës me prindërit po shfaqet dhe trajtohet si një ndër tematikat qendrore në diskutimin dhe mendimin e bashkësisë profesionale të fushës së edukimit. Përvojat dhe modelet e krijuara sot në Evropë dhe më gjerë, po e paraqesin bashkëpunimin e shkollës me prindërit, si një domosdoshmëri në përpjekjet për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor. Ky aspekt, pikërisht për shkak të potencialeve që bashkësia prindërore mbart, po paraqitet sot si një fushë e veçantë e menaxhimit dhe administrimit të cilësisë së shërbimit arsimor duke ofruar një dimensionon të ri në rolin dhe funksionet e institucioneve shkollore. Gjetjet dhe rekomandimet e kërkuesve shkencor të përfshirë në këtë diskutim, po evidencojnë *angazhimin* e prindërve si një formë e veçantë e përfshirjes së tyre në veprimtarinë e shkollës. Ky aspekt i referohet gjetjes dhe adoptimit të formave, metodikave dhe/ose teknologjive që i mundësojnë prindit angazhimin direkt në procesin e nxënies së fëmijës së tij. Përvojat e shqyrtuara dhe përshkruara më lart, tregojnë që ky aspekt, jo vetëm është pranuar nga politikëbërësit dhe vendimmarrësit në nivele të sistemit arsimor, ç`ka dëshmohet me nismat ligjore dhe normative që u trajtuan më lart, por janë krijuar dhe po zhvillohen përvoja e modele konkrete që e trajtojnë këtë aspekt si një fushë e veçantë e menaxhimit në nivel shkolle, në funksion të maksimizimit të cilësisë së shërbimit të saj.

Edhe në vendin tonë, reformat dhe politikat arsimore të ndërmarra gjatë viteve të fundit, kanë konsideruar domosdoshmërinë e përfshirjes së prindërve në jetën dhe veprimtarinë e shkollës. Siç kemi përshkruar më lart, në vendin tonë është krijuar tashmë një mbështetje sa normative aq edhe përmbajtësore, që ka siguruar përfshirjen e prindërve në menaxhimin e shërbimit arsimor. Përbën një pritshmëri dhe qasje bashkëkohore për sistemin tonë arsimor, fakti që ndër Standardet e Përgjithshme të Mësuesit, “bashkëpunimi me komunitetin”, dhe treguesit e këtij standardi, evidencohen si standard dhe aftësi të veçanta në profilin dhe në performancën që i kërkohet mësuesit në ofrimin e shërbimit.



Realizimi dhe përmbushja profesionale e treguesve të këtij standardi nga ana e mësuesve, mbetet një sfidë profesionale për të gjitha strukturat dhe institucionet e sistemit arsimor, përfshi këtu institucionet e arsimit të lartë, shkollën, mësuesit dhe strukturat profesionale partnere që mbështesin zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve.

### **5.1.1 Kuadri normativ dhe rregullator i bashkëpunimit shkollë-prindër**

Mbështetja normative dhe rregullatore që pasqyrohet në aktet aktuale ligjore dhe nënligjore, që janë aktualisht në fuqi në sistemin tonë arsimor parauniversitar, përbën një investim të konsiderueshëm dhe ka ndihmuar në ndërtimin e partneritetit të shkollës me familjen në vendin tonë.

Ajo ka mundësuar vendosjen e një komunikimi dhe bashkëpunimi të qëndrueshëm ndërmjet këtyre dy aktorëve. Megjithatë, vlerësojmë se kjo mbështetje ka mundësuar vetëm *përfshirjen* e prindërve në aspektin menaxhues dhe administrues të shkollës, ndërsa mbetet që të zhvillohen aktet normative dhe modelet e metodologjitë që mundësojnë *angazhimin* efektiv të prindërve në realizimin e veprimtarive mësimore që ato realizojnë në shtëpi në mbështetje të maksimalizimit të arritjeve akademike të fëmijëve në shkollë.

### **5.1.2 Zhvillimi profesional i mësuesve dhe drejtuesve në shërbim**

Skema e zhvillimit profesional të punonjësve mësimor, përbën tashmë një realitet jo vetëm ligjor, por edhe një përvojë të ndërtuar, si në nivelin e shkollës, ashtu edhe në nivelin e sistemit arsimor, e cila synon të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm profesional të drejtuesve dhe mësuesve të institucioneve shkollore. Megjithatë, edhe në këtë strukturë dhe mundësi të zhvillimit profesional, mendojmë që bashkëpunimi i shkollës/mësuesve me prindërit nuk ka gjetur hapësirën e nevojshme për trajtimin e plotë të këtij bashkëpunimi dhe në mënyrë të veçantë në angazhimin e tyre.

Në veprimtaritë kualifikuese të planifikuara në nivel shkolle, konstatohet se nuk është krijuar përvoja metodike e ndërtimit dhe e zhvillimit të marrëdhënieve me prindërit, të orientuar në angazhimin e tyre në realizimin cilësor të veprimtarive mësimore nga fëmija në shtëpi. Edhe në këndvështrimin e drejtimit dhe menaxhimit të shkollës, evidencohet se ky aspekt nuk është pjesë e treguesve të cilësisë dhe performancës që ofrojnë mësuesit. Format ligjore të përcaktuara në

ligjin për sistemin arsimor para universitar, përbejnë një mundësi konkrete për shkollën për zhvillimin edhe të këtij aspekti, në përputhje me realitetin dhe nevojat që ka çdo shkollë.

Gjithashtu edhe nga sistemi i zhvillimit profesional që zbatohet në nivel sistemi, i cili bazohet në modelin e “kërkesës dhe ofertës”, konstatohet se mbështetja e prindërve për angazhimin e tyre në procesin mësimor, nuk është identifikuar si nevojë dhe aq më pak si domosdoshmëri për trajnime dhe kualifikime të punonjësve mësimor në këtë drejtim. Metodikat e vlerësimit të krijuara si në procesin e vetë-vlerësimit, ashtu dhe në ato të vlerësimit të jashtëm të shkollës, tregojnë se aftësia e shkollës dhe përkatësisht e mësuesve për ndërtuar me prindërit marrëdhënie që u mundëson atyre angazhimin, është një përvojë e munguar e shkollës sonë.

Mungesa e ofertave trajnuese dhe kualifikuese që evidencohet në listat e nevojave, të përshkruara më lart, tregon se komuniteti ynë i mësuesve, drejtuesve të shkollave, specialistëve, kërkuesve dhe madje edhe të administratorëve të sistemit arsimor, nuk ka arritur të krijojë vetëdijen dhe ndjeshmërinë profesionale për potencialin që përfaqësojnë prindërit, qoftë si faktorë të riskut, ashtu dhe të suksesit të nxënësit në arritjet e tij akademike.

Nga shqyrtimi i “Standardeve të drejtorit të institucioneve arsimor” dhe “Programit të zhvillimit profesional për kualifikimin e drejtorëve të institucioneve arsimore”, rezulton se bashkëpunimi me prindërit konsiderohet si përfshirje dhe jo si angazhim i tyre në procesin e të nxënësit. Angazhimi i prindërve në procesin e të nxënësit nuk trajtohet si një aspekt dhe kompetencë e veçantë e drejtorit të institucionit shkollor në menaxhimin e bashkëpunimit të mësuesve me prindërit. Në këtë kontekst, drejtorët e institucioneve shkollore, në procesin e zhvillimit të tyre profesional, nuk mbështeten me njohuri dhe aftësi teorike, praktike dhe aq më pak metodologjike që mundësojnë zhvillimin e angazhimit të prindërve në procesin e nxënësit.

### **5.1.3 Programet e studimit të IAL-ve në formimin e mësuesve të rinj**

Gjithashtu, edhe kurrikulat e programeve të studimit që zbatohen në institucionet e arsimit të lartë për formimin e mësuesve të rinj të arsimit fillor, mendoj se e trajtojnë partneritetin shkollë familje në mënyrë të pjesshme.

Ato mjaftohen vetëm me trajtimin e rëndësisë që ka ky bashkëpunim në pjesëmarrjen e suksesshme të nxënësit në shkollë. Ndërkohë që mbeten të pa trajtuara, në kuptimin teorik dhe praktik, aftësitë, teknikat, metodat dhe kompetencat që duhet të zotërojnë mësuesit në ndërtimin

dhe zhvillimin efektiv të bashkëpunimit me prindërit në funksion të angazhimit efektiv të tyre në realizimin e kurrikulave dhe veprimtarive shkollore nga fëmija.

Gjithashtu, edhe në aspektin didaktik të lëndëve dhe moduleve që zhvillohen në këto programe, rezultojnë të mos trajtohen treguesit e suksesit në aftësitë e të shkruarit, të lexuarit dhe aftësitë matematikore, të cilat sikurse kemi theksuar më lart, zënë një pjesë të konsiderueshme të programeve mësimore të këtyre lëndëve, që zhvillohen në ciklin fillor.

## **5.2 Diskutimi i gjetjeve nga studimi pjesëmarrësve në studim**

### **5.2.1 Karakteristika të komunitetit prindëror në shkolla tona**

Komuniteti prindëror i shkollave tona, evidencon si karakteristikë të dukshme, nivelin e ulët arsimor dhe profesionin e prindërve. Tabelat. 6 dhe 8, tregojnë se prindërit/nënat me arsim bazë, pra me nivel minimal edukimi janë 33.4%, me arsim të mesëm 36.3% dhe ato që ushtrojnë profesionin e mësuesit/eses, pra që gëzojnë një kapacitet dhe/ose përvojë në mësimdhënie, janë vetëm 7.7% e prindërve/nënave. Në këto kushte, gjykoj që prindërit/nënat që raportojnë si nivel arsimor, nivelin bazë të arsimimit dhe ato që janë me arsim të mesëm, përfaqësojnë një faktor që mund ta përcaktojmë si faktor kufizues dhe madje që riskon arritjet cilësore të shërbimit arsimor që fëmijët e tyre përfitojnë në shkollë, pasi nuk kanë as formimin dhe as përvojën e duhur për mbështetjen profesionale të fëmijëve të tyre në procesin e nxënies në shtëpi.

Shkollat tona edhe pse kanë evidenca të dokumentuara të këtyre treguesve, nuk kanë arritur të krijojnë përvoja, modele dhe metodologji se si ti trajtojnë dhe menaxhojnë këto tregues me qëllim që, prindërit nga faktor kufizues dhe risku, të kthehen në aktor që kontribuojnë në pjesëmarrjen dhe arritjet e suksesshme të fëmijës në shkollë.

Në kontekstin e angazhimit të prindërve në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, siç rezultojnë në grafikun 39, nënat, në 85.3% të rasteve janë më të identifikuar dhe më të përfshira në procesin e të mësuarit të fëmijës në shtëpi gjatë këtij cikli edukimi dhe njëkohësisht më të preferuara (83.7%) edhe nga vetë fëmijët për t'u konsultuar lidhur me realizimin e detyrave të tyre të shtëpisë apo procesit në tërësi.

Duke ju referuar kësaj karakteristike, ku ndër prindërit, *nënat* janë më të pranishme në komunikimin dhe bashkëpunimin me shkollën lidhur me ecurinë dhe arritjet e nxënësve,

vlerësojmë se përbën avantazh për shkollën mungesa e barrierave me natyrë gjinore, dhe favorizon zgjerimin dhe efektivitetin e këtij bashkëpunimi, pasi edhe mësimdhënësit e këtij cikli në shkollat e qytetit të Tiranës, në 91 % të tyre janë mësuese dhe në shkallë vendi, ky tregues është 82.8%(MAS 2013).

## 5.2.2 Kompetencat akademike, njohja dhe qëndrimi i prindërve

Lidhur me kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, përmes instrumentit të përshkruar më lart dhe përkatësisht të pyetjeve të adresuara në këtë rubrikë, janë vëzhguar dy nga katër aftësitë e kësaj kompetence dhe pikërisht; “*Të shkruarit*” dhe “*Të lexuarit*”. Këto aftësi janë pjesë përbërëse e programeve lëndore të Gjuhës shqipe dhe trajtohen si linja apo kapituj të veçantë të tyre. Përzgjedhja e këtyre dy aftësive nga programi lëndor i kësaj lëndë, është bërë mbështetur në dy kriterë:

1. Kriteri i *matshmërisë* së tyre, që do të thotë se veprimtaritë e këtyre linjave/kapitujve përbëhen nga elementë të matshëm në terma kohorë dhe cilësor.
2. Kriteri i rëndësisë apo hapësirës që këto linja përfaqësojnë në raport me programin lëndor.

Në këtë kontekst, siç evidencohet në tabelën në vijim, rezulton se në arsimin fillor, të dy linjat, *të shkruarit* dhe *të lexuarit*, përfaqësojnë veprimtaritë mësimore më të rëndësishme të programit/ve lëndore dhe për këtë arsye kanë edhe fondin me të madh të orëve mësimore vjetore.

Tabela 12 Linjat e programit “Gjuhë shqipe” ne ciklin fillor

Klasa	Lënda	Fusha/Linja				Orë gjithsej të programit
		Të lexuarit		Të shkruarit		
		Orë të Linjës	%	Orë të linjës	% në program	
I	Gjuhë Shqipe (Abetare)	84	30 %	84	30 %	280 orë
II	Gjuhë Shqipe	120	42%	30	10%	280 orë
III	Gjuhë Shqipe	90	42%	25	12%	210 orë

IV	Gjuhe Amtare	52	30%	15	26%	175 orë
V	Gjuhë Shqipe	65	37%	15	8.5%	175 orë

Nga rezultatet e pyetësorit, evidencohet vlerësimi që kanë prindërit për rëndësinë e këtyre dy linjave në arritjet dhe në ecurinë e suksesshme të fëmijës në procesin e edukimit dhe gjithashtu vlerësimi që ato kanë për arritjet e fëmijëve në këto dy linja

Vlerësimi i prindërve për *rëndësinë* e në formimin e fëmijës.

Vlerësimi i prindërve për *cilësinë e të shkruarit* të shkruarit të fëmijës së tyre

Shumë e rëndësishme	66.6%
E rëndësishme	32%

	Nena	Babi
Shumë të mirë	40.4%	38.4%
Të mirë	48.9%	50%
Mjaftueshëm	10.3 %	10%

Ndërsa, për aftësinë e të lexuarit rezulton se:

Vlerësimi i prindërve për *Rëndësinë e të lexuarit*

Vlerësimi i prindërve *Për cilësisë së "të Lexuarit"*

Shumë e rëndësishme	75.9%
E rëndësishme	23.2%
E parëndësishme	0.0%
Pa përgjigje	0.8%

Shumë të mirë	58.1%
Të mirë	34.1%
Mjaftueshëm	6.6%
Të dobët	0.3%
Pa përgjigje	0.9%

Nga të dhënat e rezultateve në këtë aspekt, konstatohet se ka një diferencë të konsiderueshme ndërmjet *rëndësisë* që ka të shkruarit dhe të lexuarit në ecurinë e suksesshme të fëmijës, ç'ka mund të konsiderohet edhe si pritshmëri e prindërve dhe *vlerësimi* që ato kanë për arritjet e fëmijës në këtë aftësi. Gjithashtu, kjo diferencë bëhet edhe më e theksuar, po t'i referohemi *vlerësimi që ka mësuesja* për arritjet në këto tregues. Konkretisht, vlerësimi i evidencuar nga mësuesja, rezulton:

Vlerësimi i mësueses për “të shkruarin”

Shumë të Mirë	33.1%
Të mirë	53.4%
Mjaftueshëm	11.7%

Vlerësimi i mësueses për “të lexuarin”

Shumë të mirë	48.6%
Të mirë	38.6%
Mjaftueshëm	9.0%
Të dobët	1.2%
Nuk na ka dhënë vlerësim	1.9%

Diferencat e konstatuara në këto situata, na shfaq faktin që arritjet e fëmijës në këtë aspekt, janë larg pritshmërisë që kanë prindërit dhe kjo mund të konsiderohet si një faktor apo shkaktar që prindërit, përmes veprimtarive të tyre të t’ushtuarit dhe kërkesave për cilësi, të rrisin “trysninë” tek fëmijët, me qëllim përmirësimin e preformancës në këto tregues. Ky shkaktar, shfaqet më i faktorizuar, po t’i referohemi edhe treguesve të mos-dakordësisë që kanë prindërit për vlerësimin e mësueses, të cilët, siç kemi paraqitur më lart, rezulton se 30.3% e prindërve janë pjesërisht dakord me vlerësimin e mësueses, ndërsa 7% janë pothuajse dhe aspak dakord me këtë vlerësim.

Diferencat e dakordësisë së vlerësimit që dallohen ndërmjet vlerësimit të shkollës dhe vlerësimit të prindërve për arritjet e nxënësve, mund të konsiderohet si një shkaktar që nuk mbështet dhe nuk i kontribuon ndërtimit të marrëdhënieve bashkëpunuese të shkollës dhe prindërve, përkundrazi e dëmton efektivitetin e këtij bashkëpunimi.

Shkalla e objektivitetit të vlerësimit të prindërve, sidomos për *cilësinë* e të shkruarit të fëmijës, mund të konsiderohet si një tjetër shkaktar risku për efektivitetin e mbështetjes së tyre ndaj fëmijëve. Rezultatet në këtë aspekt, dëshmojnë se 45.6 % e prindërve pohojnë se nuk i njohin *treguesit e cilësisë* së kësaj aftësie, kjo do të thotë, që ata nuk arrijnë dhe/ose nuk janë objektiv në identifikimin e suksesit dhe sidomos të nevojave reale të fëmijës për përmirësim.

Gjithashtu, në nivel të konsiderueshëm shfaqet edhe shkalla e subjektivitetit të vlerësimit të prindërve për cilësinë e të *lexuarit*. Rezultatet tregojnë se 28% e prindërve nuk i njohin treguesit e suksesit të kësaj aftësie. Në këto, kushte edhe në këtë aspekt roli dhe kontributi i prindërve është i munguar.

Lidhur me kompetencat matematikore, duke ju referuar rezultateve në tërësi të rubrikës përkatëse të pyetësorit, evidencohet se ka gjithashtu një diferencë të madhe, ndërmjet pohimit

të prindërve për *rëndësinë* që kanë kompetencat matematikore në formimin e fëmijës dhe *vlerësimin* të tyre konkret për rezultatet apo arritjet që fëmija ka në këtë kompetencë. Siç shikohet në tabelat në vijim,

Kompetenca "Matematikore" dhe formimi i fëmijës

	Nëna	Babai
Shumë e rëndësishme	88.7%	85.3%
E rëndësishme	10.0%	11.6%
E parëndësishme	0.2%	0.1%
Pa përgjigje	1.1%	3.0%

Vlerësimi i rezultateve të fëmijës në Matematikë

	Nëna	Babai
Shumë të mirë	54.1%	50.8%
Të mirë	36.1%	38.1%
Mjaftueshëm	9.2%	8.9%
Të dobët	0.2%	0.1%

prindërit, në mbi 88% të rasteve e vlerësojnë këtë kompetencë si “*shumë të rëndësishme*”. Kjo do të thotë se edhe pritshmëria e tyre për rezultatet e fëmijëve, në këtë aspekt të jetë shumë e lartë. Ndërkaq, vlerësimi i tyre, për rezultatet e arritura nga fëmijët janë; 57% të rasteve “*Shumë mirë*” dhe në 36% të rasteve “*Mirë*”. Nga të dhënat e këtyre dy pohimeve, evidencohet një diferencë e konsiderueshme ndërmjet pritshmërive të prindërve dhe rezultateve të arritura nga fëmija.

Prindërit janë të njohur me vlerësimin që ka mësuesja për cilësinë e arritjeve të nxënësve. Domethënës është fakti mbi *dakordësinë* që kanë prindërit për vlerësimin e mësueses. Rezultatet na tregojnë se në 28% të rasteve, prindërit janë *pjesërisht dakord* me këtë vlerësim dhe në 2.8% të rasteve prindërit nuk janë *aspak dakord* me vlerësimin e mësueses.

Mungesa e dakordësisë ndërmjet prindërve dhe mësueses për arritjet e nxënësit, mund të ketë shumë arsye, por në tërësinë e saj, ato mund të konsiderohen si faktorë stresant të cilët ndikojnë negativisht, sidomos në gatishmërinë e nxënësit për një pjesëmarrje efektive në proces dhe cilësinë metodologjike të mjedisit mësimor.

Nga të dhënat lidhur me pohimin e prindërve për mundësinë/aftësinë e tyre për të ndihmuar fëmijën në të ushtruarin në Matematikë, rezultojnë se në 18.7% të prindërve pohojnë se nuk dinë të ndihmojnë fëmijën në këtë lëndë, ndërsa 35.2% e tyre pohojnë se “jo plotësisht” mund ta ndihmojnë fëmijën gjatë të mësuarit në shtëpi. Siç shikohet nga të dhënat, prindërit paraqesin nevojë dhe/ose mangësi të konsiderueshme për të mundësuar një mbështetje apo tutorim korrekt në procesin që ata organizojnë në shtëpi.

Kjo situatë na mundëson të gjykojmë që, procesi që organizojnë prindërit në mbështetje të fëmijës të jetë një faktor që nuk e ndikon pozitivisht vijueshmërinë dhe suksesin e nxënësit në këtë kompetencë. Ky gjykim bëhet edhe më i besueshëm, po të konsiderojmë edhe faktin se në 29% të prindërve pohojnë se nuk i njohin treguesit e cilësisë të kësaj kompetence.

Rezultatet e pyetësorit lidhur me këshillimin metodik që shkolla/mësuesja u ofron prindërve për ndihmën e tyre ndaj fëmijëve, paraqesin një situatë e cila mund të trajtohet në dy këndvështrime:

- *e para*, si nevojat dhe/ose kërkesa që prindërit kanë për të marrë këshillim metodik. Kjo konsideratë, përforcohet edhe më shumë, po t'i referohemi rezultateve të pyetjes “Shkolla duhet t'i njohë prindërit me “treguesit e cilësisë” të kompetencës/ve matematikore”, sipas të cilave, 88.3% e prindërve pohojnë se shkolla duhet t'i njohë ata me këto tregues.
- *e dyta*, si nivel i qasjes apo i konsiderimit që ka shkolla si institucion për domosdoshmërinë e ofrimit të këshillimit metodologjik për prindërit, dhe trajtimin e këtij aspekti si një ndër veprimtaritë e nevojshme të bashkëpunimit të shkollës me prindërit.

### **5.2.3 Njohja e programeve lëndore nga prindërit**

Niveli dhe cilësia e njohjes që kanë prindërit për programet lëndore në tërësi është një tjetër aspekt i informacionit të mbledhur përmes pyetësorit. Në modelin tonë të organizimit dhe funksionimit të sistemit arsimor para universitar, programet lëndore, krahas planeve dhe teksteve mësimore, përfaqësojnë një ndër elementët më të rëndësishëm të planifikimit dhe zhvillimit të kurrikulës në shkollë. Ato, janë në qendër të procesit të mësimdhënies dhe njëkohësisht përfaqësojnë dokumentin normativ në të cilin referohet e gjithë metodika monitoruese dhe vlerësuese e arritjeve dhe cilësisë që ofrohet nga institucionet shkollore dhe sistemi në tërësi.

Parë në këtë këndvështrim, programet lëndore ashtu si dhe teksti mësimor janë dy elementët e kurrikulës mbi të cilët ndërtohet edhe bashkëpunimin e mësuesit me prindërit në procesin e nxënies. Ndërsa për mësuesin përbën detyrim që procesi i mësimdhënies të organizohet, realizohet dhe të vlerësohet duke ju referuar programit, si në aspektin sasior ashtu dhe në atë cilësor, kjo qasje nuk evidentohet në procesin e mësimor që prindërit realizojnë në shtëpi. Kjo



konsideratë mbështetet në të dhënat që raportohen nga pyetjet e adresuara në këtë rubrikë të pyetësorit, sipas të cilave rezulton se 13.4% e prindërve të intervistuar nuk njohin asnjë nga programet lëndore dhe se 41.6% e tyre njohin "disa nga programet".

Referuar pohimeve të prindërve lidhur me cilësinë e njohjes së programeve, rezulton se prindërit nuk i njohin *objektivat* e programit në një përmasë të madhe të tyre (41.8%). Gjithashtu, nga ana e tyre nuk njihen as objektivat e linjave apo kapitujve (38.4%), që janë pjesë e strukturës përmbajtësore të programeve lëndore. Kjo do të thotë që procesi i organizuar nga prindërit në shtëpi nuk referohet në objektiva qoftë të programit në tërësi, ashtu dhe të linjave/kapitujve në veçanti. Në këtë kontekst gjykojmë që procesi mësimor në shtëpi nuk është në vijim dhe në funksion të procesit mësimor që zhvillohet në klasë/shkollë dhe për rrjedhojë, nuk i kontribuon efektivitetit të këtij procesi.

- Mos njohja e objektivave të programit dhe sidomos të linjave, nga ana e prindërve përbën një kufizim dhe barrierë të madhe për kontributin dhe efektivitetin e këtij procesi.
- Mos njohja e objektivave të programit dhe të linjave, sjell si pasojë që procesi mësimor që realizohet në shtëpi të mos jetë i projektuar në objektiva konkret dhe të matshëm, ç`ka e kufizon dhe pengon identifikimin e arritjes së progresit apo mungesës së tij në raport me objektivat.
- Mos njohja e objektivave nga ana e prindërve, sjell si pasojë që mësuesit dhe prindërit të mos ndajnë të njëjtën konsideratë vlerësuese për arritjet dhe sidomos për nevojat në të cilat duhet të ushtrohen dhe përmirësohen fëmijët.
- Programet mësimore, janë të strukturuar dhe të adresuara vetëm për mësuesit dhe jo për prindërit. Ato nuk pasqyrojnë tregues të suksesit për njësitë mësimore që kanë në përmbajtje. Kjo përbën një disavantazh për prindërit, pasi ndërsa mësuesit mbështeten me trajnime dhe kualifikime për realizimin e tyre, prindërit nuk e kanë këtë mundësi.

Një tjetër këndvështrim i rezultateve të kësaj rubrike të pyetësorit, është ai i aspektit menaxherial të shkollës.

- Shkolla nuk njeh kapacitetin, mundësitë dhe nevojat që kanë prindërit për të qenë të suksesshëm në mbështetjen e tyre ndaj fëmijëve.

Prindërit nuk janë as të orientuar nga shkolla se ku mund t'i gjejnë programet lëndore dhe as të këshilluar se ata *duhet* t'i njohin këta programe. Kjo do të thotë se shkolla jonë nuk e ka krijuar përvojën për mbështetjen dhe orientimin e prindërve mbi domosdoshmërinë e njohjes së programeve mësimore nga ana e tyre. Pse është e domosdoshme që prindërit të njohin programin mësimor? Sepse;

- *së pari*, do të mundësonte që procesi mësimor që ata organizojnë në shtëpi të jetë në unison dhe në funksion të procesit mësimor që fëmijët/nxënësit përfitojnë në klasë.
- *së dyti*, njohja e programeve lëndore, do t'i ndihmonte ata të kontribuonin në mënyrë më efektive në progresin e fëmijës dhe sidomos në identifikimin dhe mbështetjen e nevojave reale të tyre.
- *së treti*, njohja e programeve nga prindërit do të ndikonte në reduktimin ose racionalizimin e perceptimit që ata kanë për nivelin e stresit tek fëmijët e tyre dhe që si shkaktar të tij evidencojnë ngarkesën mësimore siç raportohet nga ata në grafikun 36

#### **5.2.4 Karakteristika të procesit të edukimit të organizuar në shtëpi**

Konsiderata dhe vlerësimi që raportojnë prindërit për cilësinë e mjedisit mësimor që ato kanë krijuar në familje, siç tregohet në grafikun 37, përbën një parakusht të konsiderueshëm në mbështetje të realizimit cilësor të procesit të të mësuarit në shtëpi, pasi siç kemi përshkruar edhe më lart, mjedisi dhe sigurisht cilësia e tij, përfaqëson një ndër dimensionet apo parakushtet e realizimit cilësor të këtij shërbimi.

Lidhur me ngarkesën mësimore që realizojnë fëmijët në shkollë, prindërit, siç tregon tabela 35, edhe pse dominon mendimi se nxënësit realizojnë një ngarkesë mësimore normale, (vetëm 9% e tyre mendojnë se ngarkesa mësimore është mbingarkuar), megjithatë, ata(prindërit) gjithashtu pohojnë se përdorin edhe tekste të tjera ndihmëse dhe ndiejnë nevojën dhe frekuentojnë kurset plotësuese (tabelat 42, 43). Nga këto rezultate, vlerësojmë se prindërit nuk kanë një besueshmëri të plotë mbi mjaftueshmërinë e shërbimit arsimor që përfitojnë, si dhe të cilësisë së tij.

Në qendër të procesit mësimor që prindërit realizojnë në familje është teksti mësimor, siç shikohet edhe në grafikun 45. Nisur nga ky tregues, vlerësojmë se tekstet mësimore edhe pse në

pikëpamjen e formatit dhe strukturës së tyre, përmbajnë rubrika që evidencojnë njësitë e mësuar në temat përkatës, ato përsëri nuk janë të mjaftueshme për të ndihmuar prindërit për të dalluar dinamikën e progresit, pasi, tekstet nuk përfaqësojnë tregues apo standarde të të nxënës, të cilat të ofrojnë informacion mbi nivelin/shkallën e përvetësimit apo nxënies/arritjeve nga nxënësi.

Nivelin e vështirësive që kanë prindërit në faza të ndryshme të procesit të të mësuarit në shtëpi, e konsiderojmë shqetësuese. Tabelat dhe grafikët 46, tregojnë se paraqesin vështirësi në dy fazat kryesore të këtij procesi siç janë; *realizmi* dhe *vlerësimi* i procesit. Vështirësitë në këto dy faza, paraqesin informacionin më të rëndësishëm për të kuptuar që suksesi në kontributin e prindërve në procesin e edukimit, është shumë i riskuar. Njëkohësisht, këto të dhëna paraqesin edhe nevojat në të cilat duhet të përqendrohen veprimtaritë mbështetëse, trajnuese dhe konsultuese të shkollës në tërësi dhe mësuesve në veçanti, të cilët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me prindërit.

### **5.2.5 Standardizimi i metodologjisë së angazhimit të prindërve në procesin e nxënies**

Nga sa përshkruam në kapitullin “Shqyrtimi i literaturës” dhe përvojës së krijuar nga institucionet tona shkollore, evidencohet fakti, që ndërsa janë krijuar përvoja dhe modele të standardeve të bashkëpunimit të shkollës me komunitetin, diskutimi dhe qasjet teoriko-profesionale nuk kanë arritur të krijojnë një përvojë të ngjashme, të standardizimit të metodologjive që mund dhe duhet të ndiqen nga shkolla dhe mësuesit me qëllim arritjen e angazhimit efektiv të prindërve në procesin e të mësuarit dhe sidomos në atë të të nxënës.

Mendojmë që krijimi i një metodologjie të standardizuar për arritjen e angazhimit të prindërve në procesin e nxënies do të ishte me vlera për të gjithë aktorët që përfshihen në procesin e edukimit.

Standardet e angazhimit të prindërve do të ndihmonin:

*Mësuesit*; përcaktimi i standardeve të angazhimit të prindërve, treguesve dhe teknikave përkatëse të tyre, do t'i ndihmonte mësuesit për njohjen reale të nevojave, mundësive dhe sidomos të vështirësive që kanë prindërit për një angazhim efektiv në procesin e nxënies së fëmijëve të tyre. Njohja reale nga ana e mësuesve e mundësive dhe e vështirësive të prindërve për t'u angazhuar në këtë proces, do ta ndihmonte mësuesin të planifikonte në mënyrë racionale dhe të përshtatshme ndihmën dhe mbështetjen e tyre për prindërit.

*Drejtuesit e institucioneve shkollore.* Metodologjia e standardizuar e angazhimit të prindërve në edukim, do t'i ndihmonte drejtuesit e shkollave në menaxhimin më efektiv të komunikimit dhe të bashkëpunimit me prindërit. Organizimi i strukturuar nga ana e shkollës i këtij procesi në mbështetje të prindërve, do të ndihmonte në menaxhimin dhe administrimin cilësor të shërbimit arsimor. Kjo metodologji do t'i ndihmonte drejtuesit të monitoronin cilësinë e performancës së mësuesve në standarde dhe tregues konkret dhe të matshëm.

*Prindërit;* përmes bashkëveprimit me mësuesin dhe realizimit të treguesve të këtyre standardeve, prindërit do të kenë mundësinë të intensifikojnë dhe të forcojnë marrëdhëniet me mësuesin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në funksion të interesit të tyre më të lartë, siç është suksesi i fëmijës. Për prindërit krijohet një mundësi e qartë për t'u informuar dhe aftësuar në aspektet pedagogjike dhe metodologjike të pjesëmarrjes së tyre në procesin e të mësuarit dhe nxënies.

Me qëllim mbështetjen e institucioneve shkollore dhe mësuesit në veprimtaritë e tyre në funksion të arritjes së angazhimit të prindërve në procesin e edukimit dhe atë të nxënies, më poshtë po paraqesim një model të standardeve të angazhimit të prindërve. Modeli që po paraqesim, është strukturuar në këto rubrika;

- standardet e angazhimit të prindërve,
- treguesit dhe
- instrumentet.

Rubrika e standardeve, në aspektin përmbajtësor, synon të identifikojë aspektet më tipike që konstatohen në veprimtaritë që mund të ndërmerren nga shkolla dhe mësuesit për arritjen e angazhimit të prindërve në procesin e edukimit.

Standardet që propozohen, mbështeten nga treguesit përkatës, të cilët synojnë të sjellin një dimension konkret, të monitorueshëm dhe të matshëm të veprimtarive dhe masave që ndërmerr mësuesi për këtë aspekt. Standardet dhe treguesit përkatës të tyre, mundësojnë:

- Njohjen e përgjithshme të prindërve, kontaktet dhe rrugët e komunikimit që mësuesi vendos me prindërit.
- Njohjen e vështirësive që kanë prindërit në procesin e të mësuarit në shtëpi.
- Njohjen e aspekteve metodike që ofron mësuesi për kapërcimin e vështirësive që kanë prindërit.

Standardet e angazhimit të prindërve janë organizuar në dy panele kryesore:

1. Ndërtimi i komunikimit dhe bashkëpunimit efektiv i mësuesit me prindërit.
2. Mbështetja dhe zhvillimi metodik i angazhimit të prindërve në procesin e të mësuarit dhe të nxënies.

Standardet e angazhimit të prindërve në procesin e nxënies të fëmijëve të ciklit fillor;

	<b>Standardet e angazhimit të prindërve</b>	<b>Treguesit</b>	<b>Instrumente të administrimit</b>
<b>I Ndërtimi i komunikimit dhe bashkëpunimit efektiv ndërmjet mësuesit me prindërit</b>			
Standardi 1	Mësuesit njohin prindërit dhe kanë vendosur kontaktin dhe komunikimin me prindërit.	Mësuesi ka adresë banimi, numër telefoni dhe e-adresa të çdo prindi  Mësuesi ka njohje të individualizuar për çdo prind të klasës/grupit të tij.  Mësuesi njeh nivelin arsimor të prindërve, si të nënës ashtu dhe të babait.	Skedar me të dhënat e kontaktit për çdo prind. Evidence me të dhënat e përgjithshme të prindërve (emër, mbiemër, nivelin arsimor, profesion etj.

		<p>Mësuesi njih profesionin e prindërve, si të nënës ashtu dhe të babait.</p> <p>Mësuesi ka njohje të kontekstit/statusit ekonomik-social dhe kulturor të prindërve.</p>	
Standardi 2	Mësuesi njih nivelin e interesit dhe gatishmërisë së prindërve për të bashkëpunuar me mësuesin.	Mësuesi e ka të qartë se me cilin prej prindërve duhet vendosur kontakti dhe zhvilluar bashkëpunimin për ecurinë dhe mbështetjen e fëmijës në shkollë.	<p>Intervista/Biseda me prindërit e nxënësit.</p> <p>Pohime dhe konfirmime të vetë prindërve</p>
<b>II Mbështetja dhe zhvillimi metodik i angazhimit të prindërve</b>			
Standardi 3	Mësuesi njih nivelin e njohjes së programeve nga ana e prindërve.	<p>Mësuesi u ka rekomanduar prindërve nevojën për njohjen e programeve lëndore nga ana e tyre.</p> <p>Mësuesi ka të individualizuar prindërit që kanë vështirësi në linja/kapituj të caktuar sipas lëndëve</p>	<p>Letër informuese.</p> <p>Anketa</p> <p>Biseda</p> <p>Kërkesa të prindërve</p> <p>Takime ne grup/individuale për prezantimin e përmbledhur të programeve lëndore</p> <p>Pajisjen e tyre me programet.</p>

Standardi 4	Mësuesi mbështet prindërit në realizimin e programit lëndor	<p>Mësuesi mbështet prindërit me modele dhe metodologji të situatave dhe detyrave që u jepen fëmijëve në shtëpi.</p> <p>Forma dhe metodika të kontrollit gjatë të ushtruarit.</p> <p>Mësuesi mbështet prindërit të njohin dhe të përdorin tekstet shkollore dhe ato plotësuese.</p>	<p>Shembuj tipik për çdo njësi mësimore dhe/ose kapitull apo linjë të programit.( të shkruarin, të lexuarin, veprimet matematikore etj.)</p> <p>Referenca dhe shpjegime të tekstit mësimor</p>
Standardi 5	Mësuesi njih vlerësimin që kanë prindërit për cilësinë e arritjeve të nxënësit.	<p>Mësuesi ka feedback të vazhdueshëm nga prindërit për arritjet e nxënësve.</p> <p>Mësuesi ka njohur prindërit me treguesit e suksesit për çdo lëndë (linjë/kapitull), sipas kompetencave.</p> <p>Mësuesi është i qartë për diferencat e vlerësimit të prindërve dhe ndërmerr veprime për minimizimin e tyre.</p>	<p>Anketa, shënime e-maile etj., përmes të cilave evidencohet vlerësimi i prindërve.</p> <p>Karakteristika, modele dhe situata të performimit të nivelit të lartë, të mesëm dhe të ulët gjatë të ushtruarit.</p>
Standardi 6	Mësuesi njih mjedisin mësimor të krijuar në familje dhe njih	<p>Mësuesi njih:</p> <p>Mjedisin mësimor në familje.,</p>	Informacion për mjedisin fizik në shtëpi.

	<p>modelin e prindërimit të ofruar në familje.</p>	<p>Raportin që ka prindi me fëmijën.</p> <p>Karakteristika të personalitetit dhe profilit psikologjik të prindërve.</p> <p>Marrëdhënia që ka prindi me leximin dhe edukimin në tërësi</p> <p>Modelin e planifikimit dhe organizimit të të mësuarit në shtëpi.</p>	<p>Mjetet dhe pajisjet teknologjike që ka ose jo fëmija në shtëpi.</p> <p>Ekzistenca e bibliotekës familjare dhe/ose personale.</p>
--	--	---	---



## KAPITULLI GJASHTË

### 6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Vlerësojmë se studimi arrin të provojë hipotezën dhe objektivat mbi të cilat është organizuar dhe zhvilluar.

**6.1 Përfundime lidhur me hipotezën/at e studimit:** Nga trajtimi dhe interpretimi i përshkruar në tërësinë e këtij studimi, provohet se në sistemin tonë arsimor dhe në modelin e organizimit dhe funksionimit të institucioneve tona shkollore, është krijuar një përvojë e konsiderueshme për arritjen e *përfshirjes* së prindërve në veprimtarinë e shkollës.

Ndërsa, vlerësojmë se nuk është krijuar dhe zhvilluar përvoja e *angazhimit të prindërve*, si një aspekt i veçantë i përfshirjes së tyre në realizimin e kurrikulës në përgjithësi dhe arritjeve të nxënësit në veçanti. Ky konstatim, evidencohet edhe në nivelin institucional të pasqyruar përmes politikave të munguara arsimore në këtë drejtim, por edhe në nivelin e shkollës përmes modelit dhe përvojës së saj të drejtimit dhe administrimit të institucionit arsimor në përgjithësi dhe performancës së mësuesit në veçanti..

Nga analiza e politikave arsimore të përshkruara më lart, provohet se angazhimi i prindërve nuk trajtohet si një aspekt i veçantë i përfshirjes së tyre.

Nga analizimi dhe trajtimi i përvojës organizative dhe menaxhuese të institucioneve shkollore, provohet që angazhimi i prindërve nuk është pjesë e fushave dhe treguesve të cilësisë së shërbimit arsimor që ofrohet në/nga shkollat. Në këtë kontekst, mendojmë se roli i prindërve si partner kryesor në procesin e edukimit, nuk i përgjigjet pritshmërisë që përcakton ligji për sistemin arsimor parauniversitar.

Studimi tregon që, as skema e zhvillimit profesional që ofrohet dhe zbatohet për drejtuesit dhe mësuesit në shërbim dhe as programet e formimit të mësuesve që ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë në vendin tonë, nuk e trajtojnë *angazhimin* e prindërve si një tipar dhe aspekt të veçantë të përfshirjes së tyre. Për pasojë, mësuesit dhe kandidatët për ushtrimin e profesionit të mësuesit dhe drejtuesit të shkollave, nuk janë të pajisur me njohuri, modele dhe kompetenca për zhvillimin profesional dhe efektiv të angazhimit të prindërve në edukim.

Duke ju referuar nivelit arsimor të prindërve dhe përvojës apo modeleve të munguara në shkollat tona në drejtim të angazhimit të tyre në procesin e nxënies, mund të konsiderojmë që prindërit nuk përfaqësojnë një faktor favorizues dhe mbështetës të cilësisë së shërbimit arsimor, por përkundrazi, mund të konsiderohen si faktor dhe një ndër shkaktarët e riskut të cilësisë së saj.

Niveli arsimor i prindërve në shkollat tona, rezulton i ulët në një përmasë të lartë. Njohja e kufizuar dhe e munguar e programeve mësimore lëndore dhe mungesa e aftësive dhe kompetencave metodologjike të tyre për të organizuar dhe sidomos për të vlerësuar cilësinë e arritjeve të nxënësve, bën që prindërit të dështojnë me pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në edukimin e fëmijëve.

Krahas tipareve të përshkuara më lart, diferencat dhe mos dakordësia që evidencohet ndërmjet prindërve dhe mësuesve në vlerësimin e arritjeve të nxënësit, (për aftësitë e vëzhguara në këtë studim), tregojnë që ndërmjet këtyre dy aktorëve ka një vlerësim dhe besueshmëri të ulët lidhur me kontributin e ndërsjellët të tyre në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Kjo situatë tregon që ndërmjet prindërve dhe mësuesit/ve, ka një tension potencial, i cili mund të transmetohet në atmosferën dhe mjedisin mësimor të fëmijës, si në klasë, ashtu dhe në familje, ç`ka ndikon negativisht në gatishmërinë dhe qasjen pozitive të fëmijës me përvojën e edukimit.

Studimi tregon dhe konfirmon pohimet se prindërit mbeten të gatshëm dhe shumë të interesuar për të vendosur dhe zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi me mësuesit. Duke konsideruar faktin që nënat janë më të pranishme dhe më të mirëpritura nga fëmijët në procesin e tyre të edukimit dhe faktin që mësimdhënësit në ciklin fillor të edukimit janë kryesisht mësuese, vlerësojmë se ky realitet gjinor, përbën një lehtësi dhe mundësi konkrete, për ndërtimin dhe zhvillimin më cilësor të bashkëpunimit të shkollës me prindërit, në këtë cikël të edukimit.

Studimi, përmes “Standardeve të angazhimit të prindërve”, sjell një qasje dhe këndvështrim të ri në diskutimet profesionale të edukimit në tërësi dhe të partneritetit shkollë-familje në veçanti. Modeli i propozuar i këtyre standardeve, vjen në një format konkret, funksional dhe i detajuar. Ai synon të jetë i dobishëm për mësuesit, drejtuesit dhe prindërit dhe përdorimi profesional i tyre, do të mundësojë forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit shkollë-familje dhe promovimin e një dimensionit të ri të tij.

Studimi provon se njohja e programeve mësimore dhe metodologjisë së organizimit dhe vlerësimit të cilësisë së procesit mësimor nga prindërit, ndikon në pjesëmarrjen e miqësore (ose jo) të fëmijës në procesin e të mësuarit dhe në arritjen e potencialit të tij nxënës.

Në këtë pikëpamje, prindërit në komunitetet e shkollave tona edhe pse formalisht konsiderohen si partner kryesor në procesin e edukimit, nuk janë të angazhuar në realizimin e procesit të nxënies dhe nuk janë faktor mbështetës në arritjen e potencialit nxënës të fëmijëve të tyre në ciklin fillor. Madje, duke ju referuar gjetjeve dhe interpretimeve lidhur me objektivat e studimit, mund të vlerësojmë se, prindërit për shkak të nivelit arsimor të tyre, të mos njohjes së programeve mësimore lëndore, të mungesës së aftësive dhe kompetencave metodologjike e profesionale në procesin e të mësuarit në shtëpi, përvoja e kufizuar dhe/ose e munguar e shkollës në menaxhimin e partneritetit shkollë-prindër, bën që kontributi i prindërve jo vetëm të jetë i munguar në procesin e edukimit, por ata të konsiderohen si një faktor dhe shkaktar potencial i cilësisë së ulët të shërbimit arsimor.

## **6.2 Përfundime lidhur me objektivat e studimit**

Studimi arrin të provojë se:

1. Prindërit kanë nivel të ulët në njohjen e kompetencave themelore të komunikimit në gjuhën amtare dhe nuk i njohin treguesit e suksesit të fëmijës në këtë kompetence. Në këto kushte paraqitet e kufizuar mundësia e tyre për të kontribuar në nxënien dhe përmirësimin e vazhdueshëm të arritjeve shkollore të fëmijës në këtë kompetencë.
2. Prindërit kanë nivel të ulët në njohjen e kompetencave themelore të fushës së matematikës dhe nuk i njohin treguesit e suksesit të fëmijës në këtë kompetence. Edhe në këtë kompetencë, kontributi i prindërve për mbështetjen dhe zhvillimin e arritjeve shkollore të fëmijës, është i munguar.
3. Prindërit kanë nivel të ulët të njohjes së programeve lëndore dhe për pasojë procesi i organizuar nga ata nuk referohet dhe nuk është në mbështetje të tyre.
4. Rezultatet e studimit treguan se prindërit paraqesin vështirësi në aspektet metodike të procesit të të mësuarit, siç janë organizimi i procesit dhe vlerësimi i tij.

### 6.3 Rekomandime,

Studimi e përshkruan angazhimin e prindërve në procesin e të mësuarit si një tipar të veçantë të partneritetit të shkollës me familjen. Përmasa e angazhimit të prindërve qëndron në themel të partneritetit shkollë-familje, sepse qasja e prindërve ndaj shkollës ka karakteristikë dalluese interesin individual të çdo prindi për shërbim arsimor dhe arritje shkollore sa më të mira të fëmijës. Sa më të angazhuar të jenë prindërit në procesin e të nxënimit të fëmijëve të tyre, aq më i qartë është komuniteti i shkollës dhe aq më efektiv është roli i tij në jetën dhe në veprimtarinë e shkollës dhe sidomos në arritjet e saj.

I konsideruar si i tillë, ky aspekt duhet të zhvillohet në mënyrë profesionale nga të gjithë aktorët që përfshihen në edukim. Konstatimet, rezultatet, interpretimet, propozimet dhe përfundimet e këtij studimi, mund të konsiderohen nga të gjithë aktorët e sistemit arsimor, qofshin këta politikbërës, mësues dhe drejtues të institucioneve shkollore, qofshin prindër, specialist dhe kërkues shkencor të fushës së edukimit.

Në këtë këndvështrimi, mendojmë se përfundimet dhe propozimet e këtij studimi, mund të konsiderohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, si institucioni përgjegjës për krijimin e zbatimin e politikave arsimore. Bashkëpunimi i shkollës dhe veçanërisht i mësuesve me prindërit, duhet të ri-dimensionohet, duke e orientuar këtë bashkëpunim drejtë *angazhimit* konkret të prindërve në procesin e nxënies. Për këtë arsye, angazhimi i prindërve në edukim, ka nevojë të mbështetet me një bazë normative të posaçme, e cila të mundësojë rregullat, detyrat dhe sidomos kërkesat dhe procedurat metodologjike që duhet të ndjekin punonjësit mësues (drejtues dhe mësues të shkollave) në ndërtimin dhe zhvillimin profesional të këtij aspekti të partneritetit shkollë-familje.

Arritja e angazhimit të prindërve në procesin e edukimit, kërkon `investimin` e të dy këtyre aktorëve, por mësuesit mbeten protagonistë të këtij procesi. Janë pikërisht mësuesit, ata që mund dhe duhet të organizojnë, strukturojnë dhe zhvillojnë këtë marrëdhënie në një kontekst profesional.

Angazhimi i prindërve në procesin e të nxënimit duhet të identifikohet si një ndër treguesit që përdoren për vlerësimin e cilësisë së shërbimit arsimor, në nivel sistemi dhe sidomos në nivel shkolle dhe mësuesi. Për këtë, vetë shkolla në procedurat e saj vetë-vlerësuese, por edhe

institucionet përgjegjëse për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së shërbimit arsimor, duhet të adoptojnë teknika dhe instrumente që mund të vlerësojnë këtë aspekt të veprimtarisë së shkollës dhe të mësuesve, si pjesë të performancës së përgjithshme të tyre.

Studimi evidencon domosdoshmërinë për zhvillimin profesional dhe aftësimin e mësuesve për zhvillimin e marrëdhënieve me prindërit, me fokus, angazhimin e tyre në procesin e nxënies. Në këtë drejtim, studimi mund të jetë i vlefshëm dhe i konsiderueshëm nga institucionet e arsimit të lartë. Programet e formimit të mësuesve, të ciklit të parë dhe/ose dytë, duhet ta përfshijnë dhe ta trajtojnë angazhimin e prindërve në shkollë, si në kontekstin teorik ashtu dhe në atë praktikometodologjik, me qëllimin aftësimin e mësuesve të rinj në zhvillimin profesional të këtij aspekti.

Gjetjet e dhe qasjet e këtij studimi, mund të shërbejnë për pasurimin e mëtejshëm të përvojës së krijuar në sistemin tonë arsimor, lidhur me zhvillimin profesional të mësuesve. Kërkesa për trajnime dhe kualifikime që shprehin punonjësit mësimor, njësitë arsimore vendore dhe vetë Ministria e Arsimit, duhet të përfshijë edhe kërkesën për trajnime dhe kualifikime që mundësojnë zhvillimin profesional të mësuesve për promovimin e angazhimit të prindërve në procesin e edukimit.

Gjetjet dhe përfundimet e këtij studimi, mund të bëhen të njohura për forumet e prindërve në institucionet shkollore, pasi tematika që trajtohet është plotësisht në funksion të interesit dhe të të drejtave që kanë prindërit sot kundrejt shërbimit arsimor që ata përfitojnë.

Studimi në tërësi dhe gjetjet, modeli i propozuar i Standardeve të angazhimit të prindërve dhe rekomandimet në tërësi, mund të jenë pjesë e mëtejshme e debateve dhe diskutimeve profesionale. Këto debate e diskutime, do mundësojnë pasurimin e argumenteve, diversifikimin e pikëpamjeve dhe qasjeve metodologjike, të cilat promovojnë zhvillimin efektiv të angazhimit të prindërve në edukimin e fëmijëve.

## 8 ANEKSE

### 8.1 BIBLIOGRAFIA

1. Aronson, J.Z (1996). How school can recruit hard-to reach parents. Educational Leadership p.58-80.
2. Adelman, H., Taylor, L. (2007)“Fostering school, family and community involvement – (effective strategies for creating safer schools and communities)”. p.7-9. 29-35.
3. Bux, J., Cuba, P. (2012) “Positively involving parents in their child`s education”
4. Briggs, D.C. “Your child`s self-esteem”. Dolphin Books edition;(1975).p.45.p.263-272
5. Cotton, K. Wikeland, K. (1989). “Parent involvement in education” (OERI) U.S D.
6. Canter, A. (2001) “Parents and teachers: Strategies for working together. NASP
7. Clark, L. (1996). “S.O.S: Help for parents”. 2<sup>nd</sup> edit
8. Columbo, G.(1995). Parent involvement: A key to school. NASSP.Bulletin. p. 70-76
9. Coleman, J. (1998) Parent, student and teacher collaboration; The power of three. p.175-198
10. Desforjes, R & Abouchar (2003). “ The impact of parental involvement, parental support and family education on pupil achievement and adjustment”
11. Demaliaj, S. (2002).”Probleme social-psikologjike të nxënësve me prindër të divorcuar”.Botim i Institutit të Studimeve Pedagogjike.Nr. 3.
12. Dispozitat Normative (2013). “Per sistemin arsimor parauniversitar”.
13. Deklarata Universale e të Drejtave te Njeriut
14. Epstein, J.L (1995) “School and family communication partnership. Caring about children”p.700-711.
15. Epstein, J,L. (1991) “Effects on student achievement of teachers` practices of parent involvement”. Vol. 5. pp.260-272
16. Eurofound - European Foundation for the Improvement of Living and Working Conditions (2010) Developing support to parents through early childhood services, workshop report, Brussels, 27th November 2009, Dublin, Eurofound.
17. European Commission (2011) Early Childhood Education and Care: Providing all our children with the best start for the world of tomorrow, Communication from the Commission, COM (2011) 66 final, Brussels, 17.2.2011.

18. European Economic and Social Committee (2010) Opinion of the European Economic and Social Committee on Early Childhood Care and Education, Soc/358, Brussels, 20 January 2010.
19. Earl, L. Fullan, M et al. (2000). Watching& learning. (evaluation of the implementation of the national literacy and numeracy strategies). Uk.
20. EUROPE 2020 A strategy for smart, sustainable and inclusive growth. COM(2010) 2020
21. Fullan,M. “Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim”.(2001). p.295-307,308.
22. Feldman, S.R. Essentials of Understanding Psychology. 4<sup>th</sup>.ed. (2000).p.172-174
23. Gertler, P. Patrinos, H. Rubio,M. (2008) ”Empowering parents to improve education”
24. Gertler, P. Patrinos, H. Rubio,M. (2008) ”Empowering parents to improve education”
25. Goleman, D. Emotional Intelligence (1994). p.189-204
26. Gjedia, R. “Si të ndihmojmë fëmijën të mësojë”. (2003) Kurrikula dhe Shkolla 4. Botim i Institutit Pedagogjik.
27. Hoover-Dempsey, K.V, Bassler, O.L & Brissie, J.S (1987). “Parent involvement”. AER. P. 285-292.
28. Hardin,D.M & Littlejohn, W. (1994) “Family-school collaboration. Elements of effectiveness and program models” p. 37-41
29. Harris, A., &Goodall, J., (2007). “Engaging parents in raising achievements. Do parents know they matter?”.
30. H,Garry. (2000).”Improving parental involvement”., p.68-84.151.
31. Haralambos,M & Heald, R.Sociology. “Themes and Perspectives”.(1980). 2<sup>nd</sup> edition. p. 173-178, 189-193, 217-221
32. Jensen.K., Joseng.F.,& Lera. Met (2007). Family School Relation.
33. Kraja, m. “Pedagogjia”.(2002) p. 328-330. 338
34. Kraja, M. “Pedagogji e zbatuar”. (2008). P. 457-484
35. Karoly, L.A., et al. (1998), “Investing in our children: What we know and don't know about the costs and benefits of early childhood interventions”.
36. “Kodi i etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar publik dhe privat”(2013)
37. Lawson, M. Lawson,.T.A (2012).”A case study of school-linked, collective parent engagement” (AERJ)
38. Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.
39. Ligji për arsimin fillor në Maqedoni. Nr. 135/2014).

40. Marphatia,A. Edge,K. (2010). “Politics of participation:parental support for children`s learning and school governance”. p. 25-29. 78.
41. Mannathoko, M. (2013). “Barriers for parental involvement in primary school”.
42. Musai, B. Metodologji e mësimdhënies (2003). p.244-250
43. Mialaret, G.”Pedagogjia e Përgjithshme” (1995). p. 200-202
44. Mita, N.”Paketa e treguesve të cilësisë së arsimit”.(2002). Vlerësimi i Arsimit, Botim i Institutit i Studimeve Pedagogjike.p.20-88.
45. Material në ndihmë të psikologëve shkollor. (2008). Qendra e Zhvillimeve Humane
46. National Standards for family-school partnership. (PTA).what parents, schools, and communities can do together to support student success.
47. Nordahl.Th. (2006) Samarbeid mellom hjem og skole-en kartleggingsunderskolese.
48. Orstein, C.Allan& Hunkins, P.Francis. “Kurrikula. Bazat, parimet dhe prblemet”(2003). p.512-513.
49. Oktrova, E. “Mësuesit prindërit dhe bisedat me fëmijët e adoleshentët”. Probleme psiko-pedagogjike.Nr.7. (2005).Botim i Institutit të kurrikulave dhe Standardeve. Tiranë
50. Redding, S. “Prent and learning”. UNESCO p. 17-22
51. Pardini, P.(1995) “Legislating parental involvement”.
52. Piaget, J. 2005.Mbi pedagogjinë. 225-228
53. PISA 2009 Results. What makes a School Successful? Resources, policies and practices (V.4).p.68,98-99.
54. “Përfshirja e prindërve në jetën e shkollës në Shqipëri”.CDE 2010
55. “Parental involvement strategy 2013” (Education and skills)
56. S,R.Hara& Burke,J.Daniel (1998).“Parent involvement: The key to improves student”. School Learning Journal vol.8,nr.2
57. Shearer , K., (2006) “Parnetal involvement: Teachers` and parent`s voice”.
58. “School management” (2005). UNESCO. p. 29-31
59. “Situata e përfshirjes së prindërve në edukim.Shqiperi”.(2008) CDE& UNICEF
60. “Standardet e shkollës qendër komunitare”.
61. “Standardet e mësuesit”
62. Vjetari statisitkor për arsimin. MAS 2012-203
63. Education strategy 2014-2015.UNESCO.pp 53
64. Watson, G. Lawson, S.R., McNeal, L (2012). “Understanding Parental Involvement in American Public Education.International Journal of Humanities and Social Science.
65. [www.hfrp.org/family-involvement/fine-family-involvement-network-of-educators](http://www.hfrp.org/family-involvement/fine-family-involvement-network-of-educators)



## 8.2 THE ABSTRACT

The construction and the development of school-family partnerships is emerging as one of the most current topics in the discussions and professional approach of the leaders of educational institutions, teachers, specialists and scientific researchers in the field of education. This consists not only because of the interest of the school to improve its quality of the service, but also for the fact that the family has a role and a considerable potential in the effectiveness of the children's education.

The following study, entitled "The involvement of the parents in the realization of the elementary curriculum, as a factor of the construction of friendly relations of the pupil with the school ", was developed as part of the doctoral degree program organized at the Faculty of Social Sciences of the University of Tirana. The study was developed precisely in this field and / or aspect of the educational service and intended to provide not only an analysis of the quality of the development of this relationship in our educational institutions, but also to provide an access on the methodology that can be implemented in schools connected with the building and professional development of the relationships of the teachers with parents in the primary cycle of education.

The study analyzes some of the aspects and characteristics that experience so far recorded in our schools in cooperation with parents. In this context, are analyzed and recorded characteristics, barriers and difficulties that represent our school parent communities, which do not allow them an effective involvement in the education process of their children. The study also has analyzed the normative and regulatory framework of the educational system in our country, the actual experience of creating in our schools in this regard, stating that they are insufficient for a full and effective involvement of parents.

Considering the experience gained and in particular the common interest of the school and parents to sustainable development of quality education service, the study represents and develops the thesis that the school involvement and partnership with them should gain a feature and / or a new dimension, it of commitment of the parents in the realization of the education process, and particularly in learning.

The population of this study were the parents of the elementary students of classes I-IV of 9-year schools, which are administered by the Regional Education Directorate in Tirana City. The survey sample of this population was been 2885 parents and referred to statistics of Ministry of Education and Science for the academic year 2012-2013, represents 10.8% of the parents who have received education services in schools of this city.

In order to recognize the characteristics of the parental community of the schools, as the main instrument of the methodology it was designed and structured a questionnaire constituted for the parents. The questionnaire was structured in such rubrics; general, competence / writing ability, competence / ability to read, competence/ mathematical ability, for the recognition of academic curricula and for the organization of the education process in the family. The Questionnaire contains a total of 47 questions and processing of collected data was performed through the statistical package for social sciences SPSS, version 18.

The results of the study show that parents in our schools have a significant involvement in school life and activities, but this participation is reflected only in terms of management and administration of the school institution. This experience does not enable them (the parents) to be supportive factor of the quality of the educational service provided in schools. The evidence and the interpretation of the characteristics of the parents community in the schools such as; their level of education, lack of knowledge of academic curricula, lack of skills on methodology of the learning process, makes them not a supportive factor and not supplementary of the quality, but in factor and its risk cause.

*Keywords:* Involvement in education, commitment to education, learning, competence, learning at home, school and family partnerships, indicators of success.

### 8.3 PYETSORI PËR PRINDËRIT E NXËNËSVE TË KLASAVE 1,2,3,4 dhe 5, TË ARSIMIT 9-VJEÇAR

Të nderuar Prindër,

Ju falënderojmë për kohën që do të na kushtoni duke plotësuar këtë *Pyetësor*. Ju informojmë se Pyetësori ka qëllime vetëm studimore. Ju mund ta plotësoni atë, **pa u identifikuar**. Saktësia dhe objektiviteti i përgjigjeve tuaja janë shumë të rëndësishme për rezultatet e këtij studimi. Për të dhënë përgjigjen/mendimin tuaj, Ju lutemi (*rrethoni*), ose vendosni shenjat:(+), (x) ose (v)nëkutizat përkatëse.

#### I Të përgjithshme:

1. Fëmija juaj është?	Djalë	<input type="checkbox"/>	Vajzë	<input type="checkbox"/>						
2. Në cilën klasë është fëmija juaj?	Klasa I	<input type="checkbox"/>	Klasa II	<input type="checkbox"/>	Klasa III	<input type="checkbox"/>	Klasa IV	<input type="checkbox"/>	Klasa V	<input type="checkbox"/>
3. Vlerësimi, (Nota mesatare) e fëmijës suaj është?	'Shumë Mirë',	<input type="checkbox"/>	'Mirë',	<input type="checkbox"/>	'Mjaftueshëm',	<input type="checkbox"/>	'Dobët'	<input type="checkbox"/>		
4. Arsimi i Prindërve?	I Nënës:	I lartë	<input type="checkbox"/>	I mesëm	<input type="checkbox"/>	I detyruar	<input type="checkbox"/>			
	I Babait:	I lartë	<input type="checkbox"/>	I mesëm	<input type="checkbox"/>	I detyruar	<input type="checkbox"/>			
5. Profesioni i Prindërve?	I Nënës:	Mësuese	<input type="checkbox"/>	Jo Mësuese	<input type="checkbox"/>					
	I Babait:	Mësues	<input type="checkbox"/>	Jo Mësues	<input type="checkbox"/>					

#### II Për kompetencën/aftësinë e të Shkruarit:

6. A e vlerësoni të rëndësishme kompetencën/aftësinë e të Shkruarit në formimin e fëmijës suaj?	Mendimi i Nënës:	Shumë të rëndësishme	<input type="checkbox"/>	Të rëndësishme	<input type="checkbox"/>	Parëndësishme	<input type="checkbox"/>			
	Mendimi i Babait:	Shumë të rëndësishme	<input type="checkbox"/>	Të rëndësishme	<input type="checkbox"/>	Parëndësishme	<input type="checkbox"/>			
7. Si e vlerësoni cilësinë e shkrimit të fëmijës suaj?	Mendimi i Nënës:	Shumë të mirë	<input type="checkbox"/>	Të mirë	<input type="checkbox"/>	Mjaftueshëm	<input type="checkbox"/>	Të dobët	<input type="checkbox"/>	
	Mendimi i Babait:	Shumë të mirë	<input type="checkbox"/>	Të mirë	<input type="checkbox"/>	Mjaftueshëm	<input type="checkbox"/>	Të dobët	<input type="checkbox"/>	
8. Si e vlerëson Mësuesja, shkrimin e fëmijës suaj?	Shumë të mirë	<input type="checkbox"/>	Të mirë	<input type="checkbox"/>	Mjaftueshëm	<input type="checkbox"/>	Të dobët	<input type="checkbox"/>	Nuk na ka dhënë vlerësim	<input type="checkbox"/>
9. Jeni dakord me vlerësimin e Mësueses për cilësinë e shkrimit të fëmijës suaj?										

Plotësisht dakord	Pjesërisht dakord	Mjaftueshëm	Aspak dakord
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

10. A i njihni “treguesit e cilësisë” për aftësinë e ‘Të shkruarit’?

Po                      Jo

11.A u janë bërë të njohura nga Mësuesja, Treguesit e cilësisë për kompetencën e ‘Të shkruarit’?

Po                       Jo

12.A mendoni se shkolla/mësuesja duhet t`i njohë Prindërit me Treguesit e cilësisë së aftësisë së ‘Të shkruarit’?

Po                       Jo

### III Për kompetencën/aftësinë e ‘Të Lexuarit’:

13. A e vlerësoni të rëndësishme kompetencën/aftësinë e të ‘Lexuarit’, në formimin e fëmijës suaj?

Mendimi i Nënës:	Shumë e rëndësishme	Të rëndësishme	E parëndësishme
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mendimi i Babait:	Shumë e rëndësishme	Të rëndësishme	E parëndësishme
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

14. Si e vlerësoni cilësinë e të ‘Lexuarit’ të fëmijës suaj?

Mendimi i Nënës:	Shumë të mirë	Të mirë	Mjaftueshëm	Të dobët
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mendimi i Babait:	Shumë të mirë	Të mirë	Mjaftueshëm	Të dobët
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

15. Si e vlerëson Mësuesja cilësinë e të Lexuarit të fëmijës suaj?

Shumë të mirë	Të mirë	Mjaftueshëm	Të dobët	Nuk na ka dhënë vlerësim
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

16. A jeni dakord me vlerësimin e Mësueses?

Plotësisht dakord	Pjesërisht dakord	Aspak dakord
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

17. A i njihni ‘treguesit e cilësisë’ së kompetencës/aftësisë së të ‘Lexuarit’

Po                      Jo

18. A u janë bërë të njohura nga Mësuesja, treguesit e cilësisë për kompetencën e të ‘Lexuarit’?

Po                       Jo

19. A mendoni se Shkolla/Mësuesja, duhet t`i njohë prindërit me treguesit e cilësisë për kompetencën e të lexuarit?

Po                       Jo

#### IV Për kompetencën/aftësinë 'Matematikore':

20. A e vlerësoni të rëndësishme kompetencën 'Matematikore', në formimin e fëmijës suaj?

Mendimi i Nënës:	Shumë e rëndësishme	Jo aq e rëndësishme	E parëndësishme
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mendimi i Babait:	Shumë e rëndësishme	Shumë e rëndësishme	E parëndësishme
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

21. Si i vlerësoni rezultatet e fëmijës suaj në Matematikë?

Me ndimi i Nënës:	Shumë të mira	Të mira	Mjaftueshëm	Të dobëta
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Mendimi i Babait:	Shumë të mira	Të mirë	Mjaftueshëm	Të dobëta
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

22. Si i vlerëson Mësuesja arritjet/ rezultatet e fëmijës suaj në Matematikë?

Shumë të mira	Të mira	Të dobëta	Nuk na ka dhënë vlerësim
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

23. A jeni dakord me vlerësimin e mësueses?

Plotësisht dakord	Pjesërisht dakord	Aspak dakord
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

24. A e ndihmoni dot fëmijën në të ushtruarin në Matematikë në shtëpi?

<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	<input type="checkbox"/> Jo plotësisht
-----------------------------	-----------------------------	--

25. A merrni këshilla metodike nga mësuesja për ndihmën tuaj gjatë të ushtruarit të fëmijës në Matematikë?

<input type="checkbox"/> Po	Jo <input type="checkbox"/>
-----------------------------	-----------------------------

26. A u janë bërë të njohura nga Mësuesja, treguesit e cilësisë gjatë të ushtruarit të fëmijës në Matematikë në shtëpi?

<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo
-----------------------------	-----------------------------

27. A mendoni se Shkolla/Mësuesja, duhet t'i njohë prindërit me treguesit e cilësisë për kompetencën e Matematikore?

<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo
-----------------------------	-----------------------------

#### V. Për njohjen e programeve lëndore dhe procesit mësimor:

28. A jeni njohur me programet lëndore që zhvillon fëmija juaj në shkollë?

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
--------------------------	--------------------------	--------------------------

Jo. Me asnjë program  Po. Me të gjitha programet  Po. Me disa nga programet

29. (Nëse përgjigja në pyetjen 28 është, 'Po, me disa'), Cilin program lëndor njihni?

<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Gjuhë amtare,	Gjuhë të huaj,	Matematikë,	Dituri Natyre,	Histori,	tjetër

30. A keni informacion ku mund t'i gjeni ato (programet lëndore)?

Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
-----------------------------	-----------------------------

31. A i njihni objektivat e programit/ve lëndore?

Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/> Pjesërisht (të ndonjë lënde të veçantë)
-----------------------------	-----------------------------	--

32. A i njihni objektivat për çdo linjë(kapitull) të programeve lëndore?

Po

Jo

Pjesërisht (ndonjë lënde të veçantë)

33. A jeni orientuar/këshilluar nga mësuesja që të njiheni me programet lëndore?

Po

Jo

34. A mendoni se shkolla duhet t'i pajisë prindërit me programet e lëndëve?

Po

Jo

Nuk e di

35. Si e vlerësoni cilësinë e procesit mësimor që fëmija realizon në klasë?

Shumë të mirë

Të mirë

Jo aq të mirë

Duhet përmirësuar

36. Si e gjykon ngarkesën mësimore që nxënësi realizon në klasë

Normale

Të ulët

Të mbingarkuar

37. A mendoni se ngarkesa mësimore ka ndikuar në nivelin e stresit tek fëmija juaj?

Po

Jo

Nuk e di

## VI. Për organizimin e procesit të edukimit në familje:

38. Si e vlerësoni mjedisin mësimor që keni në familje?

Shumë mirë

Mirë

Duhet përmirësuar

39. Kush nga prindërit ndihmon më shumë fëmijën gjatë procesit të të mësuarit në shtëpi?

Nëna

Babai

40. Me cilin prej prindërve mendoni se fëmija juaj ndjehet më mirë gjatë të mësuarit në shtëpi?

Me Nënë

Me Babain

41. Si e gjykon ngarkesën mësimore që fëmija duhet të realizojë në shtëpi?

Normale

Të ulët

Të mbingarkuar

42. A përdorni tekste të tjera(ndihmëse), përveç atyre të shkollës?

Po

Jo

43. A ndjeni të nevojshme që fëmija juaj duhet të ndjekë kurse mësimore (private) ?

Po

Jo

44. A shkon fëmija juaj në kurse private?

Po

Jo

45. Nëse 'Po', në cilat lëndë?

Gjuhë amtare ,

Gjuhë të huaj,

Matematikë,

Dituri Natyre,

Histori,

tjetër

46. Në procesin mësimor që realizoni në shtëpi, ju si prindër i referoheni?

Tekstit mësimor

Porosive të mësueses

Programit të lëndës

Tekstit dhe Programit

Tjetër

47. Në procesin mësimor që realizoni në shtëpi, ju si prindër në cilat faza keni vështirësi?

Në organizimin e procesit  Në realizimin e procesit  Në vlerësimin e procesit  Në të gjitha fazat  Në asnjërën